



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të
ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

**RAPORT PËRFUNDIMTAR
AUDITIMI
MBI
AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË
PËRPUTHSHMËRISË NË
“BASHKIA URA VAJGURORE”**

Tiranë, Qershor, 2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I	Përmbledhje ekzekutive	4 -5
II	Hyrja	5 - 9
III	Përshkrimi i auditimit	9 - 11
IV	Drejtimit e auditimit	12 - 125
	Kontrolli i brendshëm.	12 -16
A	A/1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut	12 - 13
	A/2 Mbulimi me auditim i aktivitetit të Bashkisë, referuar kërkesave ligjore. Rezultatet dhe efica e strukturave të ngritura për realizmin e auditit të brendshëm.	13 – 14
	A/3 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	14 - 16
	Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA dhe buxhetit vjetor respektiv për periudhën 2017-2019.	16 - 21
B	B/3 Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor	21 - 37
C	Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të parashikuar opinion mbi pasqyrat financiare për vitet 2017-2019.	37 - 53
D	D. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit për prokurimet publike.	52 – 105
	- Viti 2017	54- 82
	- Viti 2018	82 -103
	- Viti 2019	103 - 105
	D/4 Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.	105 - 125
V	Opinion Auditimit	126 – 129
VI	Gjetjet dhe Rekomandimit	129 - 149
VII	Anekse	150 - 182



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonime.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Përmbledhje Ekzekutive.

Nga auditimi kanë rezultuar këto gjetje:

- Në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare (balance) të viteve 2017 - 2019, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **Opinion i kualifikuar**, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705), të cilat sipas mendimit tonë kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Ura Vajgurore.

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **Opinion i modifikuar me rezervë¹**, pasi janë konstatuar parregullsi në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e vijim AK) në shumë raste më pjesëmarrje vetëm me një OE, të reflektuara me paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në procedurat e prokurimit publik në vlerën 358,716 mijë lekë.

Gjithashtu,

- Në administrimin e shpenzimeve operative, nuk është arritur efënca dhe efikasiteti i procedurave të prokurimit, duke mos përmbushur kështu, qëllimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, veprime me paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në fushën e prokurimit në vlerën **344,972 mijë lekë**, etj.

Për këto u analizuan 38 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 625,492 mijë lekë ose 97.4 % të fondit limit të prokuruar për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019.

- Në fushën e zbatimit të kontratave për punë civile, shërbime e mallra si dhe mungesës së lidhjes së kontratave me subjektet e shfrytëzimit të guroveve, janë konstatuar parregullsi për vlerën e dëmit ekonomik prej **42,161 mijë lekë**, si rezultat i mos përfundim në afat të punimeve dhe mangësive të konstatuara në zbatimin e punimeve jo sipas projekt preventivin të punimeve.

- Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjare, nuk është ndjekur e plotë procedura në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 28.5.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshime dhe Vendimeve respektive të Këshillit Bashkiak, për arkëtimin e vlerës **223,115 mijë lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Ura Vajgurore. Borxhi tatimor i konstatuar është në vlerën **23,615 mijë lekë**.

- Detyrimet për 6 vendime gjyqësore janë në vlerën **18,652 mijë lekë** (nga të cilat 5 për largime nga puna dhe një penalitet).

- Mos zbatimi i rekomandimeve nga auditimet e kaluara, duke vlerësuar se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e tyre, kryesisht për vlerën e shpërblimit të dëmit prej **6,671 mijë lekë**.

¹ Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; Kapitulli V “Raportimi i auditimit”, pika 5.4 “Konkluzionet/opinionit në auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI/2019 “Framework of Professional Pronouncements” (IFPP), ISSAI 400 “Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë” dhe ISSAI 4000 “Standardet e auditimit të përputhshmërisë”, Kapitulli 9 “Raportimi”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimin me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre, duke prekur zonat e llogarive, 600-paga; 202- Studime dhe kërkime; 401-408-Furnitorë e llogari te lidhura me to; 467-Kreditore te ndryshëm; 602-shpenzime operative; 215-Mjete transporti; 218-Inventar ekonomik; 32-Objekte inventari dhe 230- 231-investime, si dhe 38 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 625,492 mijë lekë ose 97.4 % të fondit limit të prokuruar për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 262/1prot, datë 02.03.2020, ndryshuar me shkresat nr.262/2, datë 24.04.2020, për shtyrje afat auditimi për arsye të situatës së fatkeqësisë natyrore nga COVID-19, dhe 262/3, datë 19.05.2020, për ndryshim afat auditimi deri më datë 29.05.2020 dhe shtuar grupi i auditimit, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 03.03.2020 deri në datën 29.05.2020, për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.03.2020 “Auditimi Financiar dhe Përputhshmërisë” nga Grupi i Audituesve Shtetërore:

1. L. B., Përgjegjës Grupi
2. G. K., Auditues
3. J. P., Auditues
4. A. Z., Kryeauditues
5. L. B., Auditues

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), auditoi pasqyrat financiare të viteve 2017, 2018 dhe 2019, mbi bazën e materialitetit dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm. Zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 17 akte, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit datë 22.05.2020 dhe 29.05.2020.

- a) **Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërisë.
- b) **Marrësi:** Raporti Përfundimtar i Auditimit i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Ura Vajgurore.
- c) **Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

Përcaktimi nëse pasqyrat financiare të subjektit që auditohet janë paraqitur saktë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.

Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit financiar për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord të procedurave të prokurimit, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e Rekomandimeve për përmirësime².

Objektivat e auditimit synojnë:

²-Rregullorja e procedurave të auditimit në KLSH, faqe 28



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

-nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullave dhe ligjeve të kontabilitetit;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në zbatim të ligjit të Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

d) Identifikimi i çështjes.

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Ura Vajgurore, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

e) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).

Kryetari i Bashkisë Ura Vajgurore (*Nëpunësi autorizues*) **znj. J. M.** dhe Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financës (*Nëpunësi zbatues*) **znj. M. B.**, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6 e nenit 34, neneve 65- *Administrata e njësisë administrative* dhe pika 1 “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori” e nenit 91, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore” .

f) Përgjegjësitë e Audituesve:

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH^{së}*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Ura Vajgurore, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

g) Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- ✓ Kushtetuta dhe ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- ✓ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, ligji nr. 109/2017, datë 18.12.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje.
- ✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, etj.
- ✓ UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor...”, i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.
- ✓ UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- ✓ Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”.
- ✓ Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurën e përgatitjes dhe paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare”.

h) Standardet e auditimit të aplikuar në kryerjen e punës.

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë” që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

i) Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, të Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe shqyrtimit me objektivitet dhe profesionalizim të u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimit.

j) Praktikrat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), operative (602) dhe investime (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej **5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektiveve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

k) Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshime.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

III- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

1. Informacioni i përgjithshëm:

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektiv, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Ura Vajgurore është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Ura Vajgurore etj. akt ligjore/nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Ura Vajgurore.

1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Zona Gjeografike: Ura Vajgurore kufizohet në veri- perëndim me bashkinë Lushnjë, në veri-lindje me bashkinë Kuçovë, në jug-lindje me bashkinë Berat dhe në jug-perëndim me bashkinë e Roskovecit. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Urës Vajgurore.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 27,295 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 39,551 banorë. Me një sipërfaqe prej 156.56 km², ajo ka densitet prej 174 banorë/km² sipas censurit dhe densitet prej 226 banorë/km² sipas regjistrimit civil.

Të dhëna të tjera: Bashkia e re shtrihet në një zonë të pasur me toka bujqësore shumë pjellore si dhe me burime të rëndësishme guri. Burimet kryesore të të ardhurave për banorët e kësaj zone bazohen te shfrytëzimi i resurseve natyrore, sidomos atyre të përpunimit të inerteve të gurit dhe të lumenjve, i fermave private, përpunimit agro-industrial, plantacioneve me ullinj, dru frutorë dhe vreshta, perimeve, blegtorisë, si dhe përpunimit të produkteve të qumështit dhe mishit.

Kjo zonë është e njohur herët për minierat sipërfaqësore të gurit, ndërsa kohët e fundit edhe për përpunimin e gurit në granit dhe gëlqere, duke u njohur edhe si “guratorja” e Shqipërisë për shkak të numrit të madh të shoqërive private që kryejnë aktivitetet në këtë fushë.

Me ndarjen e re administrative kjo njësi vendore do të marrë një profil të rëndësishëm bujqësor, të orientuar sidomos në frutikulturë me prodhimin e ullirit, por nuk mbetet pas dhe blegtorisë, drithërat dhe perimet, si dhe shumë foragjere. Veçanërisht Komuna Kutalli është e njohur në rang kombëtar për kultivimin dhe hershmërinë e perimeve në serat pa ngrohje. Këtë mundësi ia jep terreni dhe pozicioni shumë i favorshëm gjeografik që i favorizon fermerët të kultivojnë perime, fruta dhe vreshta.

2. Të dhëna mbi gjetjet nga auditimet e mëparshme:

Kjo Bashki është audituar nga KLSH-ja për një periudhë nga 01.01.2015 – 31.12.2016. Me shkresën nr. 259/19, datë 06/07/2017, nga ana e KLSH janë rekomanduar 20 masa organizative. Janë rekomanduar 9 masa për shpërbllim dëmi në shumën 12,191,045 lekë, janë rekomanduar 20 masa disiplinore nga të cilat 6 për punonjësit e shërbimit civil dhe 13 për punonjës që marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punë. Si dhe i janë rekomanduar APP masa administrative për 11 raste, dhe me shkresën nr. 259/29, datë 07.12.2017 të APP mbi Vendimin nr. 88, datë 05.12.2017 të APP është dhënë 1 masë disiplinore dhe 9 masa me gjobë në shumën 680,000 lekë (më hollësisht trajtuar në pikën A/3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

a. Objekti i këtij auditimi, është përputhshmëria e veprimtarisë dhe rregullshmëria e operacioneve financiare të kryera nga ana Bashkisë Ura Vajguore përgjatë periudhës 01.01.2017 deri më 31.12.2019.

b. Qëllimi i auditimit, është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e Rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrin ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)⁴.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të ISSAI 1700, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

c. Fushëveprimi: Auditimi ka përfshirë fushën e prokurimeve publike, veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, administrimi i Aseteve, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, dhënien e lejeve zhvillimore/ndërtimit dhe përdorimit, veprimtaria e IMT, hartim e zbatimi i buxhetit si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

d. Misioni, për njësinë që auditohet është Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

e. Objektivat, burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak. Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre. Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

f. Metoda e Auditimit: Auditim mbi bazë risku.

⁴Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

IV. DREJTIMET E AUDITIMIT

A. KONTROLLI I BRENDSHËM.

A/1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon;

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Ura Vajgurore, nga Grupi i Auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët, konkretisht: Mjedisi i kontrollit; Menaxhimi i riskut; Aktivitetet e kontrollit; Informimi dhe komunikimi; Monitorimi.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

1- Titulli i gjetjes: KLSH në drejtim të zbatimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit konstatoi se nuk ka manuale mbi procedurat për operacionet kryesore. Mungon sistemi i mirëfilltë unik i mbajtjes së kontabilitetit si dhe Bashkia Ura Vajgurore nuk ka mekanizma të cilat t’i dedikohen ankesave për korrupsion.

Situata:

Për të vlerësuar funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, grupi i auditimit testoi *komponentët vlerësues të funksionimit të kontrollit* të brendshëm, nga të cilat rezultoi;

-Mjedisi i kontrollit. Strukturat e Bashkisë, funksionojnë sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, por nuk është miratuar kodi i etikës profesionale.

Nga ana e Titullarit të Bashkisë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit. Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit. Lëvizjet e punonjësve për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, vlerësohet me risk përse i përket shkallës së kualifikimit të tyre, veprime në kundërshtim me UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19, neni 16 pika 2 dhe neni 22.

-Menaxhimi i riskut. Lidhur me identifikimin e aktiviteteve më risk, hapjen e regjistrit të riskut si dhe menaxhimin e tij, është caktuar koordinatori i riskut në kundërshtim me kërkesat e nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

Nuk është miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk, si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij.

-Veprimtaritë e kontrollit. Në këtë Bashki, është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), veprim i cili ka çuar në mos miratimin e Planeve të Zhvillimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Kriteri	<p>Strategjik dhe planet buxhetore afat mesëm, në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010; ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF nr. 8 dt. 29.3.2012 “Procedura e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.</p> <p><i>-Informacioni dhe komunikimi.</i> Realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010.</p> <p><i>-Monitorimi.</i> Në monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatuan se janë përmbushur kërkesat ligjore, konkretisht janë konstatuar shumë raste ku marrja në dorëzim e punimeve të kontraktuara ose furnizimi me materiale sipas kontratave, nuk janë bërë me komisione të ngritura për këtë qëllim. Këto raste janë shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar Kap. III, pikat Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4 pika 19, nenet 21, 22, 23, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32, UMF Plotësues nr. 8 dt. 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V dhe UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” pika 40;</p>
Impakti Shkaku	<p>Ndikim në mbarëvajtjen e funksionimit dhe menaxhimit të proceseve.</p> <p>Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel të lartë të riskut dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.</p>
Rëndësia: Rekomandimi	<p>I mesëm.</p> <p>1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos funksionimit të aktivitetit të GMS-së, duke nxjerrë përgjegjësitë më qëllim që GMS-ja të kryejë funksionet e veta ligjore.</p> <p>1.2 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajgurore, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, të hartojë regjistrin e riskut e në mënyrë periodik, si dhe të hartohet rregullore për kodin e etikës përfshirë hartimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës.</p>

A/2. Mbulimi me auditim i aktivitetit të Bashkisë, referuar kërkesave ligjore. Rezultatet dhe efica e strukturave të ngritura për realizimin e auditit të brendshëm. Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, Planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi;

2- Titulli i gjetjes: Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së auditimit të brendshëm u konstatuan mangësi në drejtim të realizimit të planit të auditimeve, të plotësimit të strukturës së njësisë dhe mungesë e certifikatës të auditit të brendshëm të dy prej audituesve.

Situata: Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm rezultoi se: nuk është bërë i mundur realizimi i kontroleve për verifikimin e detyrave të lënë nga misionet e auditimit të kryera, pikë e cila nuk rezulton të jetë dhe në programet e auditimit të subjekteve të ri kontrolluara, duke bërë që si nga NJAB ashtu dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	<p>Menaxheri i Njesisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera, në kundërshtim me ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”; Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;</p>
<u>Kriteri:</u>	<p>Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”. VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.</p>
<u>Impakti:</u>	<p>Nuk jep siguri të mjaftueshme për përmbushjen dhe zbatimin e ligjit për funksionin dhe detyrat që ka auditimi i brendshëm.</p>
<u>Shkaku:</u>	<p>Nga neglizhenca dhe nga mos këmbëngulja në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e ushtruara nga Auditimi i Brendshëm.</p>
<u>Rëndësia:</u>	<p>E lartë</p>
<u>Rekomandimi:</u>	<p>Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në përfundim të procesit të auditimit në njësitë e audituara, të kryej monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të cilat kërkon që në zbatim të rekomandimeve, Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm.</p>

A/3. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme (Plani i veprimit, shkalla e realizimit të tij, respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve dhe raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm).

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

1. Kryetari i Bashkisë Ura Vajgurore ka miratuar planin e veprimit nr. 1848, datë 28/07/2017 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresë nr.259/19, datë 06/07/2017. Plani i veprimit për zbatimin e masave të rekomanduara sa më sipër është përcjellë në KLSH me shkresë nr. 1848 datë 28/07/2017, brenda afatit ligjor të përcaktuar.
2. Për sa i përket informimit në vazhdimësi për afatin 6/mujor të progresit të zbatimit të masave të rekomanduara, Bashkia Ura Vajgurore është në proces pasi afati 6/mujor për informimin e KLSH është deri në datë 30.01.2018.
3. Me shkresën nr. 259/19, datë 06/07/2017, nga ana e KLSH janë rekomanduar masa, statusi i zbatimit të të cilave nga auditimi rezulton si më poshtë:

3- Titulli gjetjes: Realizimi i rekomandimeve për ndryshime ligjore, masa organizative, masa shpërblim dëmi dhe masa disiplinore, sipas cilësimeve në plan veprimin të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për Rekomandimit e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga Rekomandimit nuk janë pranuar.

Situata Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
a. Me shkresën nr. 259/19, datë 06/07/2017, nga ana e KLSH janë rekomanduar **20 masa** organizative nga të cilat **janë zbatuar 17 masa**, janë në proces zbatimi **3**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	<p>masa dhe nuk është zbatuar 1 masë ajo me nr. 20 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në vitin 2014.</p> <p>b. Janë rekomanduar 9 masa për shpërblim dëmi nga të cilat për 6 masa (masa nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6) në shumën 6,619,712 lekë subjekti është në procese gjyqësore, 1 masë është zbatuar dhe 1 është në proces.</p> <p>c. Janë rekomanduar APP masa administrative për 11 raste, me shkresën nr. 259/29, datë 07.12.2017 sipas Vendimit nr. 88, datë 05.12.2017 të APP për 1 masë disiplinore dhe 9 masa me gjobë në shumën 680,000 lekë të cilat <u>ri kërkohen</u> për zbatim.</p> <p>d. Masa administrative në bazë të Vendimit të APP nr. 88, datë 05.12.2017 në shumën 680,000 lekë.</p>
Kriteri:	Veprimet e mësipërme janë në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”
Impakti:	Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën 5,275,523 lekë.
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturave drejtues
Rëndësia	E lartë
Rekoman dimi:	Kryetari i Bashkisë Ura Vajgurore të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr.259/19, datë 06/07/2017 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Ura Vajgurore”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për ri zbatimin e plotë të tyre, respektivisht: 3 masa organizative të cilat janë në proces zbatimi. 6 masa për shpërblim dëmi në shumën 6,431,493 Masa administrative të rekomanduara APP për 11 raste, e cila me shkresën nr. 259/29, datë 07.12.2017 sipas Vendimit nr. 88, datë 05.12.2017 ka dhënë 1 masë disiplinore dhe 9 masa me gjobë në shumën 680,000 lekë.

Komente te paraqitura me shkresën nr,1300/18, datë 12.06.2020 e protokolluar në KLSH me numër 262/6, datë 13.06.2020 nga punonjësi B. R..

Në lidhje me sa komentoni se:

“-Nga Auditimi i Veprimeve Në seksionin B.MASA shpërblim dëmi në faqet 160-161 ne piken 2.Gjetje nga Auditimi, per detyrat e lëna nga Kontrolli i mëparshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit, mbajtur me 30.06.2017 për Ish-Komunën Kutalli për periudhën 01.01.2013-31.07.2015 citohet si me poshtë:

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Komunës Kutalli u konstatuan shkelje me efekte financiar dëm ekonomik në vlerën **795,400 lekë**, konkretisht:

a. 402,000 lekë për subjektin “L. 2007” shpk, sipas urdhër shpenzimit nr. 186, datë 07.07.2015, pasi është shpenzuar për sistemim të pikave të hedhjes së plehrave kur ky shërbim është kryer njeherë edhe 6 muaj më parë sipas urdhër shpenzimit nr. 296, datë 31.12.2014, nga i njëjti subjekt.

b. vlera 70,800 lekë, nga financieri B. R. për blerje kancelari e shtypshkrime pa normativë ligjore, pa planifikim dhe në mënyrë të pajustificuar, sipas urdhër shpenzimit nr. 178, datë 4.7.2015.

c. vlera 290,000 lekë, përfituar dieta të pa justifikuara për periudhën qershor 2015, sipas urdhër shpenzimit nr. 175 dhe 176, datë 3.7.2015, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, nga 28 punonjës të administratës Kutalli, sipas listës në Projekt Raportin e Auditimit.

d. vlera 32,600 lekë përfituar tepër shpenzime celular për vitin 2014 dhe 2015 nga Sh. V. në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë”, pika 9, sipas urdhër shpenzimeve nr. 142, datë 15.6.2015, nr. 10, datë 19.01.2015, nr. 106, datë 16.06.2014, nr. 77, datë 16.05.2014, nr. 56, datë 17.04.2014, nr. 41, datë 24.03.2014, nr. 281, datë 26.12.2014, nr. 240, datë 20.11.2014, nr. 209, datë 28.10.2014 dhe nr. 157, datë 25.8.2014.

e. vlera 85,500 lekë nga preventivuesi G. I., pasi në preventivin e objektit “Ndërtim i fushës Sportive “kalceto” shkolla 9-vjeçare Drenovicë, Kutalli, për vitin 2014” ka rritur artificialisht fondin limit, duke përfshirë edhe zërin “supervizion 74,250 lekë +kolaudim 11,250 lekë,” për punë të pakryer nga subjekti, pasi ky shërbim kryhet nga specialist tjerë të licencuar sipas kontratave përkatëse, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandimi: Bashkia Ura-Vajgurore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **795,400 lekë**, përkatësisht:

-vlerën 402,000 lekë për subjektin “**L. 2007**” shpk

-vlerën 32,600 lekë për **Sh. V.**

-vlerën 85,500 lekë për **G. I.** dhe

-vlerën 290,000 lekë për 28 punonjësve të Komunës Kutalli (sipas listës Projekt Raportit).

Për pikën a), shuma 402 000 leke, është bere njoftimi për likuidim detyrimesh

Për pikën b) shuma 32 600 lekë, është bere

Për pikën c) shuma 85 500 lekë

Për pikën d)shuma 290 000 lekë

Kërkojmë nga Grupi i Auditimit te beje rregullimin midis rubrikës **Gjetje nga auditimi** dhe rubrikës **Rekomandimi duke hequr vlerën 70,800 lekë dëm ekonomik** nga Financieri B. R. për blerje kancelarie pasi ai nuk përmendet ne rubrikën **Rekomandimi**, pasi është observuar ne observacionet e mëparshme dhe është pranuar por nuk është hequr nga rubrika **Gjetje nga auditimi**. **Gjithashtu dhe vlera qe kërkohet te arkëtohet nuk është 795,400 leke si me sipër por 810,100 leke pra 402,000 + 32,600 + 85,500 + 290,000 = 810,100 leke.**

Sqarim: Për sa keni komentuar ju bëjmë me dije se komenti juaj merret në konsideratë, duke hequr nga rekomandimi vlerën prej 70,800 lekë, shumë e cila është lapsus nga auditimi i mëparshëm si dhe dëmi ekonomik për t`u arkëtuar ne gjetjen nr.2 të auditimit të mëparshëm mbetet:

1. 402,000 lekë për subjektin “L. 2007” shpk;
2. 32,600 lekë për Sh. V.;
3. 85,500 lekë për G. I.;
4. 290,000 lekë për 28 punonjësve të Komunës Kutalli (sipas listës Projekt Raportit);
5. Për pikën a), shuma 402 000 lekë;
6. Për pikën b) shuma 32 600 lekë;
7. Për pikën c) shuma 85 500 lekë;
8. Për pikën d)shuma 290 000 lekë;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

B. MBI PLANIFIKIMIN DHE ZBATIMIN E PBA DHE BUXHETIT VJETOR RESPEKTIV PËR PERIUDHËN 2017-2019.

1. Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit vjetor 2017, 2018 & 2019;
2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura; shkalla e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet periodike të monitorimit;
3. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave;
4. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

4- Titulli i Gjetjes: KLSH nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2017, 2018 dhe 2019, konstaton performance jo e kënaqshme e programimit dhe realizimit të buxhetit, mungesa e analizave faktoriale të tij si dhe mangësi në monitorimin e buxhetit.

Situata:	<p>Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitet 2017, 2018 dhe 2019, u konstatua se:</p> <p>Buxheti për vitin 2017 - 2019 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me detyrimet e papaguara, të cilat janë në nivel të lartë, ku vlera totale e detyrimeve të mbartura në vitin 2017 është në shumën 237,447,614 lekë, për vitin 2018 – 258,661,743 lekë dhe në vitin 2019 në shumën 190,564,044 lekë</p> <p>Në lidhje me detyrimet e pashlyera (467) vlera e detyrimeve të pashlyera është: viti 2017 në shumën 179,212,543 lekë, viti 2018 në shumën 234,762,573 lekë dhe viti 2019 në shumën 173,548,411 lekë. Ndërkohë të ardhurat për vitin 2017 janë realizuar në masën 50%, për vitin 2018 në masën 62% dhe për vitin 2019 – 53.7%, tregues që tregojnë për një planifikim të të ardhurave mbi një bazë jo reale. Fondet buxhetore të këtyre viteve paraqiten me nivel realizimi për vitin 2017 në masën 87 % dhe për vitin 2018 në masën 86% dhe për vitin 2019 në masën 82.9%. Në këtë nivel realizimi ka ndikuar realizimi në nivel më të ulët i shpenzimeve operative për vitin 2017 në masën 67%, për vitin 2018 në masën 73%, dhe 2019 në masën 63.7%. Po kështu dhe investimet për vitin 2017 në masën 85%, për vitin 2018 në masën 73% dhe 2019 në masën 82.9%.</p>
Kriteri	<p>Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, me UMF nr.5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, me Udhëzimin plotësues nr.2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”</p>
Ndikimi/Efekti	<p>Performancë e jo kënaqshme në lidhje me në lidhje me krijimin dhe shlyerjen e detyrimeve të papaguara.</p>
Shkaku	<p>Akumulimi i një borxhi të konsiderueshëm në fund të vitit 2019 në vlerën 173,548,411 lekë, ku një pjesë nga paaftësia pagueuse dhe një pjesë për arsye limiti të vendosur nga MFE, ka ndikuar në krijimin e faturave të prapambetura.</p>
Rëndësia:	<p>-I lartë.</p>
Rekomandimi	<p>a-Me qëllim që të mos krijohen diferenca të theksuara ndërmjet programimit dhe realizimit të treguesve të buxhetit, njësia publike Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa për hartimin sa më real të treguesve të buxhetimit, mbështetur në realizimin e</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

mundshëm e objektiv të të ardhurave. Njëkohësisht në çdo periudhë buxhetore të hartohet (PBA) dhe buxhetit vjetor të ndjek parashikimin e vitit të parë të PBA. b-Titullari i njësisë vendore dhe Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masa të plota për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 190,564,044 lekë, dhe të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkisë, informacion për gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe të mbartura dhe të hartojë grafik për shlyerje të tyre.

5-Titulli i gjetjes: Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2017, programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve.

Situata: **Për vitin 2017**, buxheti i Bashkisë Ura Vajgurore është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.4, datë 02.02.2017, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2017 të Bashkisë Ura Vajgurore”, në vlerën 409,895 mijë lekë.

Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2017, është bërë brenda afateve ligjore, sipas nenit 32 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për vitin 2018, buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.75, datë 26.12.2017, në vlerën 444,738 mijë lekë, si dhe me VKB nr.19, datë 20.03.2018 “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Ura Vajgurore për vitin 2018”, për shumën 7,835 mijë lekë, e cila përbëhet nga të ardhura të trashëguara 6,774 mijë lekë, transferta të trashëguara 1,061 mijë lekë.

Me VKB nr.19, datë 20.03.2018 “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Ura Vajgurore për vitin 2018”, për shumën 7,835 mijë lekë, e cila përbëhet nga të ardhura të trashëguara 6,773 mijë lekë, transferta të trashëguara 1,062 mijë lekë.

Për vitin 2019, buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.108, datë 24.12.2018, në vlerën 477,891 mijë lekë dhe me VKB nr.31, 33, datë 29.03.2019 “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Ura Vajgurore për vitin 2019”, për shumën 16.728 mijë lekë, e cila përbëhet nga shtesë plani të ardhurash 10,000 mijë lekë, nga të ardhura të trashëguara 4,522 mijë lekë, transferta të trashëguara 2,206 mijë lekë.

Buxheti sipas viteve përbëhet nga:

000/ lekë

Nr.	Burimet e buxhetit nga:	Vitet		
		2017	2018	2019
1	të ardhurat e vitit	210,000	210,000	231,547
2	transferta e pakushtëzuar	113,942	124,063	133,533
3	ardhurat e trashëguara	26,516	25,000	18,000
4	transferta specifike	57,517	67,673	79,811
5	ardhura të trashëguara nga donatorët	0	0	0
6	transfertat e trashëguara	1,920	18,002	15,000
	Totali	409,895	444,738	477,891

Burimi i të dhënave – Bashkia Ura Vajgurore

Nga krahasimi i planit të buxhetit 2017 me planin e vitit 2017 në PBA, rezulton një diferencë prej 144,209 mijë lekë, ku konstatohet se:

-Në buxhetin e vitit 2017, bëjnë pjesë **të ardhurat dhe shpenzimet e trashëguara** nga viti i kaluar të cilat në hartimin e PBA-së nuk planifikohen.

-**Shtesa e grantit të pakushtëzuar** për vitin 2017, është jashtë parashikimit në planin e vitit 2017 në PBA, transferimi i funksionit të M N Z etj. .



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Nëpërmjet grupit të punës për menaxhimin strategjik (GMS), ngritur nga Kryetari me urdhër nr.93, datë 24.01.2017, është hartuar PBA për periudhën 2017-2019 dhe është raportuar në Ministrinë e Financave në datë 01.06.2016 në mënyrë elektronike. Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projekt buxhet vjetore janë bërë konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, njësitë administrative, etj., gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare. Ky dokument është hartuar nga Drejtoria Financës dhe Buxhetit.

Për hartimin e buxhetit të vitit 2018, është miratuar Grupi i punës për strategji, buxhet dhe integrim (GSBI) me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 16, datë 11.01.2018.

Për hartimin e buxhetit të vitit 2019, është miratuar Grupi i punës për strategji, buxhet dhe integrim (GSBI) me urdhër të kryetarit të bashkisë nr. 208 datë 22.01.2019

Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e vitin 2017 dhe 2018, 2019 është planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse. Në varësi të vlerave të fondeve të çelura në thesar në fillim të vitit ushtrimor janë bërë edhe miratimet e buxhetit fillestar të bashkisë.

Për vitin 2017, nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se buxheti i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2017, është në vlerën 409,895 mijë lekë, për vitin 2018, në vlerën 452,573 mijë lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 494,619 lekë.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve të buxhetit vlera me të cilat është rakorduar me thesarin në fund të vitit, paraqitet:

Në 000 lekë

Vitet	Vlera e rakorduar me thesarin
2017	821,561
2018	804,245
2019	805,056

Burimi i të dhënave – Bashkia Ura Vajgurore

Ndryshimet gjatë vitit, brenda zërave të shpenzimeve, janë bërë ndryshimet e nevojshme të cilat janë miratuar në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Për vitin 2017, buxheti i Bashkisë Ura Vajgurore është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.4, datë 02.02.2017 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore”, është miratuar buxheti në vlerën 409,895 mijë lekë. Për vitin 2017, është miratuar buxheti me fondet e veta (ardhura + transfertë e pakushtëzuar + transfertat specifike) në shumën 409,895 mijë lekë. Gjatë vitit ka patur alokime fondesh nga FZH-ja, Ministrinë e linjës.

Për vitin 2018, buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.75, datë 26.12.2017, në vlerë 444,738 mijë lekë nga të ardhurat vendore, transfertat e pakushtëzuar dhe ajo specifike, me VKB nr.19 datë 20.03.2018 “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Ura Vajgurore për vitin 2018”, për shumën 7,835 mijë lekë. Për vitin 2018, është miratuar me fondet e veta (ardhura + transfertë e pakushtëzuar + transfertat specifike) në shumën 452,573 lekë. Gjatë vitit ka patur alokime fondesh nga FZH-ja, Ministrinë e linjës.

Për vitin 2019, buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

nr.108, datë 24.12.2018, në vlerë 477,891 mijë lekë nga të ardhurat vendore, transferata e pakushtëzuar dhe ajo specifike, me VKB nr. 31 e 33, datë 20.03.2018 “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Ura Vajgurore për vitin 2019”, për shumën 16,728 mijë lekë. Për vitin 2019, është miratuar me fondet e veta (ardhura + transfertë e pakushtëzuar + transferata specifike) në shumën 494,619 lekë. Gjatë vitit ka patur alokime fondesh nga FZH-ja, Ministrinë e linjës.

Bashkia Ura Vajgurore, për periudhën objekt auditimi ka trashëguar detyrime të prapambetura që nga vitet 2015 sipas tabelës sa vijon:

Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	(Detyrimi i mbartur deri në 31.12.2015)	Detyrimi i krijuar Viti 2016	Detyrimi i krijuar Viti 2017	Detyrimi i krijuar Viti 2018	Detyrimet e krijuara nga viti 2019
Vlera Totale	4,427,198	58,823,107	174,710,461	241,648,170	176,888,318
Investimet	0	37,459,065	115,200,365	161,090,384	124,475,224
TVSH dhe Kosto lokale	0	0	0	0	
Mallra dhe Shërbime	4,427,198	21,364,042	59,290,496	80,557,786	32,359,834
Vendime Gjyqësore	0	0	219,600		20,053,260
Të tjera	0	0	0	0	

Këto detyrime deri me datë 30.04.2020 janë shlyer sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	Totali i detyrimeve të shlyera	Detyrimi i mbetur
Vlera Totale	482,948,843	173,548,411
Investimet	303,554,621	134,670,417
TVSH dhe Kosto lokale	0	0
Mallra dhe Shërbime	177,773,331	20,226,025
Vendime Gjyqësore	1,620,891	18,651,969
Të tjera	0	0

Bashkia Ura Vajgurore, për vitin 2019 ka 5 raste detyrime përmbarimore për detyrim pagesë për largim nga puna me vlerë **3,311,948** dhe në 1 rast për pagesë të vonuar për një kompani, kamat vonesa me vlerë **16,640,021** lekë. Në vitin 2019 janë likuiduar **1,300,000** lekë për detyrime përmbarimore për pagesë page për largim nga puna. Në datë 31.12.2019 detyrimi për vendime gjyqësore është në vlerën **18,651,969** lekë. Për këto procese gjyqësore të humbura, Bashkia Ura Vajgurore nuk ka analizuar shkaqet e lindjes së tyre dhe nuk ka marrë masa ndaj personave përgjegjës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 62 dhe 102, me Udhëzimin nr.2, datë 09.01.2015, “Vendimet gjyqësore” pika 6.1, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar neni 12 pikën 3.

Kriteri

Udhëzimit të MFE nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 62 dhe 102, me Udhëzimin nr.2, datë 09.01.2015, “Vendimet gjyqësore” pika 6.1, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar neni 12 pikën 3.

Impakti

Detyrimet për vendime gjyqësore si rezultat i humbjeve të proceseve gjyqësore nga Bashkia Ura Vajgurore, kanë sjellë rritjen e detyrimeve ndaj të tretëve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Shkaku	Nga Titullari dhe nga Drejtoria Juridike nuk janë marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e konflikteve me palë të treta sipas dispozitave ligjore në fuqi, gjë që ka sjellë dhe humbjen e proceseve gjyqësore me të tretët, duke sjellë rritjen e detyrimeve
Rëndësia:	- I Lartë
Rekomandimi	Bashkia Ura Vajgurore, të nxjerrë përgjegjësitë ligjore e administrative ndaj personave shkaktarë të cilët kanë krijuar detyrimin prej 18,651,969 lekë për 6 vendimet gjyqësore çka ka ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit si dhe të marrë masa për planifikimin e fondeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

B/3 BURIMI I KRIJIMIT TË TË ARDHURAVE BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR LIGJOR/NËNLIGJOR NË FUQI, PËRDORIMI I TYRE. VLERËSIMI I MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE NË PËRPUTHJE ME DISPOZITAT LIGJORE DHE BORXHI TATIMOR; NIVELI ARKËTIMIT TË GJOBAVE TË VENDOSURA NGA IMTV, APO ORGANEVE TË TJERA.

1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
2. Vlerësimi i arsyeshem e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);
3. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë;
4. Opinioni mbi pasqyrat financiare;

Në Bashkinë Ura Vajgurore, për vitin 2017, ka funksionuar Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve, me 12 punonjës nga të cilët 1 Drejtor Drejtorie, 1 Kryeinspektor (Zyre/Terreni), 4 specialistë detyrimesh, 5 inspektorë taksash për njësitë administrative, 1 inspektorë terreni dhe licencimi.

Për vitin 2017, realizimi i taksave dhe tarifave vendore, rezulton se nga 210,000 mijë lekë të planifikuara është realizuar 105,882 mijë lekë ose 50.2% me mosrealizim 104 118 mijë lekë. Realizimin e të ardhurave vendore për vitet 2018, 2019 dhe 3 /mujori i vitit 2020, paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2017			2018			2019			% 3 m 1 2020
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	
	Të ardhura vendore gjithsej	210,000	105,882	50	210,000	130,280	62.04	241,547	133,109	55.1	53.7
I	Taksa Vendore	150,355	66,801	44	151,882	88,695	58.4	169,908	88,483	52.1	48.2
	Tatim Thjeshtuar Fitimin	1,000	1,495	150	1,500	922	61.47	1,650	1,302	78.1	9.3
2	Taksë Pasurie Paluajtshme	38,692	18,630	48	37,720	19,439	51.53	44,263	19,375	43.8	44.2
2.a	Taksë Ndërtese	14,194	9,442	67	12,702	9,508	74.85	19,377	10,206	52.7	53.6
	Taksë Ndërtese Banesa +subjekte	14,194	9,442	67	12,702	9,508	74.85	19,377	10,206	52.7	53.6
2. b	Taksë Tokë Bujqësore	22,998	7,875	34	23,259	7,863	33.81	23,075	8,149	35.3	38.6
2.c	Taksë Trualli	1,500	1,313	88	1,759	2,068	117.57	1,813	1,365	75.3	35.1
3	Taksë Fjetje në Hotel	20	5	25	13	0	0	14	19	135.7	0
4	Taksë Ndik. në Infr. nga Nd. Reja	10,000	9,329	93	10,500	8,070	76.86	11,550	9,932	86	50.8
5	Taksë Kalimit të Drej Pasurisë	100	2	2	100	27	27	110	38	34.6	0
6	Taksë Tabele	1,166	785	67	1,166	1,107	94.94	770	839	109	19.1



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Nr.	Emërtimi	Viti 2017			2018			2019			% 3 m 1 2020
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	
7	Taksë Reklame	301	613	204	435	311	71.49	991	427	43.1	0
8	Taksë Mjeteve të Përdorura +transf	10,000	8,534	85	10,500	12,951	123.34	11,550	14,924	129.2	124.13
9	Taksë Bagëti e therur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Taksë Tjera Taksa	0	0	0	32,449	14,598	45	37,677	9,454	25.1	0
	Taksa të ndara			0	460	0	0	506	0	0	0
10	Taksë e Përkohshme	35,652	5,592	16	0	0	0	0	0	0	0
10.a	Taksë Sip ndih. Funk. biznesit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
10.b	Taksë Tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
11	Debitorë	53,423	21,816	41	57,038	31,270	54.8	60,826	31,828	52.3	35.9
II	Tarifa Vendore	59,645	39,081	66	58,118	41,585	71.6	71,639	44,626	62.3	63.5
1	Qeratë	1,600	1,334	83	2,500	1,177	47.1	2,163	1,230	56.9	119.9
2	Taksë zenie e hap Publike	1,650	2,181	132	3,480	2,352	67.6	3,748	1,755	46.8	26.6
3	Tarifë Pastrimi	24,071	16,837	70	22,603	19,684	87.1	23,360	18,909	81	63.6
4	Tarifë Gjelbërimi	7,784	2,516	32	6,499	4,592	70.7	6,979	4,330	62	37.2
5	Tarifë Ndrëçimi	7,256	3,554	49	5,423	4,692	86.5	5,838	4,378	75	57.2
6	Tarifë leje transporti +parkim	1,300	1,482	114	1,480	1,061	72	1,628	1,533	94.2	106.6
7	Kopshte	500	553	111	560	704	125.7	650	647	99.5	99.5
8	Tarife nga ministria mei	0	4,292	0	0	1,731	0	0	692	0	0
9	Parkingu	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Të tjera tarifa urbanistikë. Licensë karburanti etj.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	57.3
10	Të tjera	1,731	323	19	3,550	1,473	41.5	4,665	1,422	30.5	65.3
	Taksë për ujitje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Taksë Pyjore	0	0	0	0	0	0	10,000	6,506	65.1	0
11	Të tjera Shërbime Admini.	13,753	6,009	44	12,023	4,113	34.2	12,608	3,224	25.6	0
	Taksa Vendore	150,355	66,801	44	151,882	88,695	58.4	169,908	88,483	52.1	48.2
	Tarifa Vendore	59,645	39,081	66	58,118	41,585	71.6	71,639	44,626	62.3	63.5
	Totale Gjithsej	210 000	105,882	50	210,000	130,280	62	241,547	133,109	55.1	53.7

Burimi i të dhënave – Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

Nga të dhënat e pasqyrës si më sipër konstatohet se disa taksa e tarifa krahasim me planin kanë tejkalime të ndjeshme, kjo tregon që planifikimi i të ardhurave të Bashkisë për periudhën objekt auditimi nuk është bërë i studiuar, ka pasur rezerva për rritjen e planit të këtyre taksave e tarifave dhe për disa nga taksat e tarifave vendore nuk është patur parasysh realizimi i një viti më përpara.

Për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 210,000 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 130,280 mijë lekë ose 62 % me një diferencë në vlerën 79,720 mijë lekë, e cila ka sjellë mosrealizimin e planit të investimeve dhe të disa shpenzimeve operative.

Për vitin 2019, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 241,547 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar 133,109 mijë lekë ose 55.1 % me një diferencë 108,438 mijë lekë.

Për 3/mujorin e parë të vitit 2020, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 55,103 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar **29,573** mijë lekë ose **53.6 %**.

Taksa e tokës planifikohet nga Drejtoria e Bujqësisë, Aseteve dhe Pyjeve dhe mbledhet nga Drejtoria Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve Nga të dhënat rezulton se kanë përfituar tokë bujqësore 7,317 familje me sipërfaqe 9,249 ha, sipas pasqyrës më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Njësia vendore	Tokë bujqësore gjithsej (ha)	Tokë për t'u ndarë ha	Tokë e ndarë ha	Tokë e pandarë ha	Nr. i familjeve që kanë marrë tokë
Qendër Urë	1,570.00	1,500.00	1,300.00	200.00	1,160.00
Poshnje	3,200.00	3,120.00	2,986.00	134.00	2,360.00
Kutalli	3,680.00	3,650.00	3,306.00	344.00	2,774.00
Cukalat	1,916.00	1,900.00	1,657.00	243.00	1,023.00
Shuma	10,376.00	10,170.00	9,249.00	921.00	7,317.00

Burimi i të dhënave – Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Ura Vajgurore.

Planifikimi i taksës së tokës për vitet 2017, 2018, 2019, është llogaritur si tokë e kategorisë nga I-X me nivel takse nga 1,400 lekë /ha/vit – 4,200 lekë/ha/vit.

Planifikimi dhe realizimi i taksës së tokës paraqitet sa vijon;

Viti	planifikuar	realizuar	mosrealizimi	%
2017	22,998	7,875	15,213	34.2
2018	23,259	7,863	15,396	34.2
2019	23,075	8,149	14,926	35
3 mujori e parë/2020	5,613	2,166	3,447	38.6

Burimi i të dhënave – Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Ura Vajgurore.

Ndërsa sipas njësive bashkiake, tokës së ndarë dhe numrit të familjeve paraqitet sa më poshtë:

Nr	Njësia vendore	Tokë e ndarë ha	Nr. i familjeve që kanë marrë tokë	Viti 2017			Viti 2018		
				Plani 000/lek	Fakti		Plani 000/lek	Fakti	
					Nr. Fam. që kanë paguar	000/lek		Nr. Fam. që kanë paguar	000/leke
1	Qendër Urë	1,300	1,160	3,000	296	1,387	3,420	462	1,053
2	Poshnje	2,986	2,360	9,200	681	4,024	9,200	992	2,407
3	Kutalli	3,306	2,774	8,198	667	1,914	8,385	980	3,864
4	Cukalat	1,657	1,023	2,600	256	550	2,254	301	539
	Shuma	9,249	7,317	22,998	1,900	7,875	23,259	2,735	7,863

Burimi i të dhënave – Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Ura Vajgurore.

Nr	Njësia vendore	Tokë e ndarë ha	Nr. i familjeve që kanë marrë tokë	Viti 2019			Viti 2020		
				Plani 000/lek	Fakti		Plani 000/lek	Fakti	
					Nr. Fam. që kanë paguar	000/lek		Nr. Fam. që kanë paguar	000/lekë
1	Qendër Urë	1,300	1,160	3,470	308	1,703	759	139	558
2	Poshnje	2,986	2,360	9,200	912	3,684	2,036	276	631
3	Kutalli	3,306	2,774	8,152	898	2,308	2,254	126	450
4	Cukalat	1,657	1,023	2,253	288	454	564	263	527
	Shuma	9,249	7,317	23,075	2,406	8,149	5,613	804	2,166

Burimi i të dhënave – Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Ura Vajgurore.

Konkluzion: Nga të dhënat e pasqyrave si më sipër rezulton se për vitin 2019, nuk kanë paguar taksën e tokës me tarifat përkatëse, 7,531 familje në shumën 166,711,179 lekë, taksa lokale dhe tarifat 909 familje në shumën 9,010,940 lekë, si dhe 210 familje për qiranë e tokës bujqësore në vlerën 12,228,661 lekë të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019, sipas njësive si më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Nr.	Njësia administrative	Lloji i taksës	Numër familje	Vlera
1	Ura Vajgurore	taksë toke dhe tarifa lokale	923	15,894,282
		taksa lokale dhe tarifa lokale	909	9,010,940
2	Kutalli	taksë toke dhe tarifa lokale	2,906	67,889,981
		qira e tokës bujqësore.	208	12,183,538
3	Poshnjë	taksë toke dhe tarifa lokale	2,597	63,479,466
4	Cukalat	taksë toke dhe tarifa lokale	1,105	19,448,050
		qira e tokës bujqësore	2	45,123
Totali			8,650	187,951,380

Burimi i të dhënave – Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

4/1 Mbi planifikimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore nga popullata.

Nga auditimi i planifikimit dhe mbledhjes së taksave e tarifave vendore nga popullata për periudhën objekt auditimi, planifikimi dhe realizimi i tyre paraqitet:

Emërtimi taksës	Viti 2017					Viti 2018				
	Plani		Fakti		Mos realiz.	Plan		Fakt		Mos realiz
	Familje	000/lekë	Familje	000/		Familje	000/	Fam.	000/le	
Ndërtese	8,557	4,415	2,400	2,589	1,826	7,559	3,899	3,185	2,949	950
Pastrimi	8,557	10,757	2,400	4,899	5,858	7,559	9,701	3,185	7,346	2,355
Ndriçimi	8,557	5,406	2,080	1,899	3,507	4,279	3,328	2,798	2,580	748
Gjelbërimi	8,557	6,004	2,400	1,602	4,402	7,559	5,296	3,185	3,332	1,964
Totali		26,582		10,989	15,593		22,224		16,027	6,017

Burimi i të dhënave – Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

Emërtimi taksës	Viti 2019					Viti 2020				
	Plani		Fakti		Mos realiz	Plan		Fakt		Mos realiz
	Familje	000/lekë	Familje	000/lekë		Familje	000/leke	Familje	000/lekë	
Ndërtese	8,640	12,432	3,201	7,737	4,695	8,091	3,608	891	2,039	1,569
Pastrimi	6,452	10,470	3,201	6,275	4,195	7,386	2,560	883	1,628	932
Ndriçimi	7,725	5,838	2,838	4,377	1,461	4,960	860	891	492	368
Gjelbrimi	8,412	6,979	3,201	4,329	2,650	7,869	1,269	887	472	797
Totali		35,719		22,718	13,001		8,297		4,631	3,666

Burimi i të dhënave – Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

Konkluzion: Për vitin 2019, nuk kanë paguar taksë ndërtese, pastrimi, ndriçimi e gjelbërm 5439 familje në shumën 13001 mijë lekë, të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019.

4/2 Kontrollat e bëra për grumbullimin e taksave, rakordimi me agjentet tatimor, problemet e dala dhe masat e marra.

Një numër i vogël, subjektsh në pamundësi likuiditeti kanë lidhur aktmarrëveshje të pagesës me këste për periudha të gjata. Nga drejtoria e taksave është bërë korrespondence dhe është kërkuar informacion nga agjentët tatimor për mënyrën e mbajtjes së detyrimeve, datat dhe vlerat e vjeljes dhe transferimit të tyre në buxhetin lokal. Bazuar në afatet ligjore të përcaktuara në paketat fiskale për mbledhjen dhe transferimin në buxhet të ardhurave nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

taksat vendore si dhe në akt rakordimet dhe të dhënat nga financa, rezultojnë se në total vlera e akt rakordimeve me xhirimet e bëra të konfirmuara nga financa përputhen,

Për vitin 2017, kanë ushtruar aktivitet 612 subjekte të biznesit të vogël dhe 120 subjekte të biznesit të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore. Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi rezultojnë se nga Drejtoria e Tatimit Taksave për abonentët familjarë ka regjistruar, për evidentimin e vlerës së detyrimit që ato kanë paguar. Nga të dhënat rezultojnë se Drejtoria e Taksave Vendore për subjektet debitorë ka nxjerrë, njoftim për pagesë vullnetare nr. 1792-1792/13 prot. datë 21/07/2017, nr.1914-1914/12, datë 15/08/2017, nr. 1915-1915/22, datë 15/08/2017, nr. 1916-196/10 datë 15/08/2017, nr. 1917-1917/10, datë 15/08/2017, nr. 1996-1996/14, datë 30/08/2017, nr. 2000-2000/21, datë 31/08/2017, nr. 1996-1996/14, datë 31/08/2017, nr. 1996-1996/10, datë 30/08/2017 si dhe i ka dërguar bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit si me poshtë: urdhër bllokim nr. 2160-2160/6 , datë 20/09/2017, nr. Prot. 2159-2159/4, datë 20/09/2017, nr. 2161-2161/5, datë 20/09/2017, 2162-2162/5 datë 20/09/2017, me vlerë 8,979,139 lekë.

Shuma e detyrimeve të arkëtuara nga procedura e urdhër bllokimit është **2,453,591 lekë.**

Kanë mbetur pa u arkëtuar 6,525,548 lekë.

Për vitin 2018, kanë ushtruar aktivitet 610 subjekte të biznesit të vogël dhe 118 subjekte të biznesit të madh, për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore. Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi rezultojnë se nga Drejtoria e Tatimit Taksave, për abonentët familjarë ka regjistruar, për evidentimin e vlerës së detyrimit që ato kanë paguar. Nga të dhënat rezultojnë se Drejtoria e Taksave Vendore për subjektet debitorë ka nxjerrë, njoftim për pagesë vullnetare nr. 659-659/14, datë 12.04.2018, nr. 660-660/22, datë 12.04.2018, nr. 661-661/22, datë 12.04.2018, nr. 662-662/22, datë 12.04.2018, nr. 676-676/22, datë 13.04.2018, nr. 677-677/12, datë 13.04.2018, nr. 678-678/2, datë 13.04.2018, nr. 679-679/22, datë 13.04.2018, nr. 680-680/22, datë 13.04.2018, njoftim vlerësimet nr. 1914 - 1914/1, datë 15/08/2018, si dhe Urdhër Bllokimit të Bankave të Nivelit të dytë me nr. protokollin 2370-2370/1, datë 08.10.2018, me vlerën prej **4,703,597 lekë.**

Shuma e detyrimeve të arkëtuara nga procedura e urdhër bllokimit është **1,406,362 lekë.**

Kanë mbetur pa u arkëtuar 3,297,235 lekë.

Për vitin 2019, kanë ushtruar aktivitet 592 subjekte të biznesit të vogël dhe 118 subjekte të biznesit të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore. Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi rezultojnë se nga Drejtoria e Tatimit Taksave për abonentët familjarë ka regjistruar, për evidentimin e vlerës së detyrimit që ato kanë paguar. Nga të dhënat rezultojnë se Drejtoria e Taksave Vendore për subjektet debitorë ka nxjerrë, njoftim për pagesë vullnetare nr. 1411-1411/3, datë 11/06/2019, nr. 758/10, datë 24/05/2019, nr. 844-844/8, datë 23/05/2019, nr. 1550-1550/3, datë 24/06/2019, nr. 1550-1550/3, datë 24/06/2019, letër kujtese nr. 1308-1308/4, datë 05/08/2019, nr. 1550-1550/9, datë 08/07/2019, nr. 1550-1550/9, datë 08/07/2019, nr. 354-354/48, datë 08.08.2019, urdhër bllokimit bankave të nivelit të dytë, nr. 2467-2467/18, datë 17/09/2019, nr. 2148-2148/11, datë 16/09/2019, nr. 2467 datë 17/09/2019, nr. 2466-2466/10, datë 17/09/2019, urdhër bllokimit nr. 2104-2104/19, datë 23/08/2019, urdhër bllokimit nr. 2316-2316/14, datë 06/09/2019, nr. 2183-2183/9, datë 04/09/2019.

Vlera e bllokuar është në shumën 8,066,293 lekë.

U është dërguar njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekare dhe siguruese, nr. 2217-2217/5, datë 02/09/2019, nr. 2790-2790/21, datë 11/10/2019, nr. 2590-2590/12 datë 26/09/2019, urdhër sekuestrimi ekzekutiv, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Berat, si dhe Regjistrin të Barrëve Siguruese, nr. 2662-2662/6, datë 01/10/2019, urdhër sekuestrimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

ekzekutiv, nr. 2662-2662/16, datë 28/10/2019, nr. 2980-2980/13, datë 23/10/2019, nr. 3025, datë 04/11/2019, nr. 3231 - 3231/9, datë 25/11/2019, nr. 3232-3232/4 datë 25/11/2019, nr. 2622-2622/22, datë 22/11/2019.

Shuma e detyrimeve të arkëtuara nga procedura e urdhër bllokimit është **4,346,160 lekë**.

Kanë mbetur pa u arkëtuar 3,720,133 lekë.

Konkluzion:

1- Nga subjekte të biznesit të vogël dhe të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore pavarësisht punës së bërë niveli i arkëtimit është shumë i ulët

Për vitin 2017. Shuma e detyrimeve të arkëtuara nga procedura e urdhër bllokimit është 2,453,591 lekë. Kanë mbetur pa u arkëtuar 6,525,548 lekë.

Për vitin 2018, Shuma e detyrimeve të arkëtuara nga procedura e urdhër bllokimit është 1,406,362 lekë. Kanë mbetur pa u arkëtuar 3,297,235 lekë.

Për vitin 2019 Shuma e detyrimeve të arkëtuara nga procedura e urdhër bllokimit është 4,346,160 lekë. Kanë mbetur pa u arkëtuar 3,720,133 lekë.

Në total për tre vitet nuk janë arkëtuar: 13,542,916 lekë.

6. Titulli i gjetjes: Nga auditimi KLSH konstaton se, nga subjekte të biznesit të vogël dhe të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore pavarësisht punës së bërë niveli i arkëtimit është shumë i ulët 37%

Situata:

1-Nga të dhënat rezulton se për vitin 2019, nuk kanë paguar taksën e tokës me tarifën përkatëse, 7,531 familje në shumën 166,711,179 lekë, taksa lokale me tarifën përkatëse, 909 familje në shumën 9,010,940 lekë, si dhe 210 familje për qiranë e tokës bujqësore në vlerën 12,228,661 lekë të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019, sipas njësive si më poshtë:

Nr.	Njësia administrative	Lloji i taksës	Numër familje	Vlera
1	Ura Vajgurore	taksë toke dhe tarifën lokale	923	15,894,282
		taksa lokale dhe tarifa lokale	909	9,010,940
2	Kutalli	taksë tokedhe tarifën lokale	2,906	67,889,981
		qira e tokës bujqësore.	208	12,183,538
3	Poshnjë	taksë toke dhe tarifën lokale	2,597	63,479,466
4	Cukalat	taksë toke dhe tarifën lokale	1,105	19,448,050
		qira e tokës bujqësore	2	45,123
Totali			8,650	187,951,380

Për vitin 2019, nuk kanë paguar taksë ndërtese, pastrimi, ndriçimi e gjelbërimi 5439 familje në shumën 13001 mijë lekë, të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019.

Në Bashkinë Ura Vajgurore nga subjekte të biznesit të vogël dhe të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore pavarësisht punës së bërë niveli i arkëtimit është shumë i ulët. Kështu nga 21,749,029 lekë për vitet objekt auditimi janë arkëtuar vetëm 37.7% kanë mbetur pa u arkëtuar 13,542,916 lekë.

Kriteri

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“Mbledhja me forcë e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

detyrimeve tatimore të papaguara”

Impakti

Shkaku

Rëndësia:

Rekomandimi

Ndikim në mungesë në të ardhurat e Bashkisë Mosmbledhja e detyrimeve.

- I Lartë.

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Ura Vajgurore të merren masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 118 subjekte debitorë në shumën 23 615 358 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a - Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b - Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Ura Vajgurore, të listohen në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës për vlerën 187 951 380 lekë, të ndarë si më poshtë:

I.Njësia Administrative Urë Vajgurore

1.Për 923 abonentë për taksa toke dhe tarifa lokale në vlerën 15,894,282 lekë 2.909 abonentë për taksa dhe tarifa lokale në vlerën 9,010,940 lekë

II.Njësia Administrative Kutalli

1.2906 abonentë për taksa toke dhe tarifa lokale në vlerën 67,889,981 lekë 2.208 abonentë për qiranë e tokës bujqësore, në vlerën 12,183,538 lekë

III.Njësia Administrative Poshnjë

1.2597 abonentë për taksa toke dhe tarifa lokale, në vlerën prej 63,479,466 lekë

IV.Njësia Administrative Cukalat

1.1105 abonentë për taksa toke dhe tarifa lokale, në vlerën prej 19,448,050 lekë

2.2 tatimpagues debitorë për qiranë e tokës bujqësore, në vlerën 45,123 lekë

a- Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale të Bashkisë për të paguar detyrimin tatimor. Njoftim Vlerësimet t’ju dërgohen nëpërmjet Zyres Postare, për të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, ndërtesës dhe tarifatat të tjera të pa paguara.

4/3 Masat e marra për personat fizikë e juridikë që nuk likuidojnë taksat dhe tarifatat vendore dhe ushtrojnë aktivitet pa qenë të regjistruar në QKR.

Nga auditimi i dokumenteve dhe të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ndër vite nga ish komunat janë përcjellë detyrime tatimore të subjekteve që kanë ushtruar veprimtari biznesi pa qenë të regjistruar në QKR.

Konkluzion: Buxhetit të Bashkisë për periudhën objekt auditimi nga mos regjistrimi në vite në QKR nga ish komunat janë përcjellë detyrime tatimore të subjekteve që kanë ushtruar veprimtari biznesi pa qenë të regjistruar në QKR, llogarit mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë në vlerën 219,664 lekë e ndarë: NJA Ura Vajgurore për 4 subjekte në vlerën 146,264 lekë, NJA Kutalli për 2 subjekte me vlerë 77,040 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Bashkia Ura Vajgurore			
Nr	Emri mbiemri	Detyrimi i maturuar	Debitor 31.03.2020
1	H-K.	35,216	35,216
2	G.B.	35,216	35,216
3	E-D.	36,976	36,976
4	P.Gj.	35,216	35,216
	Shuma	142,624	142,624
Njësia Administrative Kutalli			
1	L. H.	51,020	51,020
2	I. V.	26,020	26,020
	Shuma	77,040	77,040
	Shuma totale	219,664	219,664

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

Duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 40 -Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare, ku në pikën 1,

7 Titulli i gjetjes : Nga auditimi KLSH konstaton se, në Bashkinë Ura Vajgurore kanë ushtruar aktivitet 6 subjekte të cilët nuk janë të regjistruar në QKR, duke i shkaktuar efekt negativ buxhetit të kësaj njësie vendore nga mungesa e të ardhurave në vlerën 219,664 lekë.

Situata:

Nga auditimi i dokumenteve dhe të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ndër vite nga ish komunat janë përcjellë detyrime tatimore të subjekteve që kanë ushtruar veprimtari biznesi pa qenë të regjistruar në QKR. Buxhetit të Bashkisë për periudhën objekt auditimi nga mos regjistrimi në vite në QKR nga ish komunat janë përcjellë detyrime tatimore të subjekteve që kanë ushtruar veprimtari biznesi pa qenë të regjistruar në QKR, llogarit mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë në vlerën 219,664 lekë e ndarë: NJA Ura Vajgurore për 4 subjekte në vlerën 146,264 lekë, NJA Kutalli për 2 subjekte me vlerë 77,040 lekë

Kriteri

Neni 40 e 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Impakti

Shkaku

Rëndësia:

Rekomandimi

Ndikim në mungesë në të ardhurat e Bashkisë

Mos mbledhja e detyrimeve

-I Lartë

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Ura Vajgurore të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore duke kërkuar regjistrimin e NJA Ura Vajgurore për 4 subjekte në vlerën 146,264 lekë, NJA Kutalli për 2 subjekte me vlerë 77,040 lekë, të cilët kanë ushtruar aktivitetet të pa licencuar.

4/4 Gjendja e debitorëve për taksë e tarifa më datë 31.12.2019, nxjerrja e përgjegjësisë, llogaritja sanksioneve për mospagimin në afat.

Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se më datën 31.12.2019, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë **95 subjekte të biznesit të vogël, 23 të biznesit të madh, të cilët nga të dhënat e zyrës së financës janë kontabilizuar, në vlerën prej 23,615,358 lekë.**

Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël për subjekte në vlerën 4,740,225 lekë, (NJA Ura Vajgurore, për 19 subjekte në vlerën 1,098,625 lekë, NJA Kutalli 69 për subjekte në vlerën 3,331,276 lekë, NJA Poshnjë për 4 subjekte në vlerën 155,854 lekë, NJA Cukalat për 3 subjekte në vlerën 154,470 lekë).

Në vlerën e mësipërme është përfshirë dhe shuma e vlerës debitorë për subjekte të Njësive Administrative Kutalli të lënë nga KLSH me procesverbalin nr. 18 datë 12.05.2017, për subjekte 28 biznes i vogël me vlerë 1,060,440 lekë sipas Aneksit B/1,2,3.

Debitorët e biznesit të madh për 23 subjekte në vlerën 18,875,133 lekë, (NJA Ura Vajgurore, për 18 subjekte në vlerën 18,481,544 lekë, NJA Kutalli për 2 subjekte në vlerën 116,291 lekë, NJA Poshnjë 3 për subjekte në vlerën 277,298 lekë). Në vlerën e mësipërme është përfshirë dhe shuma e vlerës debitorë për 3 subjekte të NJA Ura Vajgurore, të lënë nga KLSH me procesverbal nr.18 datë 12.05.2017, për 3 subjekte biznes i madh me vlerë 7,490,440 lekë.

Pasqyra përmbledhëse numër subjektesh/vlere debitorë sipas njësive dorëzuar në financë për vitin 2019

Nr.	Njësia Administrative	Biznesi Vogël		Biznesi Madh		Totali	
		Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	Ura Vajgurore	19	1,098,625	15	10,991,504	39	12,090,129
2	Kutalli	41	2,270,836	2	116,291	71	3,447,567
3	Poshnjë	4	155,854	3	277,298	7	433,152
4	Cukalat	3	154,470	-	-	3	154,470
	Debitorë 31.12.2019	67	3,679,785	20	11,385,093	97	15,064,878

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

Debitorë Kutalli lënë nga KLSH në vitin 2017

Njësia Administrative	Biznesi Vogël		Biznesi Madh		Totali	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Kutalli + Urë Vajgurore	28	1,060,040	3	7,490,440	31	8,550,480
Total	95	4,740,225	23	18,875,133	118	23,615,358

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

Konkluzion: Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se më datën 31.12.2019, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë **95 subjekte të biznesit të vogël, 23 të biznesit të madh, të cilët nga të dhënat e zyrës së financës janë kontabilizuar, në vlerën prej 23,615,358 lekë.**

4/5- Mbi admimistrimin dhe dhënien me qira të aseteve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Në lidhje me auditimin mbi administrimin e aseteve, procedurën e dhënies me qira të aseteve të qëndrueshme (pa tokën bujqësore) në varësi të Bashkisë, menaxhimi i aseteve, identifikimi i gjendjes fizike, teknike dhe juridike për përdorimin e vënien në efikasitet për krijimin e të mirave publike për komunitetin, administrimin e plotë të tyre nga Bashkia në plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga përdorimi i tyre, në zbatim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, të Udhëzimit nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore” për periudhën 01.07.2017 deri më datën 31.03.2020, rezultojnë si në vijim: Në auditimin e kryer për procedurat e dhënies me qira të objekteve pronë e Bashkisë dhe e ndërmarrjeve shtetërore në varësi ose nën juridiksionin e bashkisë, u auditua dokumentacioni për periudhën 01.01.2017 deri më datën 31.03.2020, në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, konstatohet se nga Bashkia Ura Vajgurore është vepruar për të dhënë me qira pasuri shtetërore dhe sipërfaqet pyjore dhe kullimore me kontrata qiraje, me subjektet e trajtuara në vijim përkatësisht:

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Kontrata numër datë	Sip/ha	Afati	Likuiduar lekë/vit
1	L. T.	Tregti me pakicë	nr. 1679/1, 18/07/17	9.18 m ²	1 vit	14400
2	L. T.	Tregti me pakicë	nr. 1087/1, 23/05/18	9.18 m ²	1 vit	14400
3	E. H.	Tregtim ushqim i shpejtë	nr. 2951 25/10/19	12 m ²	1 vit	14400

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

Për subjektet që operojnë në fondin pyjor, janë dërguar njoftimet nr. 1960/1 datë 04/09/2017, dhe nr. 1960/2, datë 04/09/2017, për ndalimin e cënueshmërisë së fondit pyjor dhe për ndjekjen e procedurave të heqjes së sipërfaqes nga fondi pyjor.

Subjektet që kanë bërë heqjen nga fondi pyjor janë:

- “S.” shpk vlera e paguar është 6,506,000 lekë
- “V. L.” shpk, ka aplikuar për heqjen nga fondi pyjor, është hartuar raporti teknik nga ana e Bashkisë Urë Vajgurore.
- “B.” shpk ka aplikuar për heqjen nga fondi pyjor dhe është hartuar raport teknik nga ana e Bashkisë Urë Vajgurore.

4/6- Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) (2017-31 mars 2020).

- Për periudhën **01.01.2017 - 31/12/2017**, është vendosur 1 gjobë në masën 500,000 lekë, P.B. Ura Vajgurore, e cila është në fazën e gjykimit në GJA të Apelit, Tiranë.
- Për periudhën **01.01.2018 - 31.12.2018**, janë vendosur 2 gjoba në shumën 60,000 lekë.
- Për **vitin 2019**, janë vendosur 18 gjoba të detajuara, në vlerën 2,700,000 lekë, sa vijon:

Nr.	Emri Mbiemri	Gjoba
1	A.K.	50,000
2	A. D.	10,000
3	K. G.	50,000
4	R. K.	50,000
5	M. V.	50,000
6	H. V.	50,000
7	Sh. B.	50,000
8	K. T.	50,000
9	H. K.	50,000



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

10	F. O.	50,000
11	B. S.	50,000
12	B. P.	50,000
13	V. T.	50,000
14	J. K.	50,000
15	H. T.	50,000
16	T. M.	500,000
17	K. D.	500,000
18	F. Z.	500,000
19	G. M., Çështja është në proces gjyqësor ne gjykatën administrative te shkalles se pare Vlore, me objekt shfuqizim akti vendim dënimi.	500,000
	Shuma	2,710,000

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

Për vitin 2019, janë arkëtuar 250,000 lekë, për 5 subjekte.

- **Për periudhën 01.01.2020 - 31.03.2020**, është vendosur një gjobë në shumën prej 500,000 lekë, për I. G. në vlerën prej 500,000 lekë.

Çështja është në shqyrtim në gjykatën administrative të shkallës së parë Vlorë.

Konkluzion: nga auditimi vjeljes së gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor për periudhën deri 31.12.2019 janë pa arkëtuar 2,020,000 lekë.

4/7- Mbi vjeljen e detyrimeve të taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI.

Në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, ku cilësohet: “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.” për Bashkinë Ura Vajgurore për periudhën objekt auditimi, kjo taksë për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, është në masën 0.5% e vlerës në lekë e investimit të ri (objektit për legalizim). Vlera e objektit llogaritet sipas sipërfaqes përkatëse me koston mesatare të ndërtimit të nxjerrë nga EKB.

- Nga ana e kësaj Bashkie janë kryer veprime për ndërtimet informale në territorin e saj, ku për vitin 2017 – janë 256, për vitin 2018, - janë 123, për vitin 2019 – janë 84, dhe për vitin 2020, muaji janar dhe shkurt, janë proceduar 20 veprime respektivisht në tabelën e mëposhtme:

NJA	2017				2018				2019				3m I 2020			
	Total	Banime	Shërbime	Të kombinuara	Total	Banime	Shërbime	Të kombinuara	Total	Banime	Shërbime	Të kombinuara	Total	Banime	Shërbime	Të kombinuara
Urë Vajgurore	28	24	4		16	11	5	-	30	24	5	1	34	34	0	-
Poshnjë	34	28	6		22	19	2	1	47	41	4	2				
Kutalli	184	178	3	3	43	35	6	2	6	5	1	0				
Cukala	10	10	0	0	42	38	2	2	1	1	0	0	1	1		
Totali	256	240	13	3	123	103	15	5	84	71	10	3	35	35	0	0

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

Për periudhën nga 01.01.2017 deri ne 31.03.2020, objektet të cilat janë pajisur me leje legalizimi për të cilat është përlogaritur **taksa ndikimit në infrastrukture nga**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

D.P.T.SH.I.P janë 498 total, nga te cilat 449 objekte banimi, 38 objekte social-ekonomike dhe 11 objekte të kombinuara.

Të ardhurat e mbledhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi për periudhën 01.01.2017 deri 31.03.2020, janë si në tabelën më poshtë:

Njësia Administrative	viti 2017	viti 2018	viti 2019	3 mujori 2020
Urë Vajgurore	760,244	230,085	777,806	986705
Poshnjë	1,131,446	622,938	1,240,981	0
Kutalli	5,648,875	1,587,505	279,184	0
Cukala	245,433	1,145,625	22,684	42589
Totali	7,785,998	3,586,153	2,320,655	1,029,293

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

Në Bashkinë Ura Vajgurore për vitin 2017-2019 dhe 3 mujorin e parë 2020 për vjeljen dhe grumbullimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë bazuar në VKM. Nr.860 datë 10.12.2014 janë paisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZN-it 449 objekte banimi, 38 objekte shërbimi, dhe 11 objekte të kombinuara . Për të gjithë objektet 498 në total, është shlyer taksën e ndikimit në infrastrukturë

Nuk është dërguar Drejtorisë ALUIZN-it kërkesë bashkëpunimi për dërgim subjektsh e lista të qytetarëve që kanë përfunduar procesin e legalizimit dhe për listën e debitorëve për pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastruktur për ndërtimet pa leje

Sa më sipër arrihet në **konkluzionin** që:

1- Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se më datën 31.12.2019, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë **95 subjekte të biznesit të vogël, 23 të biznesit të madh, të cilët nga të dhënat e zyrës së financës janë kontabilizuar, mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 23,615,358 lekë .**

2- Nga auditimi vjeljes së gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor për periudhën deri 31.12.2019 janë pa arkëtuar **2,020,000 lekë.**

3- Për vitin 2020, kanë ushtruar aktivitet 6 subjekte pa qenë të regjistruar në QKR, buxhetit të Bashkisë për periudhën objekt auditimi nga mos regjistrimi i këtyre subjekteve, llogaritet **mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 219,664 lekë,** (NJA Ura Vajgurore, për 5 subjekte në vlerën lekë 142,624 NJA Kutalli për 2 subjekte në vlerën 77,040 lekë).

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, pika 7, neni 3, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 40, pika 1, neni 41, pika 1, 2, 3, të ligjit nr. 9920, ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 90, 91 dhe neni 114.

4/8- Për lidhjen e kontratave të qirasë me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare (për aktivitet shfrytëzim guri gëlqeror) dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrjnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi,

Nga Bashkia Ura-Vajgurore nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare (për aktivitet shfrytëzim guri gëlqeror) dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrjnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, në shkëlqje të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor” i ndryshuar, për të cilët nga auditimi ka rezultuar se nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore janë bërë njoftim detyrimi për heqje nga fondi pyjor. Nga auditimi rezultoi se nga 19 subjekte:

- Vetëm një subjekt ka lidhur kontratë vetëm një subjekt:

Subjekti	Nipt	Leje minerale	Sip ha
S. sh.p.k	J.....G	1632 datë 10.06.2013	16.2

- 3 prej tyre kanë aplikuar për heqje nga fondi, pyjor. Nga ana e Bashkisë Urë Vajgurore është hartuar raporti teknik, në Ministrinë e Mjedisit, nuk ka kthim përgjigje nga kjo e fundit, e konkretisht subjektet:

Nr	Subjekti	Nipt	Leje minerale	Sip ha
1	“V. Ll.”sh.p.k	K.....U	Nr. 875/2, datë 21.05.2015	3,8
2	“V. Ll.”sh.p.k	K.....U	Nr. 1659, datë 27.08.2013	19,4
3	“B.” sh.p.k	J.....N	Nr. 969, datë 05.09/2006	10

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

- Ndërsa 14 subjekte që kanë lejen e shfrytëzimit nga viti 2012 e në vazhdim, ë cilat nuk kanë lidhur kontratë janë sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Nr	Subjekti	Nipt	Leje minerale	Sip ha
1	T. sh.p.k	K.....G	623/1 20.02.2012	1,4
2	S. sh.p.k	J.....G	685/1 11.03.2013	1,5
3	G. B. sh.p.k	K.....O	697/1 22.05.2013	8,94
4	Sh. sh.p.k	J.....F	728/1 13/06/2014	3
5	2 P. 6 SH.P.K	K.....M	739/1 09.06.2014	5,6
6	A. K. sh.p.k	K.....E	742/1 09.02.2015	12,1
7	R. sh.p.k	J.....C	778 26.07.2004	4
8	A. sh.p.k	K.....B	793/1 9/02/2015	2,15
9	R. P. sh.a	J.....A	889 11.07.2005	5,4
10	S. sh.p.k	J.....G	911/1 19.11.2015	9,11
11	R. P. sh.a	J.....A	929 15.02.2006	4,7
12	A. sh.p.k	K.....P	1577 07.09.2012	9,8
13	M. sh.p.k	K.....H	1378 24.06.2009	18
14	A. sh.p.k	K.....B	1658 26.08.2013	7,7
			Shuma	

Burimi i të dhënave – Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Ura Vajgurore.

Konkluzion: Në Bashkinë Ura Vajgurore ushtrojnë aktivitet për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullësore 17 subjekte për sipërfaqe 35 ha, është lidhur 1 kontratë qiraje, për sipërfaqe 16.2 ha. Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit, nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullësor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullësor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor”

8 Titulli i Gjetjes: Nga Bashkia Ura-Vajgurore nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare (për aktivitet shfrytëzim



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

guri gëlqeror) dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi.

<u>Situata:</u>	Në Bashkinë Ura Vajgurore ushtrrojnë aktivitetet për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullimore 17 subjekte për sipërfaqe 35 ha, është lidhur 1 kontratë qiraje, për sipërfaqe 16.2 ha. Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit, nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullimosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullimosor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullimosor”
<u>Kriteri:</u>	Neni 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar
<u>Impakti:</u>	Nuk jep siguri të mjaftueshme për përmbushjen dhe zbatimin e ligjit për funksionin dhe detyrat që ka.
<u>Shkaku:</u>	Nga neglizhenca dhe nga mos këmbëngulja në zbatimin e ligjit, për mos mbledhjen dhe arkëtimin e kësaj tarife.
<u>Rëndësia:</u>	E lartë
<u>Rekomandimi:</u>	Sektori i pyjeve dhe mbrojtjes mjedisit në Bashkinë Ura Vajgurore, t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullimosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme

4/9 – mbi vjeljen e tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni: Dokumentet evidencat për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Ura Vajgurore, për periudhën e viteve, 2017,2018, 2019 dhe tre mujori i parë 2020.

Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e autorizimeve/licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, përse i përket arkëtimin të ardhurave për taksën



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Ura Vajgurore.

Referuar kapitullit II, kapitullit III, pika 4, të VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, si dhe Referuar kapitullit II, pikës 1; germës “b” të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar, Auditimi u krye për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë, për periudhën 01.01.2017 -30.03.2020.

Në lidhje me auditimin e kryer, mbi legjislacionit të taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, (autorizime), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, u konstatua se në Bashkinë Ura Vajgurore janë të listuar 15 subjekte për të cilat:

1-Pesë subjekte e kanë paguar taksën sa vijon:

Nr	Subjekti karburant	Nipti	Data e regjistrimit ne QKB	Afati i licencës	Pajisja me licencë	Vendndodhja	Statuti i pagesës
1	“R.” Shpk	J.....J	14/02/2000	12/11/2018	licencë 5 vjeçare	Ciflik	1,000,000
2	“G. Z.” shpk	K.....I	02/12/2008	08/10/2018	licencë 5 vjeçare	Poshnje	1,000,000
3	“2N-Sh.” shpk	K.....L	05/02/1995	13.11.2015 13.11.2020	licencë 5 vjeçare	Kutalli	1,000,000
4	“M. P.” shpk	L.....J	12/06/2017	viti 2017	licencë 5 vjeçare	Ciflik	1,000,000
5	“K.” shpk	J.....P	27/04/1995	25/05/2018	licencë 5 vjeçare	Pashalli	1,000,000

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.

2- Nga auditimi rezulton se 6 subjekte kanë paguar me këste dhe nje subjekt nuk ka paguar. **Detyrimi për t`u paguar është në shumën 4,600,000 lekë** sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Nr.	Subjekti karburant	Nipti	Data e regjistrimit ne QKB	Afati i licencës	Pajisja me licencë	Vendndodhja	Statuti i pagesës	Diferenca për t`u paguar
1	R. shpk	K.....I	09/11/2001	19/09/2020	licence 1 vjeçare	“4 Shtatori”	200,000	800,000
2	B. O. shpk	L.....F	21/04/2014	28.05.2014 28.05.2019	ka filluar procedurën	Donofrosë,	200,000	800,000
3	D. O. shpk	L.....J	09/04/2014	10.09.2014 10.09.2019	licencë 1 vjeçare	Drenovicë,	200,000	800,000
5	E. shpk	L.....F	10/12/2010	02/11/2021	licence 1 vjeçare	Poshnjë	400,000	600,000
6	C. shpk	K.....T	13/01/1995	12.06.2019 12.06.2020	licencë 1 vjeçare	Kuç	400,000	600,000
7	A. shpk	K.....J	11/06/2009	15/01/2019	ne	Poshnjë	0	1,000,000
8	B. O. sh.p.k	L.....R	14/05/2015	06/10/2020	Ne procedure	Syzes, NJA Poshnje	0	1000 000
Totali							1,400,000	5,600,000

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajgurore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

3- Ndërsa 2 subjekte janë përkatësisht një mbyllur dhe sekuestruar nga përbarimi dhe një i pezulluar nga QKB, sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Nr	Subjekti karburant	Nipti	Data e regjistrimit ne QKB	Afati i licencës	Pajisja me licencë	Vendndodhja	Statuti i pagesës
1	“M.” shpk	K.....E	11/06/2001	2018	Nuk ka paraqitur dokumentacion	“4 Shtatori” I mbyllur sekuestruar nga përbarimi	0
2	“Gj. O. “ shpk	L.....I	30/01/2014	06/06/2019	I mbyllur	Goriçan I pezulluar ne QKB	0

Burimi i të dhënave – Drejtorira e taksave dhe tarifave vendore Bashki Ura Vajguore.

Këto dy subjekte më fillimin e aktivitetit nuk kanë paguar taksën përkatëse duke shkaktuar të ardhura të munguara **në shumën 2,000,000 lekë për buxhetin e Bashkisë Ura Vajguore**

Konkluzion: Gjatë auditimit të taksave/ tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre (autorizimeve), u konstatua se nuk është aplikuar saktë tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet.

Detyrimet për pajisjen me licence tregtimi nuk janë paguar në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur, sipas të cilës këto subjekte duhet të paguajnë 1,000,000 lekë për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, duke mos aplikuar dhe arkëtuar vlerën prej **6,600,000 lekë**, si e ardhur e munguar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar dhe UMF nr. 26, Dt. 04.09.2008 dhe nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”.

9 Titulli i Gjetjes: Nga KLSH është konstatuar se, për mbledhjen e të ardhurave për taksën e lëshimit të autorizimeve për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, për mos mbledhjen dhe arkëtimin e kësaj tarife.

Situata:

Gjatë auditimit të taksave/ tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre (autorizimeve), u konstatua se nuk është aplikuar saktë tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet.

Detyrimet për pajisjen me licence tregtimi nuk janë paguar në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur, sipas të cilës këto subjekte duhet të paguajnë 1,000,000 lekë për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, duke mos aplikuar dhe arkëtuar vlerën prej **4,600,000 lekë**, si e ardhur e munguar.

Gjithashtu dy subjekte qe kanë filluar aktivitetin e tyre dhe janë mbyllur më vonë nga përbarimi apo pezulluar nga QKB, nuk kanë paguar detyrimin përkatësisht me nga 1,000,000 lekë, në total **2,000,000 lekë**, sa vijon :

Subjekti karburant	Nipti	Data e regjistrimit ne QKB	Afati i licencës	Vendndodhja
“M.” shpk	K.....E	11/06/2001	2018	“4 Shtatori” I mbyllur sekuestruar nga përbarimi
“Gj. O. “ shpk	L.....I	30/01/2014	06/06/19	Goriçan I pezulluar ne QKB



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

Kriteri:	Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar
Impakti:	Neni 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar
Shkaku:	Nuk jep siguri të mjaftueshme për përmbushjen dhe zbatimin e ligjit për funksionin dhe detyrat që ka.
Rëndësia:	Nga neglizhenca dhe nga mos këmbëngulja në zbatimin e ligjit, për mos mbledhjen dhe arkëtimin e kësaj tarife.
Rekomandimi:	E lartë Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Ura Vajguore, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 6,600,000 lekë , duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Për vjeljen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga ana e Zyrës së Taksave dhe Tarifave vendore të Bashkia Ura Vajguore, nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore të mëposhtme:

Nga ana e Drejtorisë së Taksave për subjektet debitorë është bërë një punë e mirë duke vepruar me njoftimin e detyrimeve, me bllokimin e llogarive bankare i janë dërguar Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nuk janë ndjekur të gjitha etapat për subjektet tatimor si parashikon ligji “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”

-Nuk i është kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nën-pika “iii”, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

-Nuk është vendosur masa e detyrimit tatimorë, ashtu siç parashikohet në nenin 91, të ligjit nr 9920, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” Pika 1 ku thuhet: “..... nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij”.

-Nuk është vepruar me sekuestrimin e pasurive të subjekteve, siç parashikohet në nenin 93, të ligjitn 9920, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” Pika 1 ku thuhet : “ Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Për veprimet e konstatuara në kundërshtim me kërkesat ligjore të trajtuara, mbajnë përgjegjësi R. Sh.; P. P.; A. C.; D. L.; S. D.; A. K.; F. K.; L. C.; D. S., për periudhën 2017-2018 L. H.; H. K.; M. B., për periudhën 2017-2018, O. T.; Xh. V..

C. VLERËSIMI I RAPORTIMIT FINANCIAR, PËR TË PARASHIKUAR OPINION MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR VITET 2017-2019.

10. Probleme me marrjen në dorëzim, pagesat dhe magazinimin e materialeve të ndërtimit. Mangësi në plotësimin e fletë-udhëtimeve në lidhje me konsumin e karburantit dhe me vlerësimin e kontabilizimin e mirëmbajtjes së aktiveve.

Situata:

Nga verifikimi i disa artikujve dhe rakordimi me magazinën, u konstatua se për artikujt që përdoren në ndërtim, si psh çimento, hekur, stabilizant, çakull, granil, etj., nuk është zhvilluar në rregull procedura për pagesat, marrjen në dorëzim dhe magazinimin e këtyre artikujve. Psh. gjatë vitit 2018, nga subjekti “V. Ll.” janë blerë artikuj të ndryshëm ndërtimi, si më sipër, të cilët janë paguar me dy fatura, përkatësisht fatura nr. 7 datë 31.07.2017, e shoqëruar me PV për marrjen në dorëzim nr. 1 datë 31.07.2017 në vlerën 1,957,926 lekë me TVSH dhe fatura nr. 8 datë 31.08.2017, e shoqëruar me PV për marrjen në dorëzim nr. 2 datë 31.08.2017, në vlerën 1,341,048 lekë me TVSH. Nga verifikimi e fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, u konstatua se procesverbalet e marrjes në dorëzim janë bërë në mënyrë fiktive, pasi fletët e hyrjes mbajnë data duke filluar nga 04.07.2017, deri në 29.12.2017. Ndërkohë, pavarësisht mënyrës së hartimit të procesverbaleve, fletë hyrjet korrespondojnë me fletë daljet, si në sasi edhe në kohë. E njëjta procedurë ka ndodhur për të tre vitet e audituara, për artikuj të ndryshëm, kryesisht në lidhje me ndërtimin. Duke pasur parasysh se bashkia Ura Vajgurore nuk ka magazina të mjaftueshme apo ambiente ku të mbajë këto dhe të tjera materiale voluminoze, personat përgjegjës duhet të marrin masa që të përcaktojnë kushtet e lëvrimit të mallit, magazinimin e tij dhe të bëjnë pagesën sipas sasive që tërheqin, kur ju nevojitet të tërheqin.

Në lidhje me konsumin e karburantit dhe vlerësimin e kontabilizimin e mirëmbajtjes së aktiveve:

1. Nuk disponohej një plan shpërndarjeje, për çdo mjet transporti, makineri apo kaldajë, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 38 dhe 59.

2. Në asnjë rast nuk ishte kryer rakordimi i fletëudhëtimeve me leximin e kilometrazhit apo orëve të punës të çdo mjeti.

3. Nuk disponohej në të gjitha tastet autorizimi, i shoqëruar me një program pune të miratuar nga titullari i institucionit, për lëvizjet e punonjësve apo makinerive, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe Nënpunësit civilë” neni 2, pika 5. Në lidhje me sa më sipër, u konstatua se në asnjë rast, shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e aktiveve, nuk ishin shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

Kriteri:

Ligji 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 30 datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Impakti:	27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42 e në vijim dhe pika 38 dhe 59; Ligji nr. 10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe Nënpunësit civilë” neni 2, pika 5; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Vlerësimi i mëpasshëm...
Shkaku:	Menaxhim i dobët i pasurisë publike, shkak për abuzimin dhe shpërdorimin e saj. Pasaktësi dhe paplotësi në kontabilizimin dhe në pasqyrimin e vlerave të llogarive për koston historike të aseteve.
Rëndësia:	Mosnjohje e plotë dhe moszbatim i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” nga ana e personelit të ngarkuar me këto detyra dhe neglizhenca nga ana e Nënpunësit Autorizues mbi ngritjen e urdhërave përkatës për menaxhimin e këtyre aktiveve dhe përcaktimin e kushteve të duhura kontraktuale, ku të mundësohet ruajtja e mallrave të blera në ambientet e furnitorit dhe lëvrimi i tyre sipas nevojës së institucionit.
Rekomandim 1:	E Lartë Nga Bashkia Ura Vajgurore, të merren masa nga Nënpunësi Autorizues i cili duhet të përcaktojë kushtet e duhura kontraktuale, ku të mundësohet ruajtja e mallrave të blera në ambientet e furnitorit dhe lëvrimi i tyre sipas nevojës së institucionit, njëkohësisht duke bërë pagesën në momentin e lëvritimit të mallrave, si dhe të marrë masa për të zgjeruar ambientet e magazinimit të mallrave, përfshirë edhe kushtet e magazinimit. Nënpunësi Zbatues të marrë masa për të rakorduar furnizimet e mallrave me pagesat, për të rakorduar çdo muaj konsumin e karburantit në fletët e udhëtimit me leximet e kilometrave të përshkuara nga automjetet apo orëve të punës së makinerive/pajisjeve. Në rastet e blerjes së mallrave të bëjë pagesën sipas sasive që nevojiten dhe kur nevojiten, sipas përcaktimeve në UMF nr. 30 datë 27.12.2011.
Rekomandim 2:	Nga Nënpunësi Zbatues të merren masa për të inventarizuar, kontabilizuar dhe pasqyruar saktë vlerat e koston historike të aseteve, duke llogaritur plotësisht shpenzimet e bëra për mirëmbajtjen, rikonstruksionin apo modifikimet/ ndryshimet e tyre, në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8, datë 09.03.2018.

11. Mospërputhje e llogarisë 4342, me llogaritë përkatëse të pasivit në vlerën 4,995,915 lekë. Moskontabilizimi i kontratave të lidhura si detyrime të bashkisë Ura Vajgurore për periudhat e ardhshme”.

Situata:	Për vitin 2019 ka një diferencë prej 4,995,915 lekësh, e cila duke pasur parasysh se Llogaria 4342 është llogari rregulluese, tregon se në hartimin e bilancit e vitit 2019 nuk janë marrë në konsideratë përcaktimet e UMF nr. 8, të cituara më sipër. Nga informacioni i marrë në zyrën e financës në Bashkinë Ura Vajgurore, u konstatua se në asnjë rast kontratat e lidhura nuk janë kontabilizuar në
-----------------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Kriteri:	Llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në kundërshtim me UMF nr. 8, ku përcaktohet se: “Llogaria 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Përfaqësojnë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm...”. Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” duhet të ketë kundërparti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe të evidentohen veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Pra edhe faturat e gjendura nga databaza e thesarit për faturat e vitit 2018, të cilat janë likuiduar në vitin 2019, apo të vitit 2017, të cilat janë likuiduar në vitin 2018 ose nuk janë likuiduar ende, janë fatura që, për shkak të mungesës së fondeve, nuk janë likuiduar si dhe nuk janë paraqitur si detyrime në llogarinë kreditore 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe për të njëjtën arsye, nuk e gjejmë as në llogarinë debitorë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. Pra automatikisht kemi një nënvlerësim të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”
Impakti:	Pamundësia në dhënien e opinionit mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e vlerave kontabël.
Shkaku:	Mosnjohje e plotë dhe moszbatim i koncepteve të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim 1:	Nga Bashkia Ura Vajgurore, të merren masa nga Nëpunësi Zbatues për të rakorduar llogarinë 4342 me llogaritë përkatëse të pasivit, sipas përcaktimeve në UMF nr. 8, datë 09.03.2018.
Rekomandim 2:	Nga Bashkia Ura Vajgurore, të merren masa nga Nëpunësi Zbatues për të regjistruar kontratat e lidhura në Llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, sipas përcaktimeve në UMF nr. 8, datë 09.03.2018.

12. Aktivitet Afatgjatë Jomateriale dhe pamundësia në dhënien e opinionit mbi saktësinë, plotësinë dhe përkatësinë e vlerave të tyre në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2018.

Situata:	Vlera historike totale e Llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në fund të vitit 2017 ka qenë 19,658,672 lekë, në fund të vitit 2018 ka qenë 28,097,072 lekë dhe në fund të vitit 2019 ka qenë 36,521,816 lekë. Sa më sipër, nga grupi i auditimit konkludohet se për këto asete njësia publike nuk ka përlllogaritur dhe kontabilizuar siç duhet normat e amortizimit sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit, ndërkohë që objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është e gabuar. Pavarësisht se një pjesë e projekteve dhe studimeve janë vënë në zbatim ose kanë përfunduar gjatë viteve të mëparshme dhe gjatë vitit ushtrimor 2019, nuk i janë shtuar kostos totale të objekteve, megjithëse vlerat
-----------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Kriteri:	respektive të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” dhe llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë rritur në kontabilitet, në këto llogari nuk janë shtuar kostot e projekteve përkatëse. Ligji 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-05); UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Impakti:	Pamundësia në dhënien e opinionit mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e vlerave kontabël, e cila do ketë ndikim në opinionin e Pasqyrave Financiare.
Shkaku:	Mosnjohje e plotë dhe moszbatim i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6 dhe udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat nga 26-30, si dhe pikën 74.
Rëndësia: Rekomandim:	E Lartë Nga Bashkia Ura Vajgurore, të merren masa nga Nëpunësi Zbaues për të mbajtur të përditësuar regjistrin e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirembajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirembajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

13. Aktivet Afatgjata Materiale dhe pamundësia në dhënien e opinionit mbi saktësinë, plotësinë dhe përkatësinë e vlerave të tyre në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Situata:	<u>Analiza e Llogarisë 210 “Toka, troje terrene”</u> Kjo llogari pasqyron gjendjen e tokave, trojeve dhe terreneve për Bashkinë Ura Vajgurore dhe për 3 ish Komunat. Gjatë të gjitha periudhave të audituara (2017, 2018, 2019) e në vijim, kjo llogari ka pasur vlerën 0. Nga të dhënat e disponueshme, ish komunat të cilat sot përbëjnë Bashkinë Ura Vajgurore kanë në pronësi toka, troje dhe terrene, të cilat janë transferuar me VKM sipas inventareve të hartuar në bashkëpunim me AITPP-në, por nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore nuk është bërë vlerësimi dhe regjistrimi në kontabilitet i aktiveve dhe më pas në ZVRPP/Kadastër. Këto janë asete të cilat rrjedhin nga konsolidimi i 4 ish komunave, të cilat nuk kanë pasur regjistër aktivesh sipas përcaktimeve në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 26 deri 33, nuk ka asnjë dokumentacion të lëvizjes së aktiveve sipas pikave 34 deri 41 të udhëzimit dhe për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara dhe inventarizimin e tyre sipas pikave nga 42 deri 94 të këtij udhëzimi. Gjithashtu, megjithëse në vitin 2017 janë bërë 4 transaksione shpronësimi dhe në vitin 2018 një i tillë, në vlerën totale 681,086 lekë (të dhëna të disponueshme në faqen e internetit të thesarit, MFE), kjo vlerë nuk është pasqyruar në Pasqyrat Financiare. Dokumentacioni mbështetës për plotësimin e pohimit të egzistencës së aktivitetit mungon dhe kjo na shtyn të
-----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

mos japim dot opinion mbi plotësinë dhe egzistencën e vlerave në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar për vitet 2017, 2018 dhe 2019 të asetiti 210 “*Toka, troje terrene*”.

Analiza e Llogarisë 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”

Kjo Llogari pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Ura Vajgurore dhe për 3 ish Komunat. Njësoj si për Llogarinë 210 “*Toka, troje terrene*”, këto asete janë transferuar me VKM të ish komunat dhe për shkak të mungesës së regjistrimit të aktiveve nuk paraqesin vlerën e vërtetë. Vlera e paraqitur në këtë llogari (3,641,232 lekë për vitin 2017, 4,280,832 lekë për vitin 2018 dhe 4,940,832 lekë për vitin 2019) është e gabuar, pasi nuk paraqet vlerën e pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, por vlerën e inventarit të pemëve të mbjella në rrugë, lulishte, parqe, etj., me shtesat dhe pakësimet e veta, e cila duhet të shtohet në llogarinë përkatëse të çdo objekti, si pjesë e të cilit është krijuar.

Konkluzion: Sa më sipër, për këto zëra të aktivitetit nuk është mbajtur regjistër aktivesh ku të specifikohen datat e hyrjes së aktivitetit, vlera e tyre në hyrje, shpenzimet kapitale, personat që i kanë në dorëzim. Gjithashtu identifikohet problematika për mosbërjen e inventarizimit vjetor të tyre në kundërshtim me pikat 31 dhe 74 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Analiza e Llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”

Kjo Llogari pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Ura Vajgurore dhe për 3 ish Komunat, në fund të vitit 2017 rezulton në vlerën 444,793,480 lekë, në fund të vitit 2018 në vlerën 609,311,351 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 804,084,562 lekë. Situatat paraqitet pothuajse e njëjtë siç u përmend më sipër në lidhje me mangësitë si në zbatim të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, në krijimin e një regjistri gjithëpërfshirës aktivesh, ashtu dhe në dokumentacionin mbështetës për plotësimin e pohimit të egzistencës së aktivitetit. Përveç mosregjistrimit të aseteve të transferuara me VKM ish komunave, ka edhe probleme të tjera, si psh nuk është bërë konsolidimi i pasurive në një zë të vetëm, dmth në një shkollë fshati, mban tjetër zë në inventar muri rrethues, tjetër zë banjot e shkollë, tjetër zë ambientet sportive dhe tjetër zë objekti i shkollës. Përveç rritjes së burokracisë dhe artificave në menaxhimin e këtyre aseteve, kjo shkakton edhe copëtimin e fondeve në rast rikonstruksionesh etj., pasi duke qenë zëra të veçantë, trajtohen nëpërmjet prokurimeve me vlerë të vogël, rrjedhimisht duke rritur mundësinë për abuzime. Nga rakordimi i listave të inventarit me vlerën e paraqitur në bilancet e viteve të audituara, u konstatua se në listat e inventarit nuk janë llogaritur amortizimet, pra mbahen me vlerën historike dhe mospërputhje të këtyre vlerave. Konkretisht, në fund të vitit 2017 inventaret rezultojnë në vlerën 512,866,008 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 700,328,269 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 926,271,764 lekë. Siç shihet, vlera inventarilale në vitin 2017 dhe në vitin 2018 është e pandryshuar.

Analiza e Llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”

Kjo Llogari pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Ura Vajgurore dhe për 3 ish Komunat, në fund të vitit 2017 rezulton në vlerën 725,763,664



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 690,320,554 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 812,394,667 lekë. Situatata paraqitet e njëjtë sic u citua më lart në lidhje me mangësitë si në zbatim të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë*”, si në egzistencën e një regjistri aktivesh ashtu dhe në dokumentacionin mbështetës për plotësimin e pohimit të egzistencës së aktivitetit. Gjithashtu, njësoj si me llogaritë e tjera, nga rakordimi i listave të inventarit me vlerën e paraqitur në bilancet e viteve të audituara, u konstatua se në listat e inventarit nuk janë llogaritur amortizimet, pra mbahen me vlerën historike dhe mospërputhje të këtyre vlerave. Konkretisht, në fund të vitit 2017 inventaret rezultojnë në vlerën 786,049,676 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 786,049,676 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 912,794,743 lekë. Siç shihet, vlera e inventarit në vitin 2017 dhe në vitin 2018 është e pandryshuar.

Pavarësisht se një pjesë e këtyre aktiveve mirëmbahen rregullisht çdo vit, në asnjë rast kjo vlerë mirëmbajtjeje nuk është kontabilizuar dhe nuk janë bërë rivlerësimet e aseteve, veprim që bie në kundërshtim me kërkesat e UMF nr 8, datë 9.3.2018. Përveç mospaqsyrimin korrekt në pasqyrat financiare, moskryerja e rivlerësimeve dhe mosevidentimi i riparimeve e rikonstruksioneve, lë shteg për abuzime, pasi një rrugë, rrjet apo kanal i cili është riparuar me mjetet e institucionit, pas gjashtë muajsh mund riparohet përsëri nëpërmjet prokurimit dhe rrjedhimisht çon në përdorimin e fondeve pa Efikasitet, Efektivitet dhe Ekonomicitet.

Konkluzion: Për Llogarinë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe për Llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, nuk është zbatuar parimi kontabël i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, sipas të cilit si të ardhurat dhe shpenzimet kontabilizohen në momentin kur transaksioni ekonomik ndodh dhe jo në momentin kur arkëtohen/paguhen flukset monetare të lidhura me transaksionin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar/shfuqizuar, nenin 7, 9, 10; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.

Analiza e Llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e paisje*”

Kjo Llogari pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Ura Vajgurore dhe për 3 ish Komunat. në fund të vitit 2017 rezulton në vlerën 6,130,264 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 7,244,213 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 5,795,372 lekë.

Nga rakordimi i listave të inventarit me vlerën e paraqitur në bilancet e viteve të audituara, njësoj si për llogaritë e tjera më sipër, u konstatua se në listat e inventarit nuk janë llogaritur amortizimet, pra mbahen me vlerën historike, mospërputhje të këtyre vlerave dhe regjistrime në këtë llogari të artikujve që duhet të regjistrohen në llogaritë e tjera. Konkretisht, në fund të vitit 2017 inventaret rezultojnë në vlerën 512,866,008 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 700,328,269 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 926,271,764 lekë. Siç shihet, vlera inventariale në vitin 2017 dhe në vitin 2018 është e pandryshuar. Kjo llogari nuk paraqet vlerën reale dhe është e mbingarkuar në vlerën 4,669,234 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Analiza e Llogarisë 215 “Mjete transporti”

Kjo llogari pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Ura Vajgurore dhe për 3 ish Komunat. Në fund të vitit 2017 gjendja në bilanc rezulton në vlerën 48,596,898 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 40,177,287 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 32,226,902 lekë. Situatata paraqitet e njëjtë siç u citua më lart në lidhje me mangësitë si në zbatim të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë”, si në egzistencën e një regjistri aktivesh ashtu dhe në dokumentacionin mbështetës për plotësimin e pohimit të egzistencës së aktivitetit. Vlera e këtyre zërave në pasqyrën e pozionit financiar 2017, është vendosur bruto nga pasqyrat financiare të njësitë administrative në 2015 dhe nuk është specifikuar në mënyrë analitike, janë bërë shtesat e pakësimet për vitet 2017, 2018 dhe 2019, por në listat e inventarit mbahen me vlerën historike, pa llogaritur amortizimin. Shtesat gjatë viteve përputhen me vlerën në formatin nr. 6 të pasqyrave financiare “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme”. Në regjistrin e inventarit, nuk ka informacion të hollësishëm për përshkrimin e aktivitetit, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirembajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

Gjatë periudhave të audituara u konsatua se është nxjerrë nga përdorimi vetëm një automjet në vitin 2018, autoveturë tip V. T., me targë AA...JT, për të cilën është zhvilluar një ankand për shitje dhe pasi nuk është paraqitur asnjë kërkesë, ka kaluar rregullisht procedurën e miratimit në këshillin bashkiak etj., për nxjerrjen jashtë përdorimit. Konstatohet se për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe shkarkimin nga kontabiliteti nuk është llogaritur amortizimi, por është nxjerrë me vlerën historike prej 1,378,800 lekë. Për këtë procedurë, nga titullari i institucionit ka nxjerrë urdhërin për vlerësimin e automjetit me nr. 116 prot., datë 19.04.2017. Në zbatim të tij, është mbajtur procesverbali me nr. 1143 prot., datë 28.05.2018, sipas të cilit është konkluduar se vlera për riparimin e mjetit shkon rreth 70% e vlerës së tij fillestare. Preventivi për riparimin e këtij mjeti, i nënshkruar nga G. B. dhe S. N., shkon në 949,000 lekë. Kjo procedurë është referuar në Këshillin Bashkiak, nga ku ka dalë vendimi nr. 50, datë 08.06.2018 për fillimin e procedurës së ankandit publik për shitjen e këtij mjeti, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 1877/1 prot., datë 12.06.2018. Po në datën 12.06.2018 nga titullari i bashkisë Ura Vajgurore është nxjerrë urdhëri për zbatimin e vendimit të këshillit Bashkiak. Me vendimin nr. 3225 prot., datë 31.12.2018, automjeti është nxjerrë jashtë përdorimit me vlerën e tij historike. Ky automjet i nxjerrë jashtë përdorimit është bërë hyrje në magazinë për t’u shitur më pas në formë skrapit me fletëhyrjen nr. 28, datë 09.05.2019.

Nga verifikimi i personave të kontraktuar nga bashkia Ura Vajgurore, u konstatua se këta persona (G. B. dhe S. N.) nuk janë të pajisur me lejet apo liçencat për ushtrimin e profesionit dhe për vlerësimin e mjeteve motorike, pra bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” ndryshuar me ligjin nr. 10137/2009”. Për sa më sipër, për nxjerrjen jashtë përdorimit të këtij automjeti, për lëshimin e urdhërave në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përgjegjësi mban titullari i institucionit sipas pikës 5 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”. Për sa më sipër, konstatohet se vlera prej 1,378,800 lekë e shkarkuar nga kontabiliteti për nxjerrjen e këtij aktivi jashtë përdorimit, përbën përdorim pa Efikasitet, Ekonomicitet dhe Efektivitet të aktiveve të Bashkisë Ura Vajgurore. Gjithashtu, u konstatua se nga ana e kryetarit të bashkisë Ura Vajgurore nuk janë marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për degradimin dhe dëmtimin e automjetit për shkak të mospërdorimit dhe lënies në ambient me lagështirë.

Llogaria 215 është e mbivlerësuar me zëra të cilët i përkasin Llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e paisje*”, konkretisht, numrat 1, 12, 13 dhe 14 sipas Tabelës PF18. Për sa më sipër, kjo llogari nuk paraqet vlerën reale dhe është e mbingarkuar në vlerën 33,258,487 lekë. Gjithashtu, nga ana e titullarit të institucionit nuk janë marrë masa për përfundimin e procedurës hetimore dhe për shkarkimin nga kontabiliteti të makinës së vjedhur, me targë BR....A.

Si konkluzion, situata paraqitet e njëjtë si më sipër në lidhje me mangësitë si në zbatim të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë*”, si në egzistencën e një regjistri aktivesh ashtu dhe në dokumentacionin mbështetës për plotësimin e pohimit të egzistencës së aktivitetit.

Llogaria 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” në fund të vitit 2017 rezulton në vlerën 494,473,628 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 584,394,777 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 548,854,365 lekë.

Nga informacioni i marrë në zyrën e financës të bashkisë Ura Vajgurore, në këtë llogari janë përfshirë edhe aktive të cilat kanë përfunduar (pavarësisht se disa nuk janë likuiduar për mungesë fondesh), janë marrë në dorëzim, por nuk ka përfunduar periudha e garancisë. Rrjedhimisht, kjo llogari nuk paraqet vlerën e vërtetë përse i përket aktiveve të cilat janë vënë në përdorim. Gjithashtu, mosregjistrimi i vlerave të sakta në këtë llogari, ka sjellë edhe regjistrimin e gabuar në llogarinë 105 të pasivit, “*Teprica e Granteve kapitale te Brendshme*”, ku si rregull regjistrohet vetëm vlera për investimet në proces. Këto veprime bien në kundërshtim me UMF nr. 8, datë datë 09.03.2018, ku përcaktohet se: “*Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara. Për kapitalizimin e aktivitetit (kur vihet në funksionim) bëhet hyrje: Debitohet 21, “Aktive afatgjata materiale”; Kreditohet 231, “Investime për aktive afatgjata materiale”, në analizë shtatëshifrore.*”. Nga ana tjetër, fakti që për aktivet e përfunduara dhe të vëna në funksionim, të cilat nuk janë kontabilizuar në llogaritë përkatëse, sipas rastit, nuk është llogaritur as amortizimi, bën që edhe vlera e amortizimit të mos jetë e saktë, pasi nuk është gjithëpërfshirëse.

Në lidhje me urdhërat e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

konstatohet se: nuk është specifikuar cilat aktive do të inventarizohen dhe vlerësohen dhe si rezultat është realizuar inventarizimi vetëm për llogaritë 214 “*Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune*”, 215 “*Mjete transporti*” dhe 218 “*Inventar ekonomik*” (bazuar kjo në process verbalet e inventarizimit të cilët janë përpiluar vetëm për materialet, inventarët e imët, inventarin ekonomik dhe instalimet teknike. Janë përjashtuar nga inventarizimi përkatësisht llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje dhe Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete e vepra ujore*” dhe Aktivitet afatshkurtra, në kundërshtim me pikën 74 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Gjithashtu, komisioni i vlerësimit nuk është ngritur në përputhje me pikën 99 të UMF 30.

Në strukturë vihet re se nuk ka një sektor të veçantë apo një zyrë të menaxhimit të aseteve, veprim në kundërshtim me nenin 9 pika f) dhe nenin 8 pika d) të ligjit 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” dhe pikat 9, 10 11, 13, 14 dhe 21 të VKM-së nr. 500 datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*”.

Testi substancial i amortizimit

Qëllimi: Është kryer rillogaritja e amortizimit për disa nga llogaritë kryesore, duke u bazuar në pikën 36 të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, për të parë diferencat ndërmjet amortizimit të ripërfomuar sipas udhëzimit dhe atij faktikut të gjendur në rregjistrat e aktiveve përkatëse dhe në kontabilitet. Nga testimi u konstatua se ka diferenca në llogaritjen e amortizimit, jo për shkak të gabimeve apo anomalive materiale, por për shkak të mosmbajtjes në rregull të regjistrat të aktiveve, pasi nuk është e qartë se për cilat aktive është llogaritur amortizimi i shtesave të bëra gjatë vitit, dhe për cilat jo. Gjithashtu, nuk është e qartë edhe llogaritja e amortizimit të llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”, pasi p.sh. pajisjet dhe programet kompjuterike amortizohen me normën 25%, ndërsa inventaret e tjera me 20%. Meqenëse dokumentacioni i vënë në dispozicion nga zyra e financës në bashkinë Ura Vajgurore ishte i përpiluar në programin EXCEL në mënyrë manuale, nuk përmbante formulat e llogaritjes së amortizimit, ishte e pamundur ndjekja e veprimeve të bëra për llogaritjen e amortizimit, etj. Për sa më sipër, veprimet dhe mosveprimet e kryera në kundërshtim me kërkesat ligjore e nënligjore për mbajtjen e regjistrave të aktiveve, na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket llogaritjes së amortizimit.

Kriteri:

Ligji 10296 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”; Ligji nr. 9573, datë 03.07.2006, “*Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to*” ndryshuar me ligjin nr. 10137/2009”; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar/shfuqizuar; VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*”; UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes,*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Impakti:

paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;

Veprimet dhe mosveprimet e kryera në kundërshtim me kërkesat ligjore e nënligjore, na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket zërave 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje e Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete e vepra ujore*” dhe Aktivet afatshkurtra dhe për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet.

Shkaku:

Mosnjohje e plotë dhe moszbatim i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, neni 6 dhe udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” pikat nga 26-30, si dhe pikën 74 nga ana e Nëpunësit Zbatues që bën mbylljen e Pasqyrave financiare vjetore si dhe nga ana e Nëpunësit Autorizues mbi ngritjen e urdhërave të inventarizimit, kryesisht për këto aktive.

Rëndësia:

E Lartë

Rekomandim 1:

Nga Nëpunësi Autorizues i bashkisë Ura Vajgurore, të merren masa për të caktuar Nëpunësin Zbatues të krijojë dhe të mbajë regjistrin e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirembajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirembajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Gjithashtu nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm e Aktiveve Afatgjata të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “*Toka, troje terrene*”, 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”, 212 “*Ndërtime e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”.

Rekomandim 2:

Nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore të merren masa të menjëhershme që nën strukturën organizative të ngrihet një zyre apo sektor i vecant i administrimit të aseteve në përputhje me kërkesat ligjore, siç përcaktohet edhe në VKM-në nr. 500 datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*” në pikat 9, 10, 11, 13, 14 dhe 21 të saj.

Rekomandim 3:

Nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive për dëmtimin e autoveturës tip V. T., me targë AA...JT, deri në zhdëmtimin e vlerës së saj, si dhe për vlerësimin e aktiveve të mos kontraktohen persona të cilët nuk janë të kualifikuar siç duhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006, “*Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to*” ndryshuar me ligjin nr. 10137/2009”

Rekomandim 4:

Nëpunësi Autorizues, të marrë masa që në ngritjen e komisioneve për vlerësimin e aktiveve, të marrë në konsideratë përcaktimet e UMF nr. 30, ku përcaktohet se: “...Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Rekomandim 5:

Zbatues i njësisë...” dhe me pikën 101.

Nga Nëpunësi Zbatues, të merren masa për të llogaritur amortizimin në mënyrë progresive dhe për t’i mbajtur në mënyrë kumulative në regjistrin e aktiveve së bashku me të gjitha detajet e tjera të regjistrit, të listuara në rekomandimin 1 më sipër.

14. Aktivët Afatgjatë Financiare, konkretisht llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalët e veta”, për të tre vitet e audituara është paraqitur në vlerën 0 lekë, megjithëse bashkia Ura Vajgurore zotëron 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore” me NIPT K32803022R, në vlerën totale 170,366,002 lekë.

Situata:

Shoqëria Aksionere “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore” me NIPT K32803022R në Ekstraktin historik ka 100% të aksioneve, me 1 aksion në vlerën nominale **170,366,002 lekë**, e cila përbën edhe vlerën e përgjithshme të kapitalit të kësaj shoqërie (seksioni 8 i Ekstraktit Historik) në pronësi të Bashkisë Ura Vajgurore. Kjo vlerë e kapitalit prej 170,366,002 lekë në masën 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Ura Vajgurore në “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore” në asnjë rast nuk paraqitet në aktivët afatgjatë financiarë të Bilanceve kontabël 2017, 2018 dhe 2019, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalët e veta”, në kundërshtim me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivët Afatgjatë Materiale dhe Aktivët Afatgjatë Jomateriale” pikat 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, Nga verifikimi i dokumentacionit të disponueshëm në bashkinë Ura Vajgurore, u konstatua se me shkresën nr. 964/29, datë 24.03.2017, nga Ministria e transportit dhe infrastrukturës është miratuar prokurimi me vlerë të plotë për objektin “Ndërhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga stacioni i pompave Poshnjë, (ndërtim, montime, kolaudim punimesh dhe makineri e pajisje”, me vlerë totale 98,151,828 lekë, nga të cilat për vitin 2017 ishin programuar 13,100,000 lekë; dhe për objektin “Ndërhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga stacioni i pompave Poshnjë, (drejtim punimesh”, me vlerë totale 1,984,420 lekë, nga të cilat për vitin 2017 ishin programuar 156,000 lekë. Vlera e plotë e këtij objekti ka qenë 100,136,248 lekë, e ndarë në: ndërtim montime në vlerën 90,551,116 lekë; drejtim punimesh në vlerën 1,984,420 lekë; kolaudim punimesh në vlerën 297,663 lekë dhe makineri e pajisje në vlerën 7,303,049 lekë. Alokimi nga Ministria e transportit dhe infrastrukturës i shumës prej 13,100,000 për vitin 2017, si viti i parë i investimit, në këtë rast është në kundërshtim me përcaktimin në nenin 40 “E drejta për të kryer shpenzime”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57-2016, datë 02.06.2016. Konkretisht, vlera e alokuar për vitin 2017, duhet të ishte minimalisht 19,630,366 lekë. Me shkresën nr. 1494 Prot., datë 17.05.2019, nga Ministria e infrastrukturës dhe energjisë, Agjencia kombëtare e ujësjetllës kanalizimeve dhe infrastrukturës së mbetjeve, është dërguar në bashkinë Ura Vajgurore detajimi i buxhetit të viteve 2019-2021 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

programin “*Furnizimi me ujë dhe kanalizime*”, konkretisht për projektin “*Rrjeti shpërndarës i Urës Vajgurore*”, në vlerën 86,775,371 lekë, e ndarë në tre vite, përkatësisht 17,355,074 lekë në vitin 2019, 30,000,000 lekë në vitin 2020 dhe 39,420,297 lekë në vitin 2021 dhe Supervizim i këtij projekti, në vlerën 1,800,795 lekë, e ndarë sipas viteve në 360,159 lekë në vitin 2019, 720,318 lekë në vitin 2020 dhe 720,318 lekë në vitin 2021.

Në bazë të Vendimit të Gjykatës me nr. akti 29588, datë 22.04.2003, “*Për regjistrimin e personit juridik Ujësjetës Ura Vajgurore Sha*”, Aktit të Themelimit dhe Statutit të kësaj shoqërie, Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr. 73, datë 04.03.2003, “*Për transformimin e ndërmjes shtetërore “Ujësjetës Ura Vajgurore” Berat në shoqëri anonime*”, etj., kjo shoqëri është personi i vetëm që ka kompetenca ligjore dhe objekt aktiviteti “*Furnizimi me uje te pijshem per konsumatorët dhe shitja e ujit ne Bashkine Ura Vajgurore, perfshire banoret e qytetit dhe fshatrave ne perberje te saj; Pashalli, Skrevan, Vokopole, Komunen, Poshnje. Mirembajtjen e sistemeve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe/ose blerjen e ujit per plotesimin e kerkesave te konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujrave te ndotura dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemit te ujrave te ndotura si dhe impianteve te pastrimit te tyre.*”, (sipas ekstraktit historik të saj). Për sa më sipër, pavarësisht se bashkia Ura Vajgurore zotëron 100% aksionet e kësaj shoqërie, si dhe duke pasur parasysh që shoqëria “*Ujësjetës Kanalizime Sha Ura Vajgurore*”, ka të gjitha strukturat e nevojshme, kompetencat ligjore dhe aftësitë teknike për të kryer prokurime të tilla dhe për të ndjekur zbatimin e tyre, Këshilli Bashkiak duhet t’i kalojë këto fonde menjëherë në destinacionin përfundimtar, ku të zhvillohen procedurat e prokurimit, etj., dmth në shoqërinë “*Ujësjetës Kanalizime Sha Ura Vajgurore*”, pa lejuar hallka të tepërta burokratike të cilat vonojnë shërbimin ndaj qytetarëve dhe ndonjëherë dështojnë apo nuk përmbushin pritshmëritë, për shkak të mungesës së personelit në organikën e bashkive. Gjithashtu, nëpërmjet prokurimit në vlerën e plotë të një investimi tre vjeçar dhe lidhjes së kontratës pa pasur të disponueshme fondet e nevojshme në llogarinë e saj, nga bashkia Ura Vajgurore janë shkelur dispozitat e përcaktara në nenin 70 “*Lidhja e kontratës*”, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”. Krahas këtyre problemeve, duke qenë se praktika e ndjekur (e gabuar) në bashkinë Ura Vajgurore për kontabilizimin e aktiveve pas përfundimit të periudhës së garancisë, do të thotë ose që aktivet përdoren pa u kontabilizuar, (ku nuk llogaritet as amortizimi i tyre dhe krijohen probleme me shoqëritë ndërtuese) ose që popullata pret të përfundojë periudha e garancisë dhe më pas të ketë ujë në rubinet.

Përveç sa më sipër, nga ana e bashkisë Ura Vajgurore (Këshillit Bashkiak), përveç transferimit të aktiveve, asnjëherë nuk është ndërmarrë asnjë procedurë tjetër, verifikim apo vlerësim i pasurisë dhe fondeve të saj në shoqërinë “*Ujësjetës Kanalizime Sha Ura Vajgurore*”, përfshirë edhe regjistrimin e aksioneve në llogarinë 26 të pasqyrave financiare të bashkisë, “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*”.

Kriteri:

Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar/shfuqizuar; Ligji nr. 139-2015, “*Për*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Impakti:	<p><i>Vetëqeverisjen Vendore</i>”; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “<i>Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH</i>”, i ndryshuar me ligjin nr. 57-2016, datë 02.06.2016; Urdhëri nr. 64 datë 22.07.2014 “<i>Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar</i>”; Standardi Kombëtar i Kontabilitetit (SKK nr. 5) “<i>Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale</i>”; Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK nr. 28) “<i>Investimet në Pjesëmarrje</i>”; Vendimi i Gjykatës me nr. akti 29588, datë 22.04.2003, “<i>Për regjistrimin e personit juridik Ujësjetllës Ura Vajgurore Sha</i>”;</p> <p>Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë Aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore” me NIPT K32803022R.</p> <p>Mosregjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018 të llogarisë 26 “<i>Pjesëmarrje në kapitalin e vet</i>”, gjendjo kjo e nën vlerësuar me 170,366,002 lekë.</p> <p>Kryerje nga administrata e bashkisë Ura Vajgurore e procedurave të prokurimit, të cilat duhet të kryhen nga Shoqëria Aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore”.</p> <p>Marrja nga kryetari i bashkisë e kompetencave të cilat i takojnë këshillit bashkiak.</p>
Shkaku:	<p>Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 “<i>Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare</i>”, urdhërit nr. 64 datë 22.07.2014 “<i>Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar</i>”, Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “<i>Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale</i>” dhe Standartit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “<i>Investime në Pjesëmarrje</i>”.</p>
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim 1:	<p>Nga Bashkia Ura Vajgurore, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe rregjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore”, me vlerë kontabël 170,366,002 lekë në llogarinë 26 “<i>Pjesëmarrje në kapitalin e vet</i>”.</p>
Rekomandim 2:	<p>Nga Bashkia Ura Vajgurore, Këshilli Bashkiak, të merren masa që fondet për mallra dhe shërbime të prokurohen nga Shoqëria Aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore”, si i vetmi person juridik përgjegjës me ligj për furnizimin me ujë të popullatës së qytetit Ura Vajgurore dhe fshatrave të bashkisë Ura Vajgurore.</p>
Rekomandim 3:	<p>Nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, të merren masa që në rastet e alokimit të fondeve për investime në pushtetin vendor, këto fonde të jenë në përputhje me përcaktimin në nenin 40 “<i>E drejta për të kryer shpenzime</i>”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “<i>Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH</i>”, i ndryshuar me ligjin nr. 57-2016, datë 02.06.2016.</p>

15. Llogaria 105 “*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*” nuk paraqet gjendjen e vërtetë në fund të periudhave ushtrimore

Situata:	<p><u>Llogaria 105 “<i>Teprica e Granteve kapitale të brendshme</i>”</u> Teprica e Granteve kapitale të brendshme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për</p>
-----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Kriteri:	<p>investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces ne grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Në fund të vitit 2017 rezulton në vlerën 494,473,628 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 584,394,777 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 548,854,365 lekë.</p> <p>Nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore bëhet e ditur se vlerat e paraqitura në bilanc paraqesin investime të përfunduara, të cilat janë marrë në dorëzim dhe aktualisht janë në funksionim, gjë që bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 8 të Ministrisë së Financave ku thuhet qartë që duhet të ishin kapitalizuar me fondet bazë kur investimi është marrë në dorëzim. Pra llogaria 105, Teprica e Granteve kapitale të brendshme në këtë rast duhet të ishte me vlerën aktuale, minus vlerën e aktiveve të marra në dorëzim.</p> <p>Ligji 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;</p> <p>Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar/shfuqizuar</p> <p>UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p> <p>UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;</p>
Impakti:	<p>Mosregjistrimi i rregullt në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat Financiare për llogarinë 105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme”.</p>
Shkaku:	<p>Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ; udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.</p>
Rëndësia:	<p>E Lartë</p>
Rekomandim:	<p>Nga Bashkia Ura Vajgurore, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për llogarinë 105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme”</p>

16. Kryerja e shpenzimeve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve pa pasur fonde në dispozicion.

Situata:	<p>Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve, faturave, procesverbaleve të marrjes në dorëzim, rakordimeve me thesarin, etj., u konstatua se në shumicën e rasteve, urdhrat e shpenzimeve dhe kontratat për prokurime të ndryshme, si me grante/fonde të deleguara, ashtu edhe me fondet e veta, janë bërë pa pasur të disponueshme në llogarinë e institucionit vlerën e plotë të prokurimit, si në rastet e investimeve njëvjeçare, ashtu edhe për investimet shumëvjeçare. Këto veprime dhe mosveprime bien ndesh me dispozitat e përcaktara në nenin 70 “Lidhja e kontratës”, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo shkelje ngarkon me përgjegjësi Nëpunësit Autorizues, sipas nenit 71 “Shkelje dhe Sanksione” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit</p>
-----------------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Kriteri:	<i>buxhetor në R.SH</i> ”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016, pika b. Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “ <i>Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH</i> ”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “ <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ”.
Impakti:	Rritja e detyrimeve të prapambetura për shkak të mungesës së fondeve. Mosparaqitja në kohë e faturave me TVSH, duke shkaktuar vonesa në pagesën dhe deklarimin e TVSH-së, rrjedhimisht shmangie të pagesës së TVSH-së.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “ <i>Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH</i> ” dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, “ <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ”. Papërgjegjshmëria e strukturave drejtuese në menaxhimin e fondeve publike.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim 1:	Nëpunësi Autorizues dhe nëpunësi zbatues i bashkisë Ura Vajgurore të marrin masa për të mos zhvilluar angazhime shpenzimi për mallra/punë/shërbime, pa pasur në dispozicion fondet e nevojshme, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “ <i>Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH</i> ”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016.
Rekomandim 2:	Nëpunësi i parë Autorizues të marrë masa për të caktuar përgjegjësitë, për të vendosur penalitetet përkatëse në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “ <i>Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH</i> ”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016.

17. Mosparaqitja në kohën e duhur e faturave tatimore për mallrat/punët/shërbimet e blera. Marrja në dorëzim pa faturë tatimore.

Situata:	<p>Nga verifikimi i faturimeve të ndryshme, u konstatua se ka pasur mjaft raste (sidomos për kontratat e ndërtimit apo rikonstruksionit) kur faturat janë paraqitur për pagesë pas marrjes në dorëzim të punimeve apo mallrave. Ky veprim apo mosveprim, është në kundërshtim me përcaktimet në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “<i>Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë</i>”, neni 51, “<i>Lëshimi i faturës tatimore</i>”; neni 124 “<i>Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve</i>”; me ligjin nr. 92/2014 “<i>Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë</i>”, neni 33 “<i>Rregulla të veçanta</i>”, neni 99 “<i>Momenti i lëshimit të faturës</i>”, dhe me UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “<i>Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë</i>”, neni 20 “<i>Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes</i>” pika 2 “<i>Vlera e tatueshme e punimeve të ndërtimit</i>” dhe pika 3 “<i>Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim</i>”.</p> <p>Nga verifikimi i listave të tatimpaguesve në bashkinë Ura Vajgurore, u konstatua se pothuajse asnjë nga subjektet të cilët nuk janë me seli qendrore në territorin e bashkisë Ura Vajgurore, nuk ka hapur adresë sekondare në bashkinë Ura Vajgurore, duke shmangur pagesat e</p>
-----------------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

detyrimeve përkatëse tatimore dhe tarifrat që zbatohen nga kjo bashki. Rrjedhimisht, këto subjekte kanë bërë shmangien e këtyre pagesave, duke shkaktuar mungesë të ardhurash për bashkinë Ura Vajgurore, si dhe duke konkurruar pa të drejtë në tenderat e ndryshëm të zhvilluar nga bashkia Ura Vajgurore.

Për sa më sipër, konkludojmë se:

Në të gjitha rastet e punimeve në ndërtim, bashkia Ura Vajgurore nuk ka kërkuar çdo muaj situacionet dhe faturat tatimore.

Në të gjitha rastet, bashkia Ura Vajgurore nuk ka kërkuar faturat tatimore në momentin kur shërbimi apo malli është marrë në dorëzim.

Për periudhat e kaluara, nuk ka bërë rakordimet e faturave me procesverbalet e marra në dorëzim dhe nuk ka përcjellë në Drejtorinë Rajonale Tatimore listën e faturave sipas subjekteve dhe objekteve, për të proceduar me penalitetet përkatëse në vlerën e TVSH-së të padeklaruar sipas kërkesave ligjore të mësipërme.

Për punimet në ndërtim sipas grafikut të kontraktuar për punimet, ditareve dhe situacioneve të punimeve, në rastet kur nuk janë paraqitur situacione, bashkia Ura Vajgurore nuk ka proceduar me penalitete për mosrealizimin e grafikut të punimeve, sipas kontratave përkatëse.

Për të gjitha rastet e paraqitjes me vonesë, duke qenë se sipas bazës ligjore të përmendur më sipër, një punë, shërbim apo blerje mallrash quhet e përfunduar në momentin e paraqitjes së faturës, bashkia Ura Vajgurore nuk ka proceduar me penalitetet përkatëse sipas kontratave për mospërmbushje të afateve kontraktuale.

Kriteri:

Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 48-2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare” UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”;

Impakti:

Rritja e detyrimeve të prapambetura për shkak të mungesës së fondeve. Mosparaqitje në kohë e faturave me TVSH, duke shkaktuar vonesa në pagesën dhe deklarimin e TVSH-së, rrjedhimisht shmangie të pagesës së TVSH-së dhe pengesë të autoriteve tatimore në vendosjen e penaliteteve për shmangien e pagesës së TVSH-së dhe kamatëvonesave përkatëse.

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatimi i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH” dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Papërgjegjshmëria e strukturave drejtuese në menaxhimin e fondeve publike.

Rëndësia:

E Lartë

Rekomandim 1:

Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa për të kërkuar menjëherë, në momentin e marrjes në dorëzim të mallit/punës/shërbimit, faturën me TVSH nga furnitori. Në rastet e punimeve në ndërtim të kërkojë çdo muaj faturën me TVSH, në përputhje dhe të rakorduar me grafikun e punimeve, situacionin, ditarin e punimeve, etj., për çdo rast, sipas përcaktimeve në kontratë, sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Rekomandim 2:

në UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa për të gjitha subjektet të cilët kanë paraqitur faturat me TVSH, për të filluar menjëherë llogaritjen e penaliteteve dhe gjobave përkatëse duke filluar nga data e përfundimit të punimeve/shërbimeve apo dorëzimit të mallrave sipas kontratës, deri në momentin e paraqitjes së faturës nga furnitori.

Rekomandim 3:

Drejtoria Tatimore Berat, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajgurore të marrë masa për të vendosur menjëherë gjobat e barabarta me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave përkatëse, për të gjithë subjektet, në të gjitha rastet e paraqitjes me vonesë të faturave me TVSH. Në rastet e punimeve në ndërtim gjobat të vendosen për çdo muaj dhe kamatëvonesat të llogariten për çdo muaj, deri në momentin e pagesës, në përputhje dhe të rakorduara me grafikun e punimeve, situacionin, ditarin e punimeve, etj., për çdo rast, sipas përcaktimeve në kontratë, sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe në UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe në Ligjin nr. 48-2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”.

D. MBI ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT NR. 9643, DATË 20.11.2016 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” I NDRYSHUAR, VKM NR. 914, DATË 29.12.2014 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” I NDRYSHUAR ME VKM NR. 797, DATË 29.12.2017.

1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve;
2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara;
3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit);
4. Opinion mbi prokurimin e fondeve publike në nivel institucional;

1.1-Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Në Bashkinë Ura Vajgurore, u audituan zbatimi i procedurave të prokurimit të kryera bazuar në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik që kanë lidhje me objektet e prokurimit, sipas çështjeve të trajtuara. Nga ana e Autoritetit Kontraktore (këtu e vijim AK), janë respektuar afatet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve nuk janë botuar, në formë elektronike, në faqen e app.gov.al.

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2017 – 31.12.2019), nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat e sektorëve përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, si dhe në përputhje midis parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga 43 procedura të zhvilluara me fond limit 642,541,161 lekë u audituan 38 procedura me vlerë të fondit limit 625,491,973 lekë, e konkretisht:

Viti	Numër prokurimesh	Fondi limit	Vlera e kontratës	Audituar	Fondi limit	OE		Diferenca nga Fondi Limit
						gjithsej	S' kualifikuar	
2017	20	428,815,837	510,727,030	19	426,975,021	36	14	2,706,344
2018	10	79,743,262	4,961,854	10	79,743,262	26	19	2,197,957
2019	13	136,990,119	145,350,994	9	118,773,690	19	8	3,599,707
Shuma	43	642,541,161	737,775,083	38	625,491,973	81	41	8,504,008

Paligjshmëria e përdorimit të fondeve publike në procedurat e prokurimit publik, sipas viteve paraqitet sa vijon:

Vitet	Zhvilluar		Audituar me efekt negativ		
	Nr.	Fond Limit	Nr.	Fond limit	Efekt negativ
2017	20	428,815,837	11	253,124,303	239,218,358
2018	10	79,743,262	10	79,743,262	68,098,884
2019	13	136,990,119	2	36,408,024	35,548,925
Shuma	43	645,549,218	23	369,275,589	342,865,819

Tabelat nominativë të procedurave të prokurimit të zhvilluara dhe të audituara në hollësi janë trajtuar në ANEKS D, bashkëlidhur këtij materiali.

Gjetjet për vitin 2017, janë sa më poshtë vijon:

1- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Sistemin asfaltim i rrugëve të tregjeve Drenovicë”

18 Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemin asfaltim i rrugëve të tregjeve Drenovicë”, me fond limit 59,116,230 lekë pa tvsh.
Situata:	<p>Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, në kundërshtim me nenin 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 dhe neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2, si :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vërtetim nga Bashkia, se ofertuesi nuk ka detyrime ndaj Autoritetit Tonë (Bashkisë Ura Vajgurore). - klasifikimi i kategorive të mësipërme të gjitha klasifikimi “C” si dhe punime topogjeodezike klasifikimi “C”, nuk janë të argumentuara me volumin e punimeve. - Nuk është argumentuar me volumin e punimeve si dhe grafikun e punimeve numri i punonjësve. - Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nga Dhjetori 2014 e në vazhdim mjekun e shoqërisë të shoqëruar me kontrate pune dhe diplomë, (referuar VKM nr. 742 date 06.11.2003)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	<ul style="list-style-type: none"> - I Arkitekt - ISO 27001:2013- (Sistemimi i menaxhimit te sigurisë se informacionit) - ISO 50001:2011(Sistem i menaxhimit te Energjisë) - ISO EN 3843-2 :2006 (Menaxhimi i cilësisë ne proces te punimeve me Saldim) - nuk është kërkuar edhe forma kontratë furnizimi, por fabrika betoni, afalti e prodhim inertesh ne pronësi apo me qera. <p>Pas ankimimit nuk është argumentuar nga grupi i shqyrtimit të ankesës i pranimit apo mospranimit të kriterëve të ankmuara.</p> <p>Për mos marrjen në konsideratë të ankimit si dhe mos argumentimin e modifikimit në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit e grafikun e punimeve ngarkohet me përgjegjësi grupi i shqyrtimit të ankimimit i përbërë nga M. M.; B. R.; I. Sh..</p> <p>Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit:</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px;"> <p>“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”</p> </div> <p>ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga E. S., A. P., M. B..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Nga vendosja jo e drejtë e kriterëve per kualifikim ka pasur mungesë konkurence, vetëm një operator ekonomik
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin praktikave të të vendosjes së kriterëve për kualifikim të pa argumentuara si dhe në procesin e ankimimit për kriteret e kualifikimit grupi i shqyrtimit të bazohet në objektin e kontratës.

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për procedurën **me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugëve të tregjeve Drenovicë”.**

Për sa komentoni se: Përsa i përket licencës profesionale dhe pikave të saj të kërkuar nga ana jonë ju informojmë që vlera e fondit limit të procedurës në fjalë është midis **50-100** milion dhe si të tillë për të vërtetuar nga ana jonë fuqinë serioze të një shoqërie janë kërkuar këto pika licence që janë kërkuar duke u bazuar dhe në preventivin në fjalë dhe vlerën e fondit limit të kësaj procedure.

Në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar nga ana jonë ju informojmë që ky numër punonjësish është kërkuar në përputhje me grafikun e punimeve dhe afatit kohor të kërkuar për realizimin e kontratës. Përsa i përket konstatimit ku kenë veçuar si kriter në kundërshtim me VKM-në 914 datë 10.01.2007, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 30, “Kërkesat e Cilësisë” , ISO nr. 27001:2013 ”Për menaxhimin e sigurisë së Informacionit”, Iso EN ISO 3834 - 2:2006 ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, Iso 50001:2011 “Për sistemin e menaxhimit të energjisë” ju bëjmë me dije se ne si Njësi Prokurimi nuk na duken si të panevojshme këto ISO apo të ekzagjeruar, pasi ne me anë të certifikatave që posedon një Shoqëri vlerësojmë integritetin e kësaj Shoqërie, zhvillimin e saj ndër vite dhe seriozitetin që ka kjo Shoqëri në tregun shqiptar. Në lidhje me mjetet e kërkuara nga ana jonë si Fabrikë betoni, Fabrikë asfalti, Linjë prodhim inertesh janë kërkuar për arsye të uljes së kostos, nuk shohim aspak ekzagjerim pasi këto mjete janë kërkuar në të gjitha format e lejueshme të legjislacionit në fuqi, ose në pronësi ose me një kontratë që të vërtetohet që kjo kontratë do të realizohet pa hasur vështirësi në zbatim për gjetjen e materialeve.

Sqarim: Përsa i përket argumenteve të paraqitura nga ana juaj, kategoria e licencës në nivelin C është për vlera midis 50-100 milion lekë, ndërkohë që fondi limit është 59,116,230 lekë pa tvsh. Duke qenë se asnjë nga zërat e veçanta të volumeve të punimeve nuk është në masën mbi 50 milion lekë, është e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

tepërt dhe e paargumentuar vendosja e këtij kriteri, pasi nuk janë të argumentuara me volumin e punimeve. Përsa i përket fabrikës së betonit, asfaltit dhe linjës së prodhimit të inerteve, nuk është kërkuar edhe forma kontratë furnizimi, por vetëm në pronësi apo me qera duke penguar pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve në këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu, numri i punonjësve i kërkuar nga ana juaj nuk është i argumentuar dhe detajuar sipas volumit të punimeve. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

2- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Kanali i ushqimit të kanalit Gorican”

19 Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Kanali i ushqimit të kanalit Gorican”, me fond limit 12,132,284 lekë pa tvsh.
Situata:	<p>Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, në kundërshtim me nenin 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 dhe neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2, si :</p> <p>a- në lidhje me kategoritë e kërkuara, sa më poshtme, nuk kanë lidhje kërkesa me volumet e punimeve:</p> <ul style="list-style-type: none">- NP-6 A, Diga dhe tunele hidroteknike.- NP-8 A, Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.- NP-9 A, Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.- NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.- NS-15 A, Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore. <p>b- Kërkuar certifikata ISO pa lidhje me objektin e prokurimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- DS CEN/TR 15128 :2005 mbi “Shqyrtimin e standardeve evropiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit”- EN - ISO 3834-2:2006 mbi “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim” <p>c- Nuk është argumentuar numri i fuqisë punëtore (80) me volumin e punimeve.</p> <p>d- është i paargumentuar me volume pune kërkesa për 14 inxhinierë. Gjithashtu edhe për arkitekt, agromjedis, gjeoinxhinier e mjedis, pasi nuk ka zëra pune në preventiv</p> <p>➤ Kërkohej që Drejtuesi teknik të jete i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, kërkesë e përcaktuar në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.</p> <p>Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit:</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px;"><p>“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në</p></div>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	<p>përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”</p> <p>ngarkohet me përgjegjësi NHJDT të përbërë nga E. S., A. P., M. B..</p> <p>Në zhvillimin e procedurës u konstatua se BOE “T.” shpk & “B. B.”shpk, me vlerë të ofertës 12,132,284 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues, në kushtet kur nuk plotëson kriteret për kualifikim pasi:</p> <ul style="list-style-type: none">- Në sistemin spe.gov.al ky Bashkim nuk ka deklaruar OE pjesë të bashkimit të përkohshëm;- Në akt marrëveshjen e lidhur midis palëve nuk janë përcaktuar punët konkrete që do të kryejë secili nga anëtarët <p>Sa më sipër ky BOE nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, gërma (ç), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3</p> <p>Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “B. B.” Shpk & “T.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën 12,105,167 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: R. Sh., B. B., V. J.</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Nga vendosja jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka pasur mungesë konkurrence, vetëm një operator ekonomik si dhe paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 12,105,167 lekë.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin praktikave të të vendosjes së kriterëve për kualifikim të pa argumentuara si dhe në procesin e ankimimit për kriteret e kualifikimit grupi i shqyrtimit të bazohet në objektin e kontratës. <p>KVO të zbatojë aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe DST për vlerësimin e ofertave.</p>

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për procedurën me objekt: “Kanali i ushqimit të kanalit Gorican”

Përsa komentoni se: Përsa i përket licencës profesionale dhe pikave të saj të kërkuar nga ana jonë ju informojmë që këto pika licence janë kërkuar duke u bazuar në preventivin e procedurës në fjalë, dhe volumet e punimeve. Kemi vendosur kriteret të cilat i vlerësojmë të nevojshme për realizimin e kontratës dhe në afatin kohor të parashikuar për realizim, për sa kohë që ka menduar që janë jodiskriminuese dhe nuk shkakton pabarazi. Ndërsa përsa i përket Iso-ve të kërkuara specifikuat për këtë procedurë BSEN 13331-1:2002 mbi “Sistemet për veshjen e kanaleve”, DS CEN/ TR 15128:2005 mbi “Shqyrtimin e standarteve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit” dhe ISO EN ISO 3834 -2:2006 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit” ju informojmë se duke u bazuar në preventivin e kësaj procedure janë kërkuar nga ana jonë këto ISO. Ku ndër punimeve të tjera ka edhe kanale kulluese në bazë të së cilës janë vendosur ISO-t në lidhje me kanalet. Kështu që operatori ekonomik duhet të vërtëtoj që është në gjendje të zbatoj këtë kontratë dhe që ka eksperiencë të mëparshme pasi është specializuar dhe certifikuar në këtë fushë. Përsa i përket vendimit për shfuqizim është i vitit 2018 ndërkohë që kjo procedurë është zhvilluar në 2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

dhe ka qënë në fuqi ky vendim, nëse do merrnim parasysh faktin që është shfuqizuar. Gjithsesi ju informojmë që këto ISO janë akoma në fuqi. Në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar nga ana jonë ju informojmë që ky numër punonjësish është kërkuar në përputhje me grafinkun e punimeve dhe afatit kohor të kërkuar për realizimin e kontratës. Përsa i përket konstatimit tuaj në lidhje me drejtuesin teknik të angazhuar në objekt ju bëjmë me dije se për veprat me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë drejtuesi teknik duhet të qëndrojë në objekt me kohë të plotë. Gjithsesi ju informojmë që në udhëzim nuk citohet diku në një pjesë të kësaj baze ligjore që kategorikisht ndalohet të qëndrojë në objekt një drejtues teknik për objektet nën vlerën 30,000,000 lekë.

Sqarim: Licensat e vendosura nga ana juaj nuk janë të argumentuara dhe të lidhura me volumet e punimeve që do të kryhen. Në lidhje me ISO-t e kërkuara, ritheksojmë sërish se ato kanë qënë të shfuqizuara në periudhën e zhvillimit të tenderit dhe vazhdojnë të jenë të shfuqizuara edhe sot. Numri i punonjësve të kërkuar nga ana juaj (për një vepër me fond limit prej 12,132,284 lekë pa tvsh) është i ekzagjeruar dhe i paargumentuar. E njëjta gjë vlen dhe për kërkesën tuaj për 14 inxhinierë apo për drejtuesin teknik që duhet të jetë me kohë të plotë, kërkesë kjo e fundit në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

3- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”

20 Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”, me fond limit 125,540,446 lekë pa tvsh.
Situata:	<p>Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, në kundërshtim me nenin 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 dhe neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2, si :</p> <p>NS-4 C, Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.</p> <p>NS-8 B, Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.</p> <p>NS-9 A, Punime strukturore speciale.</p> <p>NS-10 A, Shtresa dhe mbi struktura speciale.</p> <p>NS-19 A, Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë.</p> <p>➤ Në këtë kërkesë nuk janë argumentuar kategoritë C dhe B, ndërsa për 3 kategoritë e tjera nuk është argumentuar me volume pune të preventivit të punimeve.</p> <p>Në DT janë kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë certifikata cilësie në gjuhen shqipe, ose përkthyer dhe të noterizuara si me poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • BSEN 13331-1:2002 mbi “Sistemet për veshjen e kanaleve” (e vlefshme, duhet të plotësohet nga një prej anëtareve në rast bashkimi i OE) • DS CEN/TR 15128 :2005 mbi “Shqyrtimin e standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit” (e vlefshme, duhet të plotësohet nga një prej anëtareve në rast bashkimi i OE) • EN - ISO 3834-2:2006 mbi “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim” (e vlefshme, duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve në rast bashkimi i OE) • ISO 27001:2013 mbi “Menaxhimin e sigurisë së informacionit” (e vlefshme, duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve në rast bashkimi i OE)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

➤ Sa më sipër këto katër certifikata ISO, nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, pasi:

1- Certifikata ISO BSEN 13331-1:2002 mbi “Sistemet për veshjen e kanaleve” (e vlefshme, duhet te plotësohet nga një prej anëtareve ne rast bashkimi i OE).

2- Certifikata DS CEN/TR 15128 :2005 mbi “Shqyrtimin e standardeve europiane për riparimin e sistemeve te kanalizimit dhe kullimit” (e vlefshme, duhet te plotësohet nga një prej anëtareve ne rast bashkimi i OE)

Përsa i përket standardit DS CEN/TR 15128:2005 është standard për “Shqyrtimin e Standardeve Europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit”, standard ky i shfuqizuar, pra nuk është në fuqi nga momenti i shfuqizimit dhe nuk është zëvendësuar me standard/dokument tjetër, ndërsa për sa i përket standardit tjetër BS EN 13331- 1:2002, është standard britanik, ndërkohë që në Shqipëri ky standard është SSH EN 13331-1:2002 dhe ka të bëjë me “Sistemet për veshjen e kanaleve – Pjesa 1: Specifikime të produktit” – Publikuar, dhe është standard ne fuqi.

3- Në lidhje me certifikatën EN - ISO 3834-2:2006 mbi “Për Sistemin e menaxhimit te cilësisë ne saldim” (e vlefshme, duhet te plotësohet nga secili prej anëtareve ne rast bashkimi i OE)

Është **kërkesë e gabuar pasi certifikata EN-ISO 3834-2:2006** “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e certifikata ENISO 3834-2:2006 ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, Certifikimi i sipërcituar shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldim. Standardi EN ISO 3834-2 për certifikim ka të bëjë vetëm me burimin dhe cilësinë e produktit që mund të rrjedh nga burimi dhe operimet e ndërlydhura. Standardet janë përdorur si bazë për vlerësimin e cilësisë së saldimit të prodhuesve. Sa më sipër, referuar objektit të prokurimit objekt shqyrtimi, rezulton se nuk jemi në kushtet e blerjes së produkteve të prodhuara me metodën e shkrirjes me saldim, në mënyrë që të kërkohet që prodhuesi i tyre të disponojë certifikimin për standardin EN ISO 3834-2. Në këto kushte, kërkimi nga ana e autoritetit kontraktor për disponimin e certifikatës të sipërcituar, nuk është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor nuk duhej ta vendoste këtë kërkesë.

4- Në lidhje me certifikatën ISO 27001:2013 mbi “Menaxhimin e sigurisë se informacionit”

Sqarojmë se ISO 27001:2013 ka si objekt: specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe vazhdimisht përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit në kontekstin e organizatës. Ajo gjithashtu përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës. Kërkesat e përcaktuara në ISO / IEC 27001:2013 janë të përgjithshme dhe kanë për qëllim të jenë të zbatueshme për të gjitha organizatat, pavarësisht nga lloji, madhësia apo natyra. Objekti i prokurimit nuk ka të bëjë me asnjë përcjellje informacioni apo menaxhim informacioni pasi çdo gjë që është e nevojshme për realizimin e këtij projekti është e publikuar dhe nuk përbën aspak informacion sekret apo të klasifikuar. Kjo ISO nuk gjen mbështetje dhe është e panevojshme për këtë objekt prokurimi

Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit”.

Në DT janë kërkuar: 4 inxhinier te certifikuar për Sistemin e menaxhimit te sigurisë dhe mbrojtjen shëndetit ne pune.

➤ Duke qenë se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me certifikatën OHSAS 18001- 2007 mbi “Shëndetin dhe Sigurimin ne pune”, konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi certifikata OHSAS 18001-2007 në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë certifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet certifikuese ndaj dhe kjo certifikatë i jep garanci autoritetit kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në dokumentet e tenderit janë kërkuar: Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë një punësim mesatar jo me pak se **130 punonjësish**, për periudhën **Janar 2015 - Prill 2017** të vërtetuar me; Listë-pagesat e punonjësve sipas formatit qe kërkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën **Janar 2015 - Prill 2017, te shoqëruar me formularët e deklaramit te pagesave** për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

➤ **Sa më sipër:** nuk është argumentuar me grafikun e punimeve dhe volumet sipas preventivit kërkesa për numrin e fuqisë punëtore që duhet për realizimin e objektit.

Në DT janë kërkuar: është kërkuar Operatori ekonomik duhet te ketë inxhinier te siguruar sipas legjislacionit ne fuqi te shoqëruar me CV, diplome, kontrate pune, librezë pune edhe 2 arkitektë.

➤ **Në lidhje me kërkesën për arkitekt, sqarojmë se** në dokumentet e procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor ka publikuar njëherazi “Preventivin e punimeve”, “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike”, “Grafikun e punimeve” dhe “Projektin e Zbatimit”, duke i vënë në dispozicion, informacionin operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatojnë në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria si pjesë e stafit teknik të një arkitekti në fazën e zbatimit të punimeve, ku ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkuar referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit pjesë të stafit teknik, inxhinierët, si ndërtimi, hidroteknik, mekanik, gjeodet, elektrik, mjedisi, gjeolog, shkon përtej synimit të autoritetit kontraktor dhe njëherazi nuk është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës. Disponueshmëria e një arkitekti referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë faktin se autoriteti kontraktor ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.

Në DT janë kërkuar: Deklarate nga administratori shoqërisë për drejtuesin teknik te punimeve ne objekt te përfshire ne licencën e shoqërisë dhe te deklaroje se ai do te jete i pranishëm gjate gjithë kohës qe do te kryhen punimet ne objekt. Drejtuesi teknik duhet te ketë eksperience pune jo me pak se **5 vjet** te vërtetuar me: CV personale,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Kontrate pune midis tij dhe Operatorit Ekonomik, Licence, Diplome, **Certifikate kualifikimi Auditim Energjie, Leje ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.**

➤ Në lidhje me kërkesën certifikatë kualifikimi për **Auditim Energjie** për drejtuesin teknik, sqarojmë se:

Në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr.125/2015 “Për efincencën e energjisë” parashikohet se:“ 4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për: a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie; b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Efincencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efincencës së energjisë. 5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij neni; b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.”

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka publikuar njëherazi “Preventivin e punimeve”, “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike”, “Grafikun e punimeve” dhe “Projektin e Zbatimit”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike” kryerjen e shërbimit të auditimit të efincencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjetik të licencuar. Gjithashtu autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të efincencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.124/2015 “Për efincencën e energjisë”, autoriteti kontraktor në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë

➤ Në lidhje me kërkesën **Leje ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin** për drejtuesin teknik, sqarojmë se:

Kërkesa e autoritetit kontraktor, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, roli i ekspertit zjarrfikës me leje nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës, në kuptim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

Në dokumentet e tenderit është kërkuar që Operatori ekonomik duhet te ketë 1 **arkitekt restaurator** te pajisur me kontrate pune, CV, licence ne zbatim ne restaurimin e monumenteve te trashëgimisë se arkitekturës sipas kategorive : AZ/2, AZ/3.

➤ Nuk është argumentuar kjo kërkesë me objektin e prokurimit.

Në dokumentet e tenderit është kërkuar që Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te dëshmojnë se disponojnë mjetet për realizimin me sukses te objektit te prokurimit, pa përcaktuar tonazhin e tyre apo karakteristika të tjera që do të shërbejnë për realizimin e objektit.

Ndërsa në lidhje me

10	Fabrike Betoni (ne pronësi ose me qira)	1 cope
11	Fabrike për prodhim asfalti Mobile (e lëvizshme) (ne pronësi ose me qira)	1 cope



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

23	Linje për larjen fraksionimin e zhavorrit (shoqëruar me vërtetim pronësie)	1 cope
24	Linje prodhimi inerte (Gurore) (shoqëruar me vërtetim pronësie)	1 cope
25	Repart parafabrikatesh te lehta (shoqëruar me vërtetim pronësie)	1 cope
26	Repart parafabrikatesh te renda (shoqëruar me vërtetim pronësie)	1 cope
27	Repart I hekurit (shoqëruar me vërtetim pronësie)	1 cope
28	Reparti konstruksionit (shoqëruar me vërtetim pronësie)	1 cope
29	Reparti I prodhimit te betonit (shoqëruar me vërtetim pronësie)	1 cope

➤ Nga ana e AK nuk është kërkuar edhe forma **kontratë furnizimi**. Fryma dhe qëllimi i LPP është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në këtë kuptim, referuar zërave të termave të referencës, grafikut të punimeve dhe afatit kohor për realizimin e punimeve konstatohet se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e operatorit ekonomik të llojit të makinerive të mësipërme është e ekzagjeruar. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse punimet do të kryhen në zbatim të specifikimeve teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së.

Materialet e ndërtimit që përdoren në objekt (Inerte dhe betone etj.), janë në një treg të lirë dhe furnitorët ose prodhuesit e tyre ushtrojnë veprimtarin në përputhje me kërkesat e palëve brenda standardeve ligjore të shtetit shqiptar. Sipas specifikimeve që ka objekti është e detyrueshme të bëhet furnizimi, dhe kjo të realizohet me kontrata dy palëshe furnizimi ku përcaktohen detyrimet dhe kërkesat e palëve brenda kërkesave dhe standardeve ligjore”.

- Në dokumentet e tenderit në kriteret e veçanta për kualifikim është kërkuar që:

“**Do të organizohet një vizitë në kantier në date** (10 dite para hapjes se tenderit) në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familjarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t’u jepen informacione shtesë e shpjegime dhe të cilat do tu shpërndahen të gjithë Operatorëve Ekonomikë. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t’a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur”.

➤ Vendosja e kësaj kërkesë në kriteret e veçanta për kualifikim është në kundërshtim me DST, të miratuara për vitin përkatës. Kjo kërkesë është pjesë e kapitullit II. Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1. “Hartimi i ofertës”, pika 1.3, ku është përcaktuar se:

(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier në _____ (dd/mm/vv) në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familjarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime dhe të cilat do tu shpërndahen të gjithë Operatorëve Ekonomikë. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Theksojmë se vendosja e sa në kriteret e veçanta për kualifikim bëhet në një kohë që operatorët ekonomikë kanë marrë informacion të hollësishëm dhe të mjaftueshëm mbi gjendjen aktuale të objektit, kjo me anë të informacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike si specifikimet teknike, preventivi, etj. Mos pjesëmarrja në takimin e organizuar, nuk mund të penalizojë operatorët ekonomikë pjesëmarrës gjatë vlerësimit të ofertave për të konsideruar të suksesshme ose jo ofertën e tyre ekonomike të dorëzuar në procedurën e prokurimit, por në rast të zbatimit të kontratës, këta të fundit nuk mund të ngrenë pretendime shtesë mbi mos pasjen dijeni për elementë konkretë të zbatimit në terren, për të cilat mund të ishin vënë në dijeni në momentin e organizimit të takimit në terren, duke qenë një herazi në përgjegjësinë e këtyre të fundit zbatimi me korrektësi i kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

mbajnë përgjegjësi Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit e përbërë nga: E. S., A. P., M. B.

Ankimime për DT: Në lidhje me DT është paraqitur ankimim nga OE “S.” shpk, e protokolluar në Bashkinë Ura Vajgurore me nr.1738, datë 12.07.2017, (41 fletë e gjithë procedura e ankimimit), i cili ankimohet në AK në lidhje me:

- Certifikatat ISO: “Mbi sistemet e veshjes së kanaleve” dhe “Shqyrtimin e standardeve europiane për riparimin e sisteme të kanalizimit dhe kullimit”, Katër inxhinier të certifikuar për sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe mbrojtjen në punë”, Certifikatë për punime në lartësi”, Stafin teknik , Auditim energjie, Inxhinier pyjesh, Arkitekt restaurator, Punonjësit e pajisur me kartela (60), Inxhinier informatikë, inxh hidro, etj, Per repartet e parafabrikat, të lehta e të rënda, hekuri, konstruksioni.

Nga ana e Titullarit të Autoritetit Kontraktor , me urdhrin numër 1738/1, datë 12.07.2017, është urdhëruar pezullimi i procedurës së prokurimit dhe është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e ankesës i përbërë nga: V. Sh.; I. Sh.; A. Gj.

Grupi i punës ka hartuar procesverbalin nr.1738/3, datë 13.07.2017, ku ka marrë në konsideratë sa vijon:

Nr.	Ankimimi sipas kriterit	Qëndrimi i grupit shqyrtues
1	Certifikatat ISO: “Mbi sistemet e veshjes së kanaleve” dhe “Shqyrtimin e standardeve europiane për riparimin e sisteme të kanalizimit dhe kullimit”	Nuk ndryshon
2	Katër inxhinier të certifikuar për sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe mbrojtjen në punë”	Nuk ndryshon
3	Certifikatë për punime në lartësi	Hiqet
4	Stafin teknik	Nuk ndryshon
5	Auditim energjie	Nuk ndryshon
6	Inxhinier pyjesh	Nuk ndryshon
7	Arkitekt restaurator	Nuk ndryshon
8	Punonjësit e pajisur me kartela (60)	Nuk ndryshon
9	Elektracist 6	Të jenë 2



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

10	Inxhinier informatik	hiqet
11	Të tjerat nuk ndryshojnë	

Sa më sipër nga ana e këtij grupi në asnjë rast nuk është bërë argumentimi me volume pune i kërkesave për kualifikim. Në këtë proces verbal ato përdorin shprehje si mund te ketë, e mund te mos ketë të cilat janë shprehje evazive dhe subjektive, jo argumentuese.

Vendimi i grupit të punës për sa më lartë mban numër 1738/4, datë 17.07.2017.

Kthim përgjigje ankimesit me numër 1738/5, datë 17.07.2017.

Shtojca e DT mban datën 1738/6, datë 17.07.2017, dhe data e hapjes së tenderit është shtyrë për 07.08.2017.

Sa më sipër, për mos shqyrtimin e ankimit për kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

mbajnë përgjegjësi grupi i punës për shqyrtimin e ankimit i përbërë nga V. Sh.; I. Sh.; A. Gj..

Zhvillimi i procedurës së prokurimit: procedura e prokurimit është hapur me procesverbalin nr.1541/6, datë 07.08.2017. Në të kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar nga KVO sa vijon:

Nr.	Operatorët ekonomikë pjesmarrës	Oferta ekonomike	Arësyet e kualifikimit apo të s' kualifikimit:
1	“F.”shpk	0	S' kualifikuar pasi ka paraqitur vetëm QKB
2	“T.” shpk & “L. K.” shpk	125,006,973	Kualifikuar e shpallur fitues.

Raporti përmbledhës nr.1541/9, datë 17.08.2017, është miratuar nga Titullari i AK po në këtë datë. Formulari i njoftimit të fituesit nr.1541/10, datë 17.08.2017.

Auditimi i ofertës fituese të BOE:

Nga auditimi rezulton se ky BOE ka lidhur kontratë bashkëpunimi të përkohëshme. Në këtë kontratë ka përcaktuar përqindjen totale të punëve dhe jo punët konkrete që do të kryejë secili anëtar i bashkimit, sa vijon:

Në kundërshtim me VKM nr.914, datë “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndyshuar, neni 74, pika 2.

OE “T.”shpk, ka marrë pjesë në datën 21.06.2017 në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani”. Në këtë procedurë ka marrë përsipër 40% të punimeve, që do të thotë se do të vërë në dispozicion për një periudhë 5 mujore 32 punonjës (nga 80 që kërkohen gjithsej).

Numri mesatar i punonjësve të OE T. për periudhën janar 2015-prill 2017 është afro 38. Ndërkohë që për procedurën e prokurimit rikonstruksion rrugësh, të zhvilluar në datën 07.08.2017, është kërkuar një punësim mesatar prej 130 punonjësish. OE T. ka marrë përsipër 80% të punimeve dhe ka një numër mesatar prej 38 punonjësish për periudhën e kërkuar në DST (ndërkohë që 32 punonjës i ka të angazhuar në shkollën Refat Bani). Pra duket qartë që nuk e plotëson kriterin për sa i përket numrit të punonjësve.

Ka deklaruar një pjesë të konsiderueshme të makinerive në të dyja procedurat e prokurimit dhe më konkretisht:

Me qera: Kamion M. B. me targa AA...CE; Kamion A. me targa AA...FH

Në pronësi Fadromë JCB BR....A, Mini Eskavator tipi H., Bobcat case 440,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	<p>Eskavator me goma Fiat Hitach 220 ZM, Kamionçinë M. B. me targa BR...B, Kamionçinë M. AA...AH, Kamionçinë M. me vinç me targa AA...LF.</p> <p>Në përmbushje të kriterit të punëve të ngjashme, ka deklaruar disa punë të ngjashme në 3 vitet e fundit. Njëra ndër to është lidhur me bashkinë Poliçan ku ka marrë pjesë së bashku me një operator tjetër. Për kryerjen e kësaj pune nuk ka hapur nipt sekondar dhe për rrjedhojë nuk ka paguar taksat në këtë bashki.</p> <p>Sa më sipër ky BOE nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, gërma (ç), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3</p> <p>Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën 125,006,973 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: P. S., M. A. dhe B. R..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Nga vendosja jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka pasur mungesë konkurrence, vetëm një operator ekonomik si dhe paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën 125,006,973 lekë.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin praktikave të të vendosjes së kriterëve për kualifikim të pa argumentuara si dhe në procesin e ankimimit për kriteret e kualifikimit grupi i shqyrtimit të bazohet në objektin e kontratës.
	KVO të zbatojë aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe DST për vlerësimin e ofertave.

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për procedurën **me objekt: “Rikonstruksione rrugësh në bashkinë Ura Vajgurore”.**

Për sa komentoni se: Në lidhje me oponencën për këtë objekt ju informojmë projekti është i përbërë nga shumë projekte të vogla të cilët nuk e kalojnë vlerën e 100 milionëve dhe nuk e kanë të nevojshme kryerjen e oponencës teknike. Përsa i përket licencës profesionale dhe pikave të saj të kërkuar nga ana jonë ju informojmë që këto pika licence janë kërkuar duke u bazuar në preventivin e procedurës në fjalë, volumet e punimeve. Janë vendosur kriteret e cilat i vlerëson të nevojshme për realizimin e kontratës dhe në afatin kohor të parashikuar për realizim, për sa kohë që ka menduar që janë jodiskriminuese dhe nuk shkakton pabarazi, ndër të tjerash ky është një objekt me fond limit mbi **101** milion lekë që i përket kategorisë **“D”**, ndaj nuk shohim këtu asnjë ekzagjerim nga ana jonë. Ndërsa përsa i përket ISO-ve të kërkuara specifikisht për këtë procedurë BSEN 13331-1:2002 mbi “Sistemet për veshjen e kanaleve” dhe DS CEN/ TR 15128:2005 mbi “Shqyrtimin e standarteve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit” ISO EN ISO 3834 -2:2006 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, ISO nr.27001:2013 “Për menaxhimin e sigurisë së Informacionit”, ju informojmë se duke u bazuar në preventivin e kësaj procedure janë kërkuar nga ana jonë këto ISO. Ku ndër punimeve të tjera ka edhe kanale kulluese në bazë të së cilës janë vendosur ISO-t në lidhje me kanalet. Kështu që operatori ekonomik duhet të vërtëtojë që është në gjendje të zbatojë këtë kontratë dhe që ka eksperiencë të mëparshme pasi është specializuar dhe certifikuar në këtë fushë. Përsa i përket vendimit për shfuqizim është i vitit 2018 ndërkohë që kjo procedurë është zhvilluar në 2017 dhe ka qënë në fuqi ky vendim, nëse do merrnim parasysh faktin që është shfuqizuar. Gjithsesi ju informojmë që këto ISO janë akoma në fuqi. Në lidhje me numrin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

punonjësve të kërkuar nga ana jonë ju informojmë që ky numër punonjësish është kërkuar në përputhje me grafikun e punimeve dhe afatit kohor të kërkuar për realizimin e kontratës. Përsa i përket Inxhinierëve të kërkuar si dhe Arkitektit për këtë procedurë, ju informojmë se: *Bazuar në VKM nr. 914 datë 10.01.2007, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 8/b ku kërkohet dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për realizimin e kësaj kontrate.* Përsa i përket kriterit në lidhje me drejtuesin teknik të pajisur me Certifikatë Auditimi dhe leje në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, nuk është aspak kriter i ekzagjeruar pasi operatori ekonomik duhet të vërtetohet aftësitë teknike.

Në lidhje me mjetet e kërkuara nga ana jonë si Fabrikë betoni, Fabrikë asfalti, etj., janë kërkuar për arsye të uljes së kostos, nuk shohim aspak ekzagjerim pasi këto mjete janë kërkuar në të gjitha format e lejueshme të legjislacionit në fuqi, ose në pronësi ose me një kontratë që të vërtetohet që kjo kontratë do të realizohet pa hasur vështirësi në zbatim për gjetjen e materialeve.

Në lidhje me kriterin për një vizitë në kantier nuk shohim asnjë arsye penalizimi edhe mos pjesëmarrja në këtë vizitë na kantier. Nuk kemi shprehur diku në kritere që mos paraqitja do jetë kusht skualifikimi. Kjo vizitë në kantier bëhet që këta operator të familjarizohen me kushtet lokale.

Në lidhje me grupin e punës të ngritur me nr. 1738/1 Prot., datë 12.07.2017 të përbërë prej 3 antarësh V. Sh., Igrid Shkempi, A. Gj. ju informojmë që grupi i punës ka marrë në konsideratë ato kritere që në mendimin tonë duke u njohur dhe me dokumentacionin e tenderit ishin jo në përputhje me preventivin. Ndërsa përsa i përket kërkesave që nuk janë marrë parasysht nga ana jonë mendojmë që ato kritere janë të nevojshme për realizimin e kësaj kontrate si dhe janë të mirëmenduar nga ana e Njësisë së Prokurimit duke marrë në konsideratë vështirësinë e këtij objekti si dhe sipërfaqen e shtrirjes në këtë zonë.

Sqarim: Fillimisht jeni shprehur se projekti është i përbërë nga shumë projekte të vogla të cilat nuk e kalojnë vlerën e 100 milionëve dhe nuk e kanë të nevojshme oponencën teknike, ndërsa më poshtë te vendosja e licencës jeni shprehur që vlera e fondit limit është mbi 101 milion lekë dhe prandaj keni kërkuar kategorinë “D”. Mungesa e oponencës teknike është në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar në të cilin është përcaktuar se ... *Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha lejet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milion lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve.* Në lidhje me ISO-t e kërkuara, ritheksojmë sërish se ato kanë qenë të shfuqizuara në periudhën e zhvillimit të tenderit dhe vazhdojnë të jenë të shfuqizuara edhe sot. Përsa i përket numrit të fuqisë punëtore të kërkuar, nuk është argumentuar me grafikun dhe volumet e punimeve sipas preventivit. Përsa i përket fabrikës së betonit, asfaltit dhe linjës së prodhimit të inerteve, nuk është kërkuar edhe forma kontratë furnizimi, por vetëm në pronësi apo me qera duke penguar pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve në këtë procedurë prokurimi. Vendosja e kriterit për vizitën në kantier bëhet në një kohë që operatorët ekonomikë kanë marrë informacion të hollësishëm dhe të mjaftueshëm mbi gjendjen aktuale të objektit, kjo me anë të informacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike si specifikimet teknike, preventivi, etj., pra është kërkesë e panevojshme dhe e paargumentuar. Përsa i përket shqyrtimit të ankesave nga grupi i punës, nga ana e këtij grupi në asnjë rast nuk është bërë argumentimi me volume pune i kërkesave për kualifikim. Në proces verbal janë përdorur shprehje si mund të ketë, e mund të mos ketë të cilat janë shprehje evazive dhe subjektive, jo argumentuese. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana e juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

4- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Ndërrhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga Stacioni pompave Poshnjë”.

21 Gjetjes:	Titulli i	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërrhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga Stacioni pompave Poshnjë”, me fond limit 82,762,312 lekë pa tvsh.
Situata:		Mungesa e argumentimit të kritereve të veçanta të vendosura në DST nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

njësia e prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, si kërkesat për certifikata ISO, mjek, restorator në stafin teknik të shoqërisë, arkitekt, numri i punonjësve, makineritë, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

Në DT janë kërkuar: Vërtetim nga Bashkia, se ofertuesi nuk ka detyrime ndaj Autoritetit Tonë (Bashkisë Ura Vajgurore), në kundërshtim me nenin 46, pika 1, e LPP ku përcaktohet se “1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese”, për rrjedhojë legjislacioni i prokurimit publik kërkon që kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta dhe të mirë përcaktuara nga AK, me qëllim që të jenë sa më të mirkuptueshme jo vetëm nga OE por edhe në funksion të procesit të vlerësimit. AK ka informacionin e nevojshëm në lidhje me detyrimet që OE mund të kenë në Bashki. Në këtë kuptim kërkesa e AK për paraqitjen e këtij vërtetimi konsiderohet e panevojshme dhe pengesë për ofertuesit pjesëmarrës në këtë procedurë. Gjithashtu kjo kërkesë frenon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik.

Në DT janë kërkuar: Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë një punësim mesatar jo me pak se 100 punonjësish, për periudhën Qershor 2016 - Mars 2017 Sa më sipër nga ana e AK nuk janë argumentuar me grafikun e punimeve dhe volumet e preventivit numri i fuqisë punëtore.

Në dokumentet e tenderit është kërkuar që: Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik që të figurojnë në licencën e shoqërisë dhe në listë pagesa.

Sa më sipër duhet të paraqesë kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV si më poshtë: Inxhinier Ndërtimi (2) Inxhinier Mjedisi (1) Inxhinier Hidroteknik (2) Inxhinier Topograf (2) Inxhinier Elektrik (1) Inxhinier Mekanik (1) Inxhinier gjeolog (1)

➤ **Numri prej 10 inxhinierësh në staf** si drejtues teknik, është i fryrë dhe ul konkurrencën në procedurë. OE mund të marrë staf edhe të punësuar me kontratë. Gjithashtu sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor që stafi i punonjësve të jetë i pasqyruar në listë pagesa, **kjo kërkesë kufizon numrin e shoqërive pjesëmarrëse që nuk zotërojnë staf teknik të përhershëm** (gjë që reflektohet në listë pagesat e shoqërisë), por që kanë mundësinë t’u sigurojnë këtë staf, duke lidhur kontrata pune me afat sa afati i kontratës objekt prokurimi.

➤ **Gjithashtu nuk është argumentuar me volum punimesh kërkesa për këtë staf të drejtuesve teknikë.**

Në dokumentet e tenderit është kërkuar: Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, për këtë duhet të paraqesin: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për të cilat nuk ka paraqitur tonazhin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

apo karakteristikë tjetër për mjetet për përmbushjen e objektit të kontratës.

Janë kërkuar:

Fabrik Betoni me QKL	1 cope	Pronesi ose me qera
Nyje intertesh me material lumi	1 cope	Pronesi ose me qera

➤ Sa më nga ana e AK nuk është kërkuar edhe forma kontratë furnizimi. Fryma dhe qëllimi i LPP është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në këtë kuptim, referuar zërave të termave të referencës, grafikut të punimeve dhe afatit kohor për realizimin e punimeve konstatohet se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e operatorit ekonomik të llojit të makinerive të mësipërme është e ekzagjruar. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse punimet do të kryhen në zbatim të specifikimeve teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së.

Materialet e ndërtimit që përdoren në objekt (Inerte dhe betone etj.), janë në një treg të lirë dhe furnitorët ose prodhuesit e tyre ushtrojnë veprimtarin në përputhje me kërkesat e palëve brenda standardeve ligjore të shtetit shqiptar. Sipas specifikimeve që ka objekti është e detyrueshme të bëhet furnizimi, dhe kjo të realizohet me kontrata dy palëshe furnizimi ku përcaktohen detyrimet dhe kërkesat e palëve brenda kërkesave dhe standardeve ligjore”. Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”
--

mbajnë përgjegjësi Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit e përbërë nga: E. S., A. P. dhe M. B.

Kontrata është vulosur vetëm nga “B.”shpk, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 74

“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 2

Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatim i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.
---------------------	--

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për procedurën me objekt: **“Ndërhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga stacioni pompave Poshnje”**

Përsa komentoni se: Përsa i përket kriterit të kërkuar nga ana jonë në lidhje me vërtetimin e taksave vendore të Bashkisë Urë Vajgurore, me anë të së cilës operatori ekonomik vërteton që nuk ka detyrime ndaj këtij Autoriteti, nuk shohim ndonjë kriter diskriminues dhe të tepruar. Në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar nga ana jonë ju informojmë që ky numër punonjësish është kërkuar në përputhje me grafikun e punimeve dhe afatit kohor të kërkuar për realizimin e kontratës. Përsa i përket Inxhinierëve të kërkuar për këtë procedurë, ju informojmë se: *Bazuar në VKM nr. 914 datë 10.01.2007, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 8/b ku kërkohet dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për realizimin e kësaj kontrate.* Në lidhje me mjetet e kërkuara nga ana jonë si Fabrikë betoni, Nyje inertesh, janë kërkuar për arsye të uljes së kostos, nuk shohim aspak ekzagjerim pasi këto mjete janë kërkuar në të gjitha format e lejueshme të legjislacionit në fuqi, ose në pronësi ose me një kontratë që të vërtetohet që kjo kontratë do të realizohet pa hasur vështirësi në zbatim për gjetjen e materialeve.

Sqarim: AK ka informacionin e nevojshëm në lidhje me detyrimet që OE mund të kenë në Bashki. Në këtë kuptim kërkesa e AK për paraqitjen e këtij vërtetimi konsiderohet e panevojshme dhe pengesë për ofertuesit pjesëmarrës në këtë procedurë. Në lidhje me numrin e punonjësve nuk është argumentuar me grafikun e punimeve dhe volumet e preventivit numri i fuqisë punëtore. Numri prej 10 inxhinierësh në staf si drejtues teknik, është i fryrë dhe ul konkurrencën në procedurë. OE mund të marrë staf edhe të punësuar me kontratë. Gjithashtu nuk është argumentuar me volum punimesh kërkesa për këtë staf të drejtuesve teknikë. Përsa i përket fabrikës së betonit, asfaltit dhe linjës së prodhimit të inerteve, nuk është kërkuar edhe forma kontratë furnizimi, por vetëm në pronësi apo me qera duke penguar pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve në këtë procedurë prokurimi. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana e juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

5- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **“Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “Refat Bani”**.

22 Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani” , me fond limit 53,370,127 lekë pa tvsh.
Situata:	Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, si kërkesat për certifikata ISO, mjek, restaurator në stafin teknik të shoqërisë, arkitekt, numri i punonjësve, makineritë, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2. Ka fituar vlera më e ulët e ofruar nga BOE “T.” shpk, “F.” shpk dhe “B. B..” shpk në vlerën 53,185,598 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të BOE të shpallur fitues rezultuan këto mangësi: Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e OE “F.” shpk janë si më poshtë: Për të plotësuar kriterin e punëve të ngjashme, OE “F.” shpk, ka paraqitur 2 kontrata për punë të ngjashme të lidhura me Bashkinë Belsh dhe me Bashkinë Berat por OE “F.” shpk, nuk ka pasqyruar në Ekstraktin e QKR-së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

	<p>edhe këto vende të zhvillimit të biznesit si dhe hapjen e niptit sekondar e për rrjedhojë nuk ka paraqitur as vërtetim për shlyerjen e taksave në këto 2 Bashki. Mosregjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit nr. 131/2015 “Për qendrën kombëtare të biznesit”, si dhe ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.</p> <p>Mungojnë kategoritë e licensave: NP 12B; NS 1B; NS 4B; NS 8B; NS 9B; NS 10B; NS 13B; NS 14B dhe NS 18B.</p> <p>Të njëjtën mangësi si më sipër ka dhe OE “T.” shpk, pasi ka paraqitur si punë të ngjashme një kontratë të lidhur me Bashkinë Poliçan, por nuk ka hapur nipt sekondar dhe nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksash në këtë bashki.</p> <p>Mungojnë kategoritë e licensave: NP 1B; NP 12B; NS 8B; NS 9B; NS 10B; NS 13B; NS 14B dhe NS 18B.</p> <p>OE “B. B..” shpk ka mangësi përsa i përket numrit të fuqisë punëtore të kërkuar në DST si shoferë, manovratorë, automakinist, etj. pasi shumica e tyre nuk figurojnë në listëpagesa.</p> <p>Gjithashtu nuk i ka të vlefshme Certifikatat ISO ISO 14001-2004; Certifikata OHSAS 18001-2007; Certifikata PAS 99-2012 dhe Certifikata ISO 39001-2012.</p> <p>OE “B. B..” ka paraqitur këto ISO si më sipër të cilat nuk janë të vlefshme, pasi kanë skaduar në datën 11.06.2017 dhe nuk janë rinovuar.</p> <p>Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e BOE “B. B..” Shpk & “F.” shpk & “T.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën 53,185,598 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: znj. B. B., znj. V. J. dhe znj. R. Sh..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Ura Vajguore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020

Sqarim: Pas përfundimit të aktkonstatimeve nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasysh. Duke qenë se të njëjtat observacione janë bërë edhe për projekt raportin dhe nuk ka asnjë provë apo fakt të ri, nuk janë marrë parasysh.

6- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Sistemim varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajguore”.

23 Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemim varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajguore”, me fond limit 29,928,045 lekë
------------------------------	--



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	pa tvsh.
Situata:	<p>Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, si kërkesat për certifikata ISO, numri i punonjësve, inxhinierët, makineritë, liçensa për volumin e punimeve në vlerë më të madhe se fondi limit, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika 2.</p> <p>Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 2 OE, një prej tyre nuk ka paraqitur ofertë dhe ka fituar oferta e ofruar nga BOE “T.” shpk, “K.” shpk në vlerën 29,304,545 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të BOE të shpallur fitues rezultuan këto mangësi:</p> <p>Numri mesatar i punonjësve i kërkuar për procedurën e prokurimit “Sistemim varrezash dhe rruga hyrëse e Bashkisë Ura Vajgurore” është 30. Mesatarja e punonjësve për OE “T.” shpk është 38 punonjës. Duke marrë parasysh se është shpallur fituese edhe në procedurën tjetër (shkolla e mesme Refat Bani, ku numri i punëtorëve të angazhuar do të jetë 32), rezulton se numri i punëtorëve të disponueshëm për këtë procedurë janë vetëm 6, ndërkohë që sipas ndarjes së detyrave duhet të ofrojë 18 punonjës, dhe nuk ofron garanci për kryerjen e punimeve në kohë dhe me cilësi.</p> <p>Për të plotësuar kriterin e punëve të ngjashme, OE “K.” shpk, ka paraqitur 2 kontrata të lidhura me OSHEE Drejtoria Rajonale Berat dhe Bashkia Ura Vajgurore. Të dyja këto kontrata të marra së bashku nuk e plotësojnë kriterin për punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, asnjëra prej këtyre kontratave nuk e plotëson kriterin për punë të ngjashme në një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet gjatë tri viteve të fundit. Përveç kësaj, këto dy kontrata të paraqitura, në pjesën më të madhe të tyre kanë zëra punimesh që nuk kanë aspak lidhje me këtë procedurë prokurimi. Në këto kushte, OE “K.” shpk nuk e plotëson këtë kriter të vendosur në DST.</p> <p>Gjithashtu OE “K.” shpk nuk e plotëson kriterin e xhiros mesatare vjetore të 3 viteve të fundit ushtrimore, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, pasi xhiroja mesatare e këtyre 3 viteve është 11,751,655 lekë ndërkohë që fondi limit është 29,928,045 lekë. Edhe ky kriter nuk plotësohet nga ana e OE “K.” shpk.</p> <p>Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e BOE “K.” shpk & “T.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën 29,304,545 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: znj. B. B., znj. V. M. dhe znj. R. Sh..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.
---------------------	--

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020

Sqarim: Pas përfundimit të aktkonstatimeve nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasys. Duke qenë se të njëjtat observacione janë bërë edhe për projekt raportin dhe nuk ka asnjë provë apo fakt të ri, nuk janë marrë parasys.

7- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Rikonstruksioni Ura Vajgurore – Poshnjë dhe Bypass Ciflik (Rehabilitimin e skemave ujitëse)”.

24 Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni Ura Vajgurore – Poshnjë dhe Bypass Ciflik (Rehabilitimin e skemave ujitëse)”, me fond limit 12,499,868 lekë pa tvsh .
Situata:	<p>Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, si kërkesat për certifikata ISO, numri i punonjësve, arkitekt, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.</p> <p>Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 2 OE, është s’kualifikuar oferta me vlerën më të lartë për mangësi në dokumentacion dhe është shpallur fituese oferta me vlerën më të ulët e ofruar nga BOE “T.” shpk, “F.” shpk në vlerën 12,431,368 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të BOE të shpallur fitues rezultuan këto mangësi:</p> <p>Këta dy operatorë kanë marrë pjesë (dhe fituar) në një procedurë prokurimi me objekt “Rikonstruksionin e shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani”, me fond limit 53,370,127 lekë pa tvsh, në të cilën kanë deklaruar si drejtues teknike të punimeve znj. A. B.. Kontrata për rikonstruksionin e shkollës është nënshkruar në datën 11.08.2017 për një afat 5 mujor. Në këto kushte, drejtuesja teknike znj. A. B. është e angazhuar me kohë të plotë në kryerjen e punimeve të rikonstruksionit të shkollës Refat Bani. Sipas Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, në Kreun I/2.1, përcaktohet se “Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.</p> <p>Mesatarja e punonjësve për OE “T.” shpk është 38 punonjës ndërsa për OE “F.” shpk është 48 punonjës. Këto dy operatorë kanë të angazhuar në rikonstruksionin e shkollës Refat Bani, sipas përqindjes së ndarjes së punimeve respektivisht 32 dhe 16 punonjës. Në këto kushte asnjë nga këta dy operatorë nuk e plotëson kriterin prej 70 punonjësish të kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor për “Rikonstruksionin Ura Vajgurore – Poshnjë dhe Bypass Ciflik”. Për plotësimin e kriterit të punëve të ngjashme, OE “F.” shpk, ka paraqitur kontratën e lidhur me Bordin Rajonal të Kullimit Korçë. Vlera e kontratës është 22,365,867 lekë me TVSH. OE “F.” shpk, nuk ka pasqyruar në Ekstraktin e QKR-së edhe këtë vend të zhvillimit të biznesit si</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

	<p>dhe hapjen e niptit sekondar e për rrjedhojë nuk ka paraqitur as vërtetim për shlyerjen e taksave në këtë Bashki. Mosregjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit nr. 131/2015 “Për qendrën kombëtare të biznesit”, si dhe ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.</p> <p>Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e BOE “F.” shpk & “T.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 12,431,368 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO: z. A. P., znj. M. M. dhe z. B. R..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Ura Vajguore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020

Sqarim: Pas përfundimit të aktkonstatimeve nga Njësia e Prokurimit janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasys. Duke qenë se të njëjtat observacione janë bërë edhe për projekt raportin dhe nuk ka asnjë provë apo fakt të ri, nuk janë marrë parasys.

Komente të paraqitura nga KVO me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për procedurën **me objekt: “Rikonstruksioni Ura-Vajguore Poshnje dhe Bypass Ciflik (Rehabilitimi i skemave ujitëse)”**:

Për sa komentoni se: Përsa i përket deklaratimit të drejtueses teknike A. B. me kohë të plotë edhe në tenderin “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani”, ju sqarojmë se për veprat me vlerë të plotë të preventivuar mbi 30,000,000 lekë drejtuesi teknik duhet të qëndrojë me kohë të plotë, por në udhëzim nuk citohet që kategorikisht ndalohet të qëndrojë në objekt një drejtues teknik për objektet nën vlerën 30,000,000 lekë.

Përsa i përket kriterit të vendosur për numrin e punonjësve, këta dy OE kanë të angazhuar në shkollën Refat Bani respektivisht 32 dhe 16 punonjës, ju sqarojmë se numri i punonjësve është lehtësisht i verifikueshëm në listpagesa dhe punimet janë kryer sipas projektit dhe kërkesave duke e përmbushur detyrimin kontraktor mbi kryerjen dhe realizimin e punimeve. E njëjta gjë edhe përsa i përket makinerive. Bilancet janë të certifikuara ose të noterizuara në përmbajtjen e tyre dhe nuk përbëjnë element për pasaktësi. Përsa i përket kriterit të punëve të ngjashme të cilat nuk janë pasqyruar në ekstraktin e QKR, KVO ka marrë në konsideratë kriteret e vendosura në DST.

Sqarim: Së pari, nga OE “T.” shpk është bërë deklaratim i rremë, pasi ka deklaruar si inxhinierë që do ndjekë punimet në këtë vepër znj. A. B., e cila është e angazhuar me kohë të plotë në rikonstruksionin e shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani. Në lidhje me numrin e punonjësve, të dy këto OE së bashku kanë një numër mesatar prej 86 punonjësish, ku 50 prej tyre janë të angazhuar në punimet e shkollës Refat Bani. E njëjta gjë dhe për makineritë, pasi nga OE “T.” makineritë janë deklaruar si të lira ndërkohë që ato janë të angazhuara në punimet e shkollës Refat Bani. Përsa i përket bilanceve, ato janë me vullë vetëm në faqen e parë dhe nuk janë të noterizuara, duke mos ofruar garanci se përmbajtja e bilancit është e saktë. Në lidhje me kriterin e punëve të ngjashme, është detyra e KVO të verifikojë të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit dhe nuk mund të shpallë fitues një OE e cila kryen punime në bashki të tjera të cilat nuk i pasqyrojnë në ekstraktin e QKR dhe për rrjedhojë nuk paguan as detyrimet vendore. Përsa më sipër komentet e bëra



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

nga ana e juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

8- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Hartim i Projekt Preventivave për Qëndrat e Mbetura pa Projekt (Qendrat e Fshatrave)”.

25 Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Hartim i Projekt Preventivave për Qëndrat e Mbetura pa Projekt (Qendrat e Fshatrave)”, me fond limit 1,250,000 lekë pa tvsh.
Situata:	<p>Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit si psh vërtetimet për xhiron vjetore dhe shlyerjen e taksave vendore vetëm për vitin 2017, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.</p> <p>Nga auditimi rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 OE, e cila ka ofruar 1,222,000 lekë pa tvsh dhe është shpallur fituese. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues u konstatuan këto mangësi:</p> <p>Për plotësimin e kriterit të përvojës së mëparshme, OE H.S. P. 05 ka paraqitur një vërtetim punimesh të lëshuar nga Bashkia Cërrrik me nr. 3150/1 prot., datë 12.09.2017. Nuk ka paraqitur kontratën e lidhur me bashkinë Cërrrik, si dhe fatura tatimore e paraqitur për këtë shërbim, nuk është e firmosur dhe vulosur nga ana e bashkisë Cërrrik.</p> <p>Gjithashtu, ka paraqitur dhe dy fatura me subjekte private (datë 08.05.2017 dhe 12.05.2017) por asnjëra prej këtyre dy faturave nuk është firmosur dhe vulosur nga të dyja palët, siç kërkohet më sipër. Gjithashtu OE nuk ka paraqitur vërtetim nga bashkia Tiranë apo nga ndonjë bashki tjetër që të konfirmojë shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017. Ka paraqitur disa veprime bankare ku ka bërë pagesa në favor të bashkisë Tiranë, por nuk ka paraqitur vërtetimin e kërkuar në DST. Detyra e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedura prokurimi, është që të paraqesin dokumentet sipas formës së kërkuar në DST. Operatori ekonomik për plotësimin e këtij kriteri nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik, por ka paraqitur vetëm librezën e energjisë elektrike ku pasqyrohet pagesa e energjisë elektrike për çdo muaj deri në muajin shtator 2017. Kjo nuk e provon që librezja i përket këtij operatori ekonomik, pasi në faqet ku është shënuar pagesa e energjisë elektrike nuk është shkruar emri i këtij operatori, gjë që nuk ofron garanci se librezja i përket këtij operatori. Mos paraqitja e vërtetimit të kërkuar në DST, bën që ky operator të mos e plotësojë këtë kriter. Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e OE “H.S. P. 05” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 1,222,000 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. A. P., znj. M. M. dhe z. B. R..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020, për procedurën me objekt: “Hartim i Projekt Preventivave për Qëndrat e Mbetura pa Projekt (Qëndrat e Fshatrave)”.

Sqarim: Pas përfundimit të aktkonstatimeve nga Njësia e Prokurimit janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasysht. Duke qenë se të njëjtat observacione janë bërë edhe për projekt raportin dhe nuk ka asnjë provë apo fakt të ri, nuk janë marrë parasysht.

Komente të paraqitura nga KVO me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020

Për sa komentoni se: Përsa i përket punëve të ngjashme, OE ka paraqitur vërtetim për kryerjen dhe realizimin e punimeve me bashkinë përkatëse me nr. prot dhe datë i cili përbën një dokument zyrtar lëshuar nga Bashkia që vërteton kryerjen dhe realizimin e këtyre punimeve. Ndërsa përsa i përket faturave me subjekte private të firmosura nga një palë e vetme dhe jo nga bashkia përkatëse gjë e cila nuk përbën kusht thelbësor për s’kualifikim pasi fatura është lehtësisht e verifikueshme me nr. serie dhe rendor. Në lidhje me vërtetimin e lëshuar nga organet e pushtetit vendor për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017, ky OE ka paraqitur veprimet bankare ku ka kryer pagesat përkatëse me bashkinë Tiranë. Ndërsa për vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve të energjisë elektrike, ky OE ka paraqitur librezën gjë që përbën një dokument ku provohet shlyerja e detyrimeve mujore përkatëse të faturave të OSHEE.

Sqarim: Në lidhje me kriterin e punëve të ngjashme, në DST është kërkuar si më poshtë vijon:

Kur kontratat janë të realizuara me institucione shtetërore ofertuesi duhet të paraqesë kontratën e lidhur me Institucionin të shoqëruar me vërtetimet nga institucioni me të cilin janë nënshkruar këto kontrata mbi realizimin me sukses të tyre, ku të shënohet data, vlera, dhe shërbimet e realizuara.

Kur kontratat janë të realizuara me subjekte private ofertuesi duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes (ku të shprehen qartë datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara, të firmosura dhe të vulosura nga të dy palët).

Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ka paraqitur një vërtetim punimesh të lëshuar nga Bashkia Cërrik me nr. 3150/1 prot., datë 12.09.2017. **Nuk ka paraqitur kontratën e lidhur me bashkinë Cërrik, si dhe fatura tatimore e paraqitur për këtë shërbim, nuk është e firmosur dhe vulosur nga ana e bashkisë Cërrik.**

Gjithashtu, ka paraqitur dhe dy fatura me subjekte private (datë 08.05.2017 dhe 12.05.2017) **por asnjëra prej këtyre dy faturave nuk është firmosur dhe vulosur nga të dyja palët, siç kërkohet më sipër.** Pra ky operator ekonomik nuk e plotëson këtë kriter.

Në lidhje me vërtetimin për shlyerjen e taksave dhe të detyrimeve të energjisë elektrike, ky OE duhet të kishte paraqitur vërtetime të lëshuar nga këto organe dhe jo fatura bankare (të cilat nuk provojnë shlyerjen e të gjitha detyrimeve që ky OE mund të ketë ndaj bashkisë Tiranë) apo librezën e energjisë elektrike (e cila përveç faqes së parë, në përmbajtje nuk



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

provon nëse i përket OE apo jo). Përsa më sipër komentet e bëra nga ana e juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

9- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje kontenjere pastrimi”.

26 Gjetjes:	Titulli i Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje kontenjere pastrimi”, me fond limit 2,083,333 lekë pa tvsh.
Situata:	<p>Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.</p> <p>Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 2 OE, dhe është s’kualifikuar oferta me vlerën më të lartë e cila e tejkalonte dhe vlerën e fondit limit, dhe është shpallur fituese oferta e ofruar nga OE “A.” shpk në vlerën 1,950,000 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues u konstatuan këto mangësi:</p> <p>Për plotësimin e kriterit për përvoja të mëparshme, OE “A.” shpk, ka paraqitur 3 fatura tatimore për blerje mallrash të viteve 2012, 2010 dhe 2009 me vlerat respektive 266,672 lekë, 341,667 lekë dhe 166,667 lekë pa TVSH. Vlëra e këtyre 3 furnizimeve në total është 775,006 lekë pa TVSH, ndërkohë që 40% e fondit limit është 833,333 lekë. Pra ky kriter nuk plotësohet nga OE “A.” shpk. OE “A.” shpk ka paraqitur vërtetimin bankar me nr. 57 prot., datë 14.11.2017, ndërkohë që afati për dorëzimin e dokumenteve është data 18.12.2017, pra vërtetimi bankar nuk duhet të jetë përpara datës 13.12.2017. Në DST është kërkuar që <i>OE duhet të ketë në përbërje një Drejtues Teknik të punësuar, të vlefshëm me dokumentacionin përkatës (Kontratë Pune)</i>, dhe OE “A.” shpk ka paraqitur një kontratë pune me z. V. D. të lidhur me datë 09.05.2015, me nr. 453 Rep., dhe 115/3 kol. Nga ana tjetër, emri i tij nuk figuron në listëpagesat e OE “A.” për muajt janar-shtator 2017.</p> <p>Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e OE “A.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 1,950,000 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. A. P., znj. M. M. dhe z. B. R..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Komente të paraqitura nga Njësia e Prokurimit me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për **procedurën me objekt: “Blerje kontenjere pastrimi”.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Sqarim: Pas përfundimit të aktkonstatimeve nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasysht. Duke qenë se të njëjtat observacione janë bërë edhe për projekt raportin dhe nuk ka asnjë provë apo fakt të ri, nuk janë marrë parasysht.

Komente të paraqitura nga KVO me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020.

Për sa komentoni se: Përsa i përket punëve të ngjashme, OE ka paraqitur 3 fatura të viteve 2012, 2010 dhe 2009 të cilat ne si KVO gjykojmë që vërteton pagesën e kryer për blerje të mallrave. Në lidhje me vërtetimin bankar për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10% e fondit limit të objektit që prokurohet, të lëshuar jo më parë se 5 ditë nga dita e hapjes së ofertave, KVO ka gjykuar dhe vendosur të kualifikojë këtë OE pasi paraqet qëndrueshmëri ekonomike nisur dhe në bazë të bilanceve të fundit. Përsa i përket pikës që OE duhet të ketë në përbërje një Drejtues Teknik të punësuar, të vlefshëm me dokumentacionin përkatës (Kontrata e Punës), keni konstatuar se drejtuesi teknik nuk figuron në listpagesa. KVO ka gjykuar dhe vendosur të kualifikojë këtë OE pasi drejtuesi teknik është deklaruar nga OE me kontratë pune si është kërkuar te kërkesat e veçanta. Listpagesat nuk vërtetojnë numrin e punonjësve pasi është detyrimi i subjekteve që të deklarojnë.

Sqarim: Në lidhje me kriterin e punëve të ngjashme, OE “A.” shpk, ka paraqitur 3 fatura tatimore për blerje mallrash të viteve 2012, 2010 dhe 2009 me vlerat respektive 266,672 lekë, 341,667 lekë dhe 166,667 lekë pa TVSH. **Vlera e këtyre 3 furnizimeve në total është 775,006 lekë pa TVSH, ndërkohë që 40% e fondit limit është 833,333 lekë. Pra nuk plotësohet vlera prej 40% e fondit limit.** Në lidhje me vërtetimin bankar, OE “A.” shpk ka paraqitur vërtetimin bankar me nr. 57 prot., datë 14.11.2017, ndërkohë që afati për dorëzimin e dokumentave është data 18.12.2017, **pra vërtetimi bankar nuk duhet të jetë përpara datës 13.12.2017.** Edhe ky kriter nuk plotësohet nga ana e OE “A.” shpk. Përsa i përket drejtuesit teknik, OE “A.” shpk ka paraqitur një kontratë pune me z. V. D. të lidhur me datë 09.05.2015, me nr. 453 Rep., dhe 115/3 kol. Nga ana tjetër, emri i tij nuk figuron në listëpagesat e OE “A.” për muajt janar-shtator 2017. Përsa më sipër komentet e bëra nga ana e juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

10-Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje materiale mirëmbajtje ndërtimore”.

27 Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale mirëmbajtje ndërtimore”, me fond limit 2,540,581 lekë pa tvsh.
Situata:	Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2. Nga auditimi rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 OE, “P..” shpk e cila është shpallur fituese në vlerën 2,463,650 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues u konstatuan këto mangësi: OE P.. Për plotësimin kriterit të punëve të ngjashme, OE P., ka paraqitur 5 fatura tatimore dhe rezultoi se, 3 prej faturave me shënimin “Sipas situacionit të bashkëngjitur” nuk janë të firmosura nga ana e blerësit, dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

	për rrjedhje nuk janë të vlefshme. Përsa i përket 2 faturave të tjera, ato janë të firmosura nga të dyja palët, por objekti i këtyre faturave tatimore nuk është i ngjashëm me objektin e tenderit. Në DST është kërkuar që <i>OE duhet të disponojë 1 Kamion me vinç në pronësi ose me qira për realizimin e kësaj kontrate</i> . Për plotësimin e këtij kriteri, OE “P..” shpk, ka paraqitur thjeshtë një deklaratë se disponon disa kamiona me vinç për realizimin e transportit të materialeve deri në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor por nuk ka paraqitur dokumentacionin përkatës duke mos e plotësuar këtë kriter. Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e OE “P..” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 2,463,650 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: znj. V. J., znj. R. Sh. dhe znj. B. B..
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkak:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Ura Vajguore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje material mirëmbajtje ndërtimore*”.

Sqarim: Pas përfundimit të aktkonstatimeve nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasys. Duke qenë se të njëjtat observacione janë bërë edhe për projekt raportin dhe nuk ka asnjë provë apo fakt të ri, nuk janë marrë parasys.

11- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “*Hartim projekt preventiv për rikonstruksionin e Qendrës Kulturore Bashkia Ura Vajguore*”.

29 Gjetjes:	Titulli i Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “ <i>Hartim projekt preventiv për rikonstruksionin e Qendrës Kulturore Bashkia Ura Vajguore</i> ”, me fond limit 4,230,790 lekë pa tvsh .
Situata:	Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2. Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 4 OE, ofertat e të cilëve janë kualifikuar të gjitha dhe fitues është shpallur oferta me vlerën më të lartë të BOE “E. G.” shpk & “A. S.” shpk në vlerën 4,200,000 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të BOE fitues u konstatuan këto mangësi: Në DST është kërkuar kopje të vërtetuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2014, 2015, 2016), të vulosura nga organet tatimore. OE A. S. shpk ka paraqitur vetëm bilancin e vitit 2016 të vulosur nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

	<p>organet tatimore, duke mos e plotësuar këtë kriter.</p> <p>Në DST është kërkuar që OE duhet të paraqesë dokument lëshuar nga administrata tatimore, ku të vërtetohet xhiro mesatare vjetore e realizuar gjatë tre viteve të fundit (2014, 2015, 2016).</p> <p>Në këto kushte vlerësimi i bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, neni 20 “Mosdiskriminimi”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, neni 52 “Hapja e ofertave” pika (1); (6), neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, neni 54 “Alternativat”, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”; neni 64 “Hapja e ofertave”; neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”; neni 67 “Klasifikimi i ofertave”; neni 68 “Raporti përmbledhës”; pasi ka kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën me vlerën më të lartë e cila kishte mangësi në dokumentacion, ndërkohë që ka renditur në vendin e dytë ofertën me vlerën më të ulët e cila i plotëson kriteret për kualifikim, për pasojë vlerësimi dhe përzgjedhja e ofertës fituese në vlerën 4,200,000 lekë pa tvsh, dhe diferenca më tepër në shumën 1,201,000 lekë pa tvsh (4,200,000 – 2,999,000) me dëm ekonomik në përdorimin e fondit të prokuruar, për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga: znj. V. J., znj. R. Sh. dhe znj. B. B..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	NJHDT në hartimin e kërkesave për kualifikim të zbatojë aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe të vlerësojë oferrat në përputhje me DST si dhe të nxirren përgjegjësitë nga ana e AK për dëmin ekonomik.

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020, për procedurën e prokurimit me objekt : **“Hartim projekt preventiv për rikonstrukcionin e qendrës kulturore bashkia Ura vajguore”**.

Sqarim: Pas përfundimit të aktkonstatimeve nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasysht. Duke qenë se të njëjtat observacione janë bërë edhe për projekt raportin dhe nuk ka asnjë provë apo fakt të ri, nuk janë marrë parasysht.

12- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **“Vendosje e sinjalistikës rrugore”**.

30 Gjetjes:	Titulli i	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Vendosje e sinjalistikës rrugore” , me fond limit 2,317,967 lekë pa tvsh .
Situata:		Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit si certifikata ISO, inxhinierë, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	<p>Nga auditimi rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 OE, “T.” shpk e cila është shpallur fituese në vlerën 2,296,674 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues u konstatuan këto mangësi:</p> <p>Në datat 21.06.2017 dhe 22.06.2017, ky operator ka marrë pjesë në dy procedura prokurimi të zhvilluara në bashkinë Ura Vajgurore në të cilat është shpallur fitues duke qenë pjesë e bashkimit të operatorëve. Numri i punonjësve që do të angazhohen në të dyja këto procedura, në përputhje me përqindjen e ndarjes së punimeve e tejkalon numrin prej 20 punonjësish të kërkuar për këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu drejtuesja teknike e punimeve znj. A. B. është deklaruar si drejtuese e punimeve me kohë të plotë në Rikonstruksionin e shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani, dhe sipas Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, në Kreun I/2.1, përcaktohet se “Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”. 2 kamiona dhe 2 kamionçina i ka të deklaruar të angazhuara edhe në procedurat e tjera të mësipërme ku është shpallur fitues. Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e OE “T.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 2,296,674 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO: znj. V. J., znj. R. Sh. dhe znj. B. B..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkak:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020, për procedurën e prokurimit me objekt “*Vendosje e sinjalistikes rrugore*”

Sqarim: Pas përfundimit të aktkonstatimeve nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasys. Duke qenë se të njëjtat observacione janë bërë edhe për projekt raportin dhe nuk ka asnjë provë apo fakt të ri, nuk janë marrë parasys.

13- Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “*Ndërtim K.U.Z. në lagjen 28 Nëntori*”.

31 Gjetjes:	Titulli i Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “ <i>Ndërtim K.U.Z. në lagjen 28 Nëntori</i> ”, me fond limit 11,411,479 lekë pa tvsh.
Situata:	Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit si certifikata ISO, numri i punonjësve, mjek, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2. Nga auditimi rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 BOE, “T.” shpk & “M.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	<p>2006” shpk, e cila është shpallur fituese në vlerën 11,357,550 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të BOE fitues u konstatuan këto mangësi: OE “T.” shpk nuk e plotëson kriterin përsa i përket numrit të punonjësve pasi është e angazhuar edhe në punime të tjera të lidhura me bashkinë Ura Vajgurore dhe nuk ofron garanci për kryerjen e punimeve në kohë dhe me cilësi. Gjithashtu, në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani”, OE “T.” shpk ka deklaruar si drejtues teknik që do të ndjekë projektin, znj. A. B.. Në këto kushte, drejtuesja teknike znj. A. B. është e angazhuar me kohë të plotë në kryerjen e punimeve të rikonstruksionit të shkollës Refat Bani. Sipas Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, në Kreun I/2.1, përcaktohet se “Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”. Edhe OE “M. 2006” shpk, nuk e plotëson kriterin përsa i përket numrit të punonjësve. Ky operator ka një numër mesatar prej 17 punonjësish për periudhën e kërkuar në DST (janar 2015-shkurt 2017), ndërkohë që sipas ndarjes së detyrave ky operator duhet të ketë 21 punonjës. OE “T.” shpk, ka mangësi në këto kategori: NP-12A; NS-8A; NS-9A; NS-19A.</p> <p>Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e BOE “M. 2006” shpk & “T.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 11,357,550 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: znj. B. B., znj. V. J. dhe znj. R. Sh..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Komente të paraqitura me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim K.U.Z. në lagjen 28 Nëntori”.

Sqarim: Pas përfundimit të aktkonstatimeve nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasys. Duke qenë se të njëjtat observacione janë bërë edhe për projekt raportin dhe nuk ka asnjë provë apo fakt të ri, nuk janë marrë parasys.

VITI 2018

32. Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Autoveture”

Situata: Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së OE të ftuar për pjesëmarrje. OE pjesëmarrës nuk janë njoftuar me shkresë për pezullimin e procedurës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

dhe ndryshimin e datës së tenderit. Data e hapjes së ofertave është vendosur në kundërshtim me nenin 42 të LPP. Specifikimet teknike në DST të disponueshme në faqen e internetit të APP-së nuk janë përditësuar nga AK pas ndryshimeve të bëra dhe shtojcave të depozituara, duke mos u dhënë mundësi OE për t'u njohur me to. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për blerjen e këtij automjeti nuk janë në përputhje me LPP neni 23, pika 1.

AK në lidhje me vërtetimin e punëve të ngjashme ka tjetërsuar kriterin ligjor për kufirin e punëve të ngjashme dhe/ose xhiros së OE, duke ndryshuar përcaktimet ligjore dhe formulimin, rrjedhimisht duke favorizuar OE të caktuar. Përcaktimi në pikën 2.3.2 të Shtojcës 8 të DST si domosdoshmëri e 5 punonjësve dhe pronësia apo disponimi i një karotresi janë kërkesa të tepërta, pengojnë konkurrencën e ndershme, favorizojnë OE të shpallur fitues dhe nuk përbëjnë asnjë lloj elementi funksional ose të garantojnë apo të ndikojnë në cilësinë e kërkuar

Pika 2.2 e Shtojcës 8 sipas formatit të DST të publikuar nga APP “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*” është hequr nga DST, në kundërshtim me nenin 41, pika 1 të LPP. Specifikimet teknike përmbajnë marka dhe të dhëna të veçanta, të përdorura vetëm nga një prodhues automjetesh. OE fitues në shtojcën 6 ka deklaruar informacion të pavërtetë në lidhje me përmbushjen e specifikimeve teknike. Vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria të OE fitues nuk shprehin gjendjen gjyqësore të OE, por të administratorit të shoqërisë.

Klasifikimi i OE fitues nuk është bërë në përputhje me pikën 2.3 e Shtojcës 9 të DST, “*Kapaciteti teknik*”, nga OE i skualifikuar nuk plotësohet pasi është më e ulët se vlera e kërkuar dhe fatura e paraqitur nuk është origjinale, por nuk plotësohet as nga OE fitues, pasi dokumentat e paraqitura nuk janë as origjinale dhe as të noterizuara, nuk ka dokumenta të origjinës së mallrave, kontrata etj. Dokumentat e tjera të paraqitura nga OE fitues janë disa fatura (joorigjinale) për blerje automjetesh nga OE fitues, pa lidhje me këtë prokurim.

Në vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve vendore, bashkia Vlorë shprehet që OE nuk ka detyrime për vitin 2018, por nuk shprehet për periudhat e mëparshme dhe nëse i ka paguar apo jo detyrimet për vitin 2018.

Faturat dhe dokumentet e tjera të paraqitura nga OE fitues për të vërtetuar punë të ngjashme janë fotokopje të panoterizuara.

Në formularin e vlerësimit të ofertave, krahas të tjerave, si arsye për skualifikimin e OE “D. B.” përmendet se tregtimi i automjeteve nuk është objekt i veprimtarisë së këtij OE, ndërkohë që nga Ekstraktet e paraqitura vërtetohet se ky OE ndërmjet të tjerash ka edhe objekt “*Import-export, tregëti me shumicë dhe pakicë, montime, servise, ... dhe automjete së bashku me pjeset e tyre të ndërrimit.*”

OE i skualifikuar i përmbush kriteret ligjore të cilat janë ndryshuar në DST dhe duhet të ishte kualifikuar dhe shpallur fitues.

Në PV e marrjes në dorëzim, me nr. 867/2, datë 22.06.2018, nuk janë përmendur të gjitha specifikimet e kërkuara në DST. Një nga elementet e lëna mënjanë, është numri i marsheve, ku në DST kërkohet me nëntë marshe, në fakt është me shtatë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Kriteri:	Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “O.” sh.p.k dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte shpallur fitues OE “D. B.” ose në të kundërt, duke i marrë të mirëqëna kriteret e DST, duhet të kishte anuluar tenderin. Kryerja dhe moskryerja e këtyre veprimeve është në kundërshtim me kërkesat LPP, neni 24, pika 1, gërma ç)
Ndikimi/Efekti:	Mosshpallja fitues e OE “D. B.”, si dhe për mosanulimin e procedurës dhe shpalljen fitues të OE “O.” sh.p.k., i cili nuk i plotëson kriteret e DST, kanë shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 150,000 lekë (180,000 lekë me TVSH) dhe paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 2,700,000 lekë (3,240,000 lekë me TVSH)
Shkaku:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Rëndësia:	Ndikim negativ në buxhetin e bashkisë Ura Vajgurore dhe mosplotësim i cilësisë së pritshme.
Rekomandim 1:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rekomandim 2:	I lartë.
Rekomandim 3:	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për nxjerrjen e përgjegjësive për vlerën e dëmit ekonomik prej 150,000 lekësh nga KVO
	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për komisionin e marrjes në dorëzim të një malli i cili nuk përputhet me DST dhe për OE i cili ka deklaruar në mënyrë të gënjeshtërt plotësimin e specifikimeve teknike të automatit.
	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për përcaktimin e DST në përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

33. Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Gazoil D1”

Situata:	<p>Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së OE të ftuar për pjesëmarrje. OE pjesëmarrës nuk janë njoftuar me shkresë për pezullimin e procedurës dhe ndryshimin e datës së tenderit.</p> <p>Në pikën 2.1. të Shtojcës 8 të DST “<i>Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë</i>”, nuk është vendosur asnjë kërkesë, në kundërshtim me nenin 41, pika 1 të LPP</p> <p>Në nënpikën 2.2.2 të DST AK në lidhje me vërtetimin e punëve të ngjashme ka tjetërsuar kriterin ligjor për kufirin e punëve të ngjashme dhe/ose xhiros së OE, duke ndryshuar përcaktimet ligjore dhe formulimin, rrjedhimisht duke favorizuar OE të caktuar.</p> <p>Kriteret për kualifikim të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me LPP, pasi bien ndesh me kërkesat e nenit 23, pika 1.</p> <p>Në nënpikën 2.1. të Shtojcës 8 të DST “<i>Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë</i>”, nuk janë kërkuar vërtetimet e pagesës së detyrimeve tatimore qendrore dhe vendore etj, në kundërshtim me LPP, neni 45</p> <p>Dokumentat e kërkuara për të vërtetuar kapacitetet teknike, janë kritere të detyrueshme për pajisjen e subjekteve me leje për tregtimin me pakicë të hidrokarbureve, sipas VKM-së nr. 970, datë 02.12.2015, “<i>Për Liçencat e tregtimit të Hidrokarbureve</i>”, të cilat supozohet se OE i ka plotësuar në</p>
-----------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Kriteri:

Ndikimi/Efekti:

Shkaku:

Rëndësia:

Rekomandim:

momentin e pajisjes me autorizimin për tregtim hidrokarburesh.
Në nënpikën 2.3.4 kërkohen Çertifikata ndërkombëtare të cilat nga grupi i auditimit gjykohet se janë të tepërta për natyrën dhe vlerën e prokurimit.
Kapaciteti i depozitave jo më pak se 85,000 litra, nuk është as kriter për lejen e tregtimit të hidrokarbureve (sipas VKM nr. 970) dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, aftësinë konsumuese të AK, apo nevojat e AK për karburant;
Përcaktimi si domosdoshmëri e 14 punonjësve për periudhën janar 2017 – janar 2018 është i tepërt dhe klientelist
Kërkesa për sigurimin e furnizimit me një autobot të kalibruar dhe të liçencuar për transport mallrash të rrezikshme, me kapacitet jo më pak se 5,000 litra nuk qëndron, pasi hidrokarburet nuk janë mallra të rrezikshëm, sipas ligjeve në fuqi në RSh.
Klasifikimi i OE fitues nuk është bërë në përputhje me pikën 2.3 e Shtojcës 9 të DST, “Kapaciteti teknik”.
AK nuk ka përgatitur asnjë grafik për lëvrimin e mallrave, sipas Shtojcës 10 të DST
Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “G.” sh.p.k dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat LPP, neni 24, pika 1, gërma ç)
Për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, si dhe për mosanulimin e procedurës dhe shpalljen fitues të OE “G.” sh.p.k., i cili nuk i plotëson kriteret e DST, veprime të cilat kanë shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 6,352,500 lekë (7,623,000 lekë me TVSH.
Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikim negativ në buxhetin e bashkisë Ura Vajgurore, funksionim me dy standarde të KVO-së.
Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
I lartë.
Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për përcaktimin e DST në përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

34. Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje për nevoja administrative (kancelari, tonera, kompjuter për nevojat e bashkisë”

Situata:

Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së OE të ftuar për pjesëmarrje. OE pjesëmarrës nuk janë njoftuar me shkresë për pezullimin e procedurës dhe ndryshimin e datës së tenderit.
Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me LPP, neni 23, pika 1
Në nënpikën 2.1. të Shtojcës 8 të DST “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë”, nuk janë kërkuar vërtetimet e pagesës së detyrimeve tatimore qendrore dhe vendore etj, në kundërshtim me LPP, neni 45
Në nënpikën 2.2.2 të DST AK në lidhje me vërtetimin e punëve të ngjashme ka tjetërsuar kriterin ligjor për kufirin e punëve të ngjashme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

dhe/ose xhiros së OE, duke ndryshuar përcaktimet ligjore dhe formulimin, rrjedhimisht duke favorizuar OE të caktuar.

Nënpika 2.2 e Shtojcës 8 sipas formatit të DST të publikuar nga APP “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*” është hequr nga DST dhe është zëvendësuar me pikën ku vendosen kriteret ekonomiko-financiare, në kundërshtim me nenin 41, pika 1 të LPP

Kërkesa në DST, shtojca 9, pika 2.3.2 për jo më pak se 15 punonjës është e tepërt dhe pa lidhje me objektin e kontratës

Me Ref. Ura Vajgurore nr. 1029 prot., datë 17.05.2018 nga OE A. është paraqitur një ankesë në lidhje me DST, për numrin prej minimalisht 15 punonjësish. AK ka pezulluar procedurën dhe ka shtyrë datën e pranimit dhe hapjes së ofertave, por në përgjigjen nr. 1029/2 prot., datë 21.05.2018, grupi i punës i përbërë nga N. C., B. R. dhe A. Gj. e ka hedhur poshtë ankesën, duke mos dhënë asnjë argument bindës.

Në hartimin e preventivit, në disa zëra, si p.sh. mandate arkëtimi ose pagese, ditare arke, fletë hyrje dhe fletë dalje, letër debi-kredi, etj, në kollonën “njësi” është përcaktuar copë, gjë e cila është e gabuar, pasi këto artikuj përdoren dhe tregtohen me blloqe, të cilat duhet të kenë nga x copë me x kopje dhe të jenë format a4, a5, etj. Në standardet e përdorura për letrën e shtypit/shkrimin, mund të vendoset dendësia për m², e cila është standardi që kërkohet për letrën dhe jo mënyra e ambalazhit në 5 rizma, mosbllokimi i aparatit apo qëndrimi i rrafshët pas printimit, të cilat janë absurde dhe pavarësisht kësaj, nga AK nuk është mbajtur asnjë PV për të vërtetuar kontrollin dhe plotësimin e këtyre kriterëve të kërkuara. Gjithashtu, në preventiva janë përdorur edhe marka, si p.sh. stilolapsa “lantu”, “shneider” etj, të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet e LPP, sipas pikës 3 më sipër.

Në DST, pavarësisht se kërkohet që mallrat të jenë origjinale, të plotësojnë normat dhe standartet e BE-së, të kenë pullë sigurie, etj., nuk kërkohet asnjë lloj dokumenti që të vërtetojë standartet të cilave i referohet AK apo origjinalitetin e kërkuar, si dhe në ST për laptopin, janë vendosur të gjitha markat e mundshme për procesorin, kartën grafike, llojin e ekranit, etj., në kundërshtim me LPP sipas pikës 3 më sipër për markat dhe patentat. Gjithashtu, një pjesë e ST për laptopin janë vendosur në anglisht, gjë që nuk lejohet për këtë procedurë prokurimi, pasi bie ndesh me kriteret e VKM 914, neni 14. AK ka marrë të dhënat e një laptopi që shet OE fitues dhe e ka paraqitur si ST që i nevojiten.

Nuk ka informacion nëse AK ka njoftuar operatorët ekonomikë për ndryshimin e kërkesave në DST.

AK nuk ka përgatitur asnjë grafik për lëvrimin e mallrave, sipas Shtojcës 10 të DST.

Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Kriteri:
Ndikimi/Efekti:

Hartimi gabuar i kërkesave për kualifikim

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia:

I lartë.

Rekomandim:

Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për përcaktimin e DST në përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

miratuara në DST.

35. Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale elektrike për ndriçim dhe hidraulike”

Situata:	<p>Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së OE të ftuar për pjesëmarrje. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me LPP, neni 23, pika 1</p> <p>Specifikimet teknike në këtë rast nuk janë në përputhje me kërkesat e VKM-së 914, neni 27, pika 1</p> <p>Në pikën 2.1. të Shtojcës 8 të DST “<i>Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë</i>”, nuk janë kërkuar vërtetimet e pagesës së detyrimeve tatimore qendrore dhe vendore etj, në kundërshtim me LPP, neni 45</p> <p>Në nënpikën 2.2.2 të DST AK në lidhje me vërtetimin e punëve të ngjashme ka tjetërsuar kriterin ligjor për kufirin e punëve të ngjashme dhe/ose xhiros së OE, duke ndryshuar përcaktimet ligjore dhe formulimin, rrjedhimisht duke favorizuar OE të caktuar.</p> <p>Në Specifikimet teknike, për shtyllat metalike kërkohet që bazamenti i shtyllës të jetë brendashkruar një rrethi Ø30 cm, vazhdimi kërkohet Ø90, duke mos përcaktuar njësinë matëse dhe duke e bërë konfuze dhe të paqartë kërkesën. Krahas kësaj, nga AK kërkohet që klasifikimi i mbrojtjes të jetë sipas standardit IP 68, IK 10, me dizajn të modernizuar, etj., por nuk kërkohet dhe nga OE fitues nuk është paraqitur asnjë dokument që ta vërtetojë plotësimin e këtyre kërkesave apo standardeve.</p> <p>AK nuk ka përgatitur asnjë grafik për lëvrimin e mallrave, sipas Shtojcës 10 të DST.</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Hartimi gabuar i kërkesave për kualifikim
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
<u>Rekomandim:</u>	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për përcaktimin e DST në përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

36. Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale të ndryshme për mirëmbajtjen e kanaleve, rrugëve, objekteve ndërtimore”

<u>Situata:</u>	<p>Shtyrja e afatit nuk është pasqyruar në Raportin Përmbledhës për procedurat e prokurimit. Gjithashtu, kjo shtyrje është bërë në kundërshtim me nenin 42 të LPP, pika 2/1 Në PV përfundimtar nuk është vendosur një përmbledhje e ankesave dhe përgjigjeve të dhëna OE, duke mos zbatuar kërkesat e LPP, neni 12</p> <p>Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së OE të ftuar për pjesëmarrje. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me LPP, neni 23, pika 1</p> <p>Në pikën 2.1. të Shtojcës 8 të DST “<i>Kapaciteti ligjor/profesional i</i></p>
------------------------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

operatorëve ekonomikë”, nuk janë kërkuar vërtetimet e pagesës së detyrimeve tatimore qendrore dhe vendore etj, në kundërshtim me LPP, neni 45

Në nënplikën 2.2.2 të DST AK në lidhje me vërtetimin e punëve të ngjashme ka tjetërsuar kriterin ligjor për kufirin e punëve të ngjashme dhe/ose xhiros së OE, duke ndryshuar përcaktimet ligjore dhe formulimin, rrjedhimisht duke favorizuar OE të caktuar.

Përcaktimi si domosdoshmëri e jo më pak se 12 punonjësve është i tepërt dhe pa lidhje me objektin e kontratës

Kërkesa për pajisje me autovinç gjykohet e tepërt nga grupi i auditimit, pasi për të kryer transportin apo ngarkim/shkarkimin e mallrave nuk përbën domosdoshmëri kontraktimi apo pronësia e një autovinçi

Pothuajse asnjë nga artikujt e vendosur në preventiv nuk është në përputhje me përcaktimet në manualin e ndërtimit, të miratuara me VKM Nr. 629, datë 15.7.2015

Më datën 04.07.2018, (Ref. Ura Vajgurore nr. 1547 prot., datë 04.07.2018) nga OE S. A. 2016 është paraqitur një ankesë në lidhje me DST, për numrin prej jo më pak se 12 punonjësish dhe për disponimin e një automjeti me vinç. AK ka pezulluar procedurën dhe ka shtyrë datën e pranimit dhe hapjes së ofertave dhe me PV nr. 1547/2 prot. dhe Vendimin nr. 1547/3 prot., datë 05.07.2018, grupi i punës i përbërë nga N. C., A. Gj. dhe R. B. kanë pranuar dy kërkesat, por kanë bërë lojë fjalësh duke lënë përsëri të njëjtin numër punonjësish dhe për vinçin kanë lejuar që mund të jetë edhe me qera.

Specifikimet teknike në DST të disponueshme në faqen e internetit të APP-së nuk janë përditësuar nga AK pas ndryshimeve të bëra dhe shtojcave të depozituara, duke mos u dhënë mundësi OE të tjerë për t’u njohur me to.

AK nuk ka përgatitur asnjë grafik për lëvrimin e mallrave, sipas Shtojcës 10 të DST.

Skualifikimi i OE “P.” për shkak të mospagimit të faturave elektrike për muajin maj është në kundërshtim me VKM 914, pika 5. Po kështu nuk qëndron edhe vlerësimi për bilancet e viteve 2015 dhe 2016, pasi vetëm bilanci i vitit 2017 është i pakonfirmuar nga zyra e tatimeve. Gjithashtu nuk qëndron skualifikimi për shkak të eksperiencave të ngjashme, pasi OE ka paraqitur fatura të mjaftueshme, në sasi, në artikuj të ngjashëm dhe në vlerë, për të vërtetuar gjendjen ekonomike dhe financiare në përputhje me LPP, neni 46, pika 1, germa c). Me të njëjtin argument janë skualifikuar edhe OE “S. T.”, i cili për të vërtetuar gjendjen ekonomike dhe financiare, ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm, në sasi, në artikuj të ngjashëm dhe në vlerë, me përjashtim të autovinçit, për të cilin cilësohet se nuk ka kontratë qeraje me mjetin, gjë që nuk qëndron, sepse kontrata e qerasë ndodhet në dosje; OE “C.”, i cili për të vërtetuar gjendjen ekonomike dhe financiare ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm, në sasi, në artikuj të ngjashëm dhe në vlerë; OE “V. K.”, i cili për të vërtetuar gjendjen ekonomike dhe financiare ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm, në sasi, në artikuj të ngjashëm dhe në vlerë; OE “A. 2.”, i cili për të vërtetuar gjendjen ekonomike dhe financiare ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm, në sasi, në artikuj të ngjashëm dhe në vlerë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “E. A.”, i cili është kualifikuar por nuk është shpallur fitues për shkak të vlerës, konstatojmë se bilanci i vitit 2016 nuk është i konfirmuar nga tatimet. Ka vulë, por nuk është i nënshkruar nga autoriteti, duke rënë ndesh me nenin 12 të “*Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”

Dokumentacioni i OE “S.”, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues, konstatojmë se ka pasur mangësi në dokumentacionin e autovinçit (kontrata e qerasë për autovinçin nuk është e hartuar para noterit), për të cilën antari i KVO M. M. nuk ka dhënë miratimin.

Si konkluzion, pavarësisht se KVO ka shpallur fitues OE “S.”, si ofertues të cilin e ka kualifikuar dhe si fitues për shkak të vlerës më të ulët, konstatojmë se KVO në vlerësimin e Operatorëve Ekonomikë ka vepruar me dy standarde, duke diskriminuar OE të cilët ka skualifikuar pa të drejtë. Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “S.” dhe OE “E. A.” dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të OE “S.”. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e LPP, neni 24, pika 1, gërma ç)

Për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, si dhe për mosanulimin e procedurës dhe shpalljen fitues të OE “S.”, i cili nuk i plotëson kriteret e DST, veprime të cilat kanë shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 3,517,500 lekë (4,221,000 lekë me TVSH).

Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikim negativ në buxhetin e bashkisë Ura Vajgurore, funksionim me dy standarde të KVO-së.

Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

I lartë.

Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për përcaktimin e DST në përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Kriteri:

Ndikimi/Efekti:

Shkaku:

Rëndësia:

Rekomandim:

36. Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Mirëmbajtje dhe riparim automjetesh”

Situata:

Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së OE të ftuar për pjesëmarrje. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me LPP, neni 23, pika 1

Specifikimet teknike në këtë rast nuk janë në përputhje me kërkesat e VKM-së 914, neni 27, pika 1

Në pikën 2.1. të Shtojcës 8 të DST “*Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë*”, nuk janë kërkuar vërtetimet e pagesës së detyrimeve tatimore qendrore dhe vendore etj, në kundërshtim me LPP, neni 45

Në Shtojcën 7 të DST, nën-pika 2.2, kërkohet: “*Kopje të vërtetuar të bilancit të vitit paraardhës 2017, të konfirmuar*” dhe “*xhiro mesatare vjetore e vitit paraardhës (2017) ... të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit.*”. Kjo kërkesë bie ndesh me kriteret e përcaktuara në LPP, neni 46 natyra e prokurimit dhe specifikimet teknike, nuk janë përcaktuar si duhet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

në DST, shtojcat 7, 8 dhe 10, pasi nuk është e qartë nëse kërkohet të blihet vetëm malli apo edhe shërbimi i montimit/çmontimit përfshirë transportin. Konkretisht, në preventiva kërkohet specifikisht (1) riparimi i 1 motorino kamioni Isuzu, (2) zëvendësimi i kavos dhe guidës të frenave të dorës të një mjeti Ford Tranzit, (3) rregullimi i motorinos së një kamionçine Kama, (4) rregullimi i pompës së vinçit të një mjeti Iveco dhe (5) rregullimi i spondit të pasëm të kazanit dhe dyshemeja e një mjeti të paspecifikuar. Pra, nga gjithsej 104 artikuj të kërkuar në preventiv, vetëm për 5 artikuj kërkohet riparimi/shërbimi, për 99 artikuj të tjerë kërkohet vetëm blerja e tyre. Përveç llojit të DST-ve, të cilat janë për shërbime, nuk përcaktohen detaje shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme nga ana ekonomike, si p.sh. vlera e punës për zëvendësimin e pjesëve të këmbimit apo lubrifikantëve, nuk specifikohet mënyra e transportit, grafiku dhe afatet e “shërbimeve” dhe vendi ku do të kryhen shërbimet, pasi supozohet që mjetet nuk janë në gjendje të shkojnë vetë në pikën e shërbimit, etj. Këto specifikime bien në kundërshtim me kriteret ligjore e nënligjore të përcaktuara në pikën 3 më sipër.

Kërkesa “jo më pak se 9 (nëntë) punonjës mesatarisht për çdo muaj për periudhën shtator 2017-shkurt 2018, nga të cilët në stafin teknik të jenë të punësuar të paktën 2 (dy) inxhinierë, 1 (një) motorrist, 3 (tre) xhenerikë, 1 (një) elektroauto” është e tepërt

Kërkesat e DST, shtojca 7, pika 2.3.1 (pas ndryshimeve të bëra), nuk qëndron, pasi pagesat e sigurimeve shoqërore vërtetohen nëpërmjet vërtetimit përkatës, të lëshuar nga zyra tatimore përkatëse dhe jo nga listëpagesat. Listëpagesat janë për efekt të veprimeve të tjera kontabël, por nuk vërtetojnë pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Kërkesat e pikës 2 dhe 3, shtojca 7, janë të tepërta, pasi nuk përbën domosdoshmëri për riparimin e mjeteve CV-ja e punonjësve/inxhinierëve. Për sa kohë që OE është i licencuar nga organet kompetente për kryerjen e një shërbimi të caktuar, plotësimi i këtyre kërkesave konsiderohet i mirëqënë.

Në pikën 3, nënpika 3, shtojca 7 e DST kërkohet: “OE ofertues, në zbatim të ligjit nr. 9573, dt. 3.7.2006, duhet të paraqesë: Diplomën përkatëse të Përgjegjësisë Teknik (i cili mund të jetë drejtuesi ekzekutiv i subjektit) në zbatim të ligjit nr. 9573, dt 3.7.2006, neni 6, pika 2 ku thuhet: Subjektet që kërkojnë të regjistrohen në regjistër (në QKB), duhet të kenë detyrimisht një përgjegjës teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti. Përgjegjësi teknik mund të jetë edhe drejtuesi ekzekutiv i subjektit.”. Kjo kërkesë nuk qëndron dhe nuk është në përputhje me ligjin nr. 9573, datë 03.07.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” ndryshuar me ligjin nr. 10137/2009”. Në bazën ligjore të referuar në DST nga NJP, thuhet për regjistrin tregtar (QKB), përcaktim i cili është i gabuar, pasi në fakt subjekti që kryen veprimtarinë e autoriparimit, duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari autoriparimi, sipas kërkesave të nenit 4 të ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006

Më datën 13.08.2018, (Ref. Ura Vajgurore nr. 1920 prot., datë 15.08.2018)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

nga OE L. shpk është paraqitur një ankesë në lidhje me DST, për numrin prej jo më pak se 9 punonjësish, për lejen mjedisore, për kërkesën që OE të jetë importues dhe për numrin e kompjuterave diagnostikues. AK ka pezulluar procedurën dhe ka shtyrë datën e pranimit dhe hapjes së ofertave, por në përgjigjen nr. 1920/1 prot., datë 15.08.2018, grupi i punës i përbërë nga N. C., B. R. dhe I. Sh. kanë pranuar tre kërkesat e para dhe kanë hedhur poshtë të katërtën. Megjithëse këto kërkesa janë pranuar shprehimisht, nuk janë marrë plotësisht në konsideratë në shtojcën për ndryshimin në DST. Gjithashtu, në Vendimin nr 1920/3, datë 20.08.2018, AK e ka tjetërsuar natyrën e kërkesës, duke bërë lojra fjalësh, nga nr. i punonjësve, në llojet e dokumentacionit vërtetues.

Kërkesa në shtojcën 7, nënpika 5, “*OE ofertues duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore te tipit C. Kodi 10.4 të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.*”, nuk qëndron, pasi në bazë të ligjit nr 10448, datë 14.07.2011, i ndryshuar me ligjin nr. 60/2014, shtojca 1, “*Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi*” është e papërshtatshme, pasi kjo leje nuk lëshohet nga QKB, siç kërkohet në DST, por nga QKL dhe kodi korrespondues për kategorinë “*Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë*” është 10.5 dhe jo 10.4 (shtojca e DST).

Kërkesat e vendosura në shtojcën 7, nënpikat 6, deri në 11 janë të papërshtatshme për natyrën e prokurimit, nuk janë të argumentuara nga NJP dhe bien në kundërshtim me kriteret ligjore dhe nënligjore

Kërkesa në nënpikën 9 konsiderohet e plotësuar në kushtet e përgjithshme të DST, kërkesat në pikat e tjera që OE të ketë 5 ura ngritëse në servis, 4 kompjutera diagnostikimi dhe pajisjet e tjera (nënpika 10 dhe 11) nuk përbëjnë domosdoshmëri për plotësimin e objektit të prokurimit dhe diskriminojnë personat fizikë të cilët mund të kenë kapacitete për plotësimin e ofertës ekonomike.

Leja mjedisore është e tipit A, jo në përputhje me DST, pika 2.3, nënpika 5, ku kërkohet Leje Mjedisore e tipit C, kodi 10.4 (sipas shtojcës); leja e OE ka kodin III.1.A.

OE nuk ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2008;

OE nuk vërteton disponimin e 4 kompjuterave diagnostikues, sipas DST, pika 2.3, nënpika 11.4. ka paraqitur faturë për 1 kompjuter diagnostikues dhe në inventarin e pajisjeve më datë 31.12.2017 (bashkëlidhur bilancit për vitin ushtrimor 2017) ka vetëm 1 set pajisjeje diagnostikuese për automatet, të renditur me numrin 4.

Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “P. I.” sh.p.k dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat LPP, neni 24, pika 1, gërma ç)

Mosshpallja fitues e BOE “G. D. dhe L. K.”, si dhe për mosanulimin e procedurës dhe shpalljen fitues të OE “P. I.” sh.p.k., i cili nuk i plotëson kriteret e DST, kanë shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 311,760 lekë (374,112 lekë me TVSH) dhe paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën 1,376,760 lekë (1,652,112 lekë me TVSH).

Kriteri:

Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në buxhetin e bashkisë Ura Vajguore, funksionim me dy standarde të KVO-së.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
<u>Rekomandim 1:</u>	Nga ana e bashkisë Ura Vajguore të merren masa për nxjerrjen e përgjegjësive për dëmin ekonomik prej 311,760 lekësh
<u>Rekomandim 2:</u>	Nga ana e bashkisë Ura Vajguore të merren masa për përcaktimin e DST në përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

37. Moszbatim i legjisllacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim dhe mirëmbajtje urash”

Situata:	<p>Shtyrja e afatit nuk është pasqyruar në Raportin Përmbledhës për procedurat e prokurimit. Gjithashtu, kjo shtyrje është bërë në kundërshtim me nenin 42 të LPP, pika 2/1.</p> <p>Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së OE të ftuar për pjesëmarrje. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me LPP, neni 23, pika 1</p> <p>Specifikimet teknike në këtë rast nuk janë në përputhje me kërkesat e VKM-së 914, neni 27, pika 1</p> <p>Në Shtojcën 11 të DST, është hequr nënpika “<i>Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë</i>”, nuk janë kërkuar vërtetimet e pagesës së detyrimeve tatimore qendrore dhe vendore etj, në kundërshtim me LPP, neni 45</p> <p>Në Shtojcën 11 të DST, nënpika 2.2.3, kërkohet: “<i>Kopje të vërtetuar të bilancit të vitit paraardhës 2017, të konfirmuar</i>” dhe “<i>xhiro mesatare vjetore e vitit paraardhës (2017) ... të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit</i>”. Kjo kërkesë bie ndesh me kriteret e përcaktuara në LPP, neni 46</p> <p>Në nënpikën 2.3.2 të Shtojcës 11 të DST, kërkohet licenca profesionale në lidhje me ekzekutimin e kontratës. Grupi i auditimit konstaton se jo të gjitha kategoritë e kërkuara kanë lidhje me objektin e prokurimit dhe rrjedhimisht kërkesat për kategoritë e listuara më poshtë janë të tepërta dhe bien ndesh me LPP, neni 46</p> <p>Kategoria NP-6 A, e cila emërtohet “Diga dhe tunele hidroteknike”;</p> <p>Kategoria NP-9 A, e cila emërtohet “Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime”;</p> <p>Kategoria NP-11 A, e cila emërtohet “Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatorëve, linjat e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë”;</p> <p>Kategoria NP-12 A, e cila emërtohet “Punime të inxhinierisë së mjedisit”;</p> <p>Kategoria NS-18 A, e cila emërtohet “Punime topogjeodezike”; dhe</p> <p>Kategoria NS-20 A, e cila emërtohet “Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.”</p> <p>Sa më sipër, në preventivin e korrigjuar të paraqitur në DST, nuk figuron asnjë nga këto lloj punimesh.</p> <p>Pa analizuar hollësisht nevojën e certifikatave të tjera, certifikata EN - ISO 3834-2:2006 “Për sistemin e manaxhimit të cilësisë në saldim”, nuk është e përshtatshme në këtë rast, pasi në preventiv nuk ka punime saldimi dhe bie</p>
-----------------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

ndesh me bazën ligjore të përcaktuar në pikën 5 më sipër.

Përcaktimi në pikën 2.3.4 se OE duhet të ketë të punësuar mesatarisht 35 punonjës është i tepërt dhe pa lidhje me objektin e kontratës. Kjo nevojë duhet të argumentohet me PV të posaçëm dhe nga grafiku i punimeve

Në nënpikën 2.3.6 më poshtë, kërkohen të paktën 3 inxhinierë të pajisur me çertifikatë trajnimi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, e cila konsiderohet e papërshtatshme për objektin e punës dhe në kundërshtim me VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””

Në të njëjtën linjë, në nënpikën 2.3.9, kërkohet që në stafin e OE të ketë veç të tjerëve 1 inxhinier mekanik, 1 punonjës mekanik, 2 punonjës elektrikistë, 2 punonjës hidraulikë, 1 punonjës montator, 1 punonjës saldator, 3 punonjës specialistë guri dekorativ, 3 punonjës punëtorë gjelbërimi, etj., të gjithë “të pajisur me Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë”, ndërkohë që asnjë nga këto profesione nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, si dhe AK nuk mund të heqë të drejtën e kualifikimeve “ekuivalente” në vendet e BE-së etj.

Në nënpikën 2.3.10 kërkohen dëshmi për pajisje teknike të cilat nga grupi i auditimit konsiderohet se nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit dhe vëllimin e punimeve, pasi nuk ka zëra të tillë punimesh

Pësa i përket grafikut të punimeve, konstatojmë se nuk korrespondon me preventivin e punimeve, në të cilin kërkohet ndërtimi i 2 urave të reja, riparimi i 7 urave (nga të cilat shuma 8, Stamaticë duket se është vendosur 2 herë dhe duhet investiguar më tej, nëse janë 2 ura me të njëjtët zëra punimesh apo është vendosur 2 herë për të rritur vëllimin e punimeve) dhe transport mbeturinash, ndërsa në grafikun e punimeve kërkohet ndërtimi i 2 urave të reja dhe riparimi i 5 urave. Riparimi i urës/urave në Stamaticë dhe transporti i mbeturinave nuk janë përfshirë në grafik

Nga auditimi i ST dhe krahasimi i tyre me preventivin e punimeve dhe grafikun e punimeve, u konstatua se ST nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit dhe mungojnë vizatimet/skicat. Nga përshkrimi, ST i përkasin një objekti tjetër, më të madh, (normalisht ndërtimit të një rruge apo ujësjellësi), pasi përmbajnë zëra punimesh dhe standarde të nivelit ndërkombëtar, si p.sh., “përforcim ndërtesash”, “largim ujrash”, “Mbrojtje të shërbimeve ekzistuese”, mirëmbajtje drenazhimesh”, “tubacione polietileni”, “shtersa me gurë të thyer”, “shtresa me asfaltobeton”, “themele me gurë të thërmuar”, “betone të parapërgatitura”, “çimento e rezistueshme ndaj sulfateve”, etj.

OE fitues nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të LPP, vërtetime nga gjykata, prokuroria dhe nga autoritetet tatimore, sipas kërkesave të LPP, neni 45

Në lidhje me kualifikimin e OE “T.”, grupi i auditimit mendon se ky OE duhet të ishte skualifikuar, pasi:

Në objektin e aktivitetit, OE T., i shpallur fitues nuk e ka ndërtimin e urave dhe veprave të artit (seksioni 9 i ekstraktit nga QKB). Kjo kërkesë bie në kundërshtim me kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe me bazën ligjore të përmendur më sipër. Gjithashtu, OE ka deklaruar në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Shtojcën 4 të DST se ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

OE T. në ekstraktin e QKB-së ka të regjistruara 2 vende për ushtrimin e aktivitetit, nga të cilat një është zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri, në adresën “Berat L. Barrikad” (seksioni 9 i ekstraktit të thjeshtë) dhe një në adresën “*Berat Cukalat DONOFROSE Lagjja Qender, rruga kryesore, banese private nr. 13*” (seksioni 13 i ekstraktit të thjeshtë të QKB-së, vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit). Në vërtetimin për pagesat e energjisë elektrike, OE ka paraqitur vetëm 1 kontratë, gjë që do të thotë se nuk e vërteton pagesën e të gjitha detyrimeve për energjinë elektrike, sipas VKM nr. 914, neni 26

Dokumentacioni i paraqitur nga OE T. për makineritë teknologjike të kërkuara në DST nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “*Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë*”, neni 113 “*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*”, pika 4

OE Sh. ka si objekt aktiviteti ndërtimin e veprave të artit, të cilën nuk e ka OE fitues.

OE Sh. ka paraqitur pagesat e energjisë elektrike për dy kontrata, që korrespondojnë me dy vendet e ushtrimit të aktivitetit, sipas ekstraktit të QKB-së, të cilat OE fitues nuk i ka.

Në nënikipkën 2.3.4 të Shtojcës 11 të DST, kërkohet që “*OE duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 35 punonjës të siguruar për periudhën Janar 2017 – Prill 2018. Listëpagesat të jenë të konfirmuara në Tatime, të shoqërohen me Urdhër pagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si edhe me faturat e bankës.*”. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni të depozituar në APP, (argumentat nëse duhej kërkuar apo jo janë paraqitur në pikën 7 më sipër), u konstatua se gjendet i plotë, në të njëjtat kushte, përkatësi dhe plotësi që është edhe dokumentacioni analog i paraqitur nga EO fitues.

Në nënikipkën 2.3.5 të Shtojcës 11 të DST, kërkohet që “*OE duhet të ketë të punësuar inxhinieret...*”. duke pasur parasysh se për shumicën e inxhinierëve nuk korrespondojnë punimet në preventiv, nga grupi i auditimit gjykohet se OE “Sh.” i plotëson kushtet për t’u kualifikuar.

Në nënikipkën 2.3.9 të Shtojcës 11 të DST, kërkohet që “*OE ofertues duhet të ketë në stafin e vet punonjës të pajisur me Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik...*”. nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në APP, u konstatua që ky dokumentacion disponohet në dosje.

Makineritë që disponon OE “Sh.” janë të pajisura me leje qarkullimi etj, gjë që i lejon të qarkullojnë rregullisht, ndryshe nga OE fitues, të cilit i mungon ky dokumentacion. (pika 9 më sipër).

Sa më sipër, pavarësisht se të dy OE ofertues mund të ishin skualifikuar, në lidhje me skualifikimin e OE “Sh.”, duke pasur parasysh edhe mënyrën e kualifikimit të OE T. nga KVO, grupi i auditimit mendon se për shqyrtimin e dokumentacionit KVO ka vepruar me dy standarde, kanë diskriminuar OE “Sh.” i cili duhet të ishte kualifikuar dhe për shkak të vlerës më të ulët duhet të ishte shpallur fitues për lidhjen e kontratës. Nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të KVO, duke shpallur fitues OE “T.”, buxhetit të bashkisë Ura Vajgurore i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 443,820 lekë (532,584 lekë me TVSH), e cila përbëhet nga diferenca



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Kriteri:	ndërmjet dy ofertave.
Ndikimi/Efekti:	Gjithashtu, përcaktimi i DST në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore të paraqitura më sipër, si dhe duke gënjyer mundësinë e skualifikimit të të dy ofertuesve, me vlerësimin e tij KVO ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën 3,300,534 lekë (3,960,641 lekë me TVSH).
Shkaku:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Rëndësia:	Ndikim negativ në buxhetin e bashkisë Ura Vajgurore, funksionim me dy standarde të KVO-së.
Rekomandim 1:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rekomandim 2:	I lartë. Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për nxjerrjen e përgjegjësive për vlerën e dëmit ekonomik prej 443,820 lekësh Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për përcaktimin e DST në përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fituese të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

38. Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Astrit Hyka” dhe ndërtim i ambienteve sportive, fshati Kutalli”

Situata:	<p>Shtyrja e afatit dhe zgjidhja e ankesave nuk janë pasqyruar në Raportin Përmbledhës për procedurat e prokurimit. Këto shtyrje janë bërë në kundërshtim me nenin 42 të LPP, pika 2/1</p> <p>Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me LPP, neni 23, pika 1</p> <p>Pika “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë”, është hequr nga DST dhe nuk janë kërkuar vërtetimet e pagesës së detyrimeve tatimore qendrore dhe vendore etj, në kundërshtim me LPP, neni 45</p> <p>Në Shtojcën 12 të DST, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, në nënpikën 1, AK në lidhje me vërtetimin e punëve të ngjashme ka tjetërsuar kriterin ligjor për kufirin e punëve të ngjashme dhe/ose xhiros së OE, duke ndryshuar përcaktimet ligjore dhe formulimin, rrjedhimisht duke favorizuar OE të caktuar.</p> <p>Përcaktimi në nënpikën 5 të Kapacitetit teknik se OE duhet të ketë të punësuar të paktën 60 punonjës dhe kërkesat e tjera të renditura më poshtë në lidhje me punonjësit, nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 61 të LPP</p> <p>Kërkesat për licencat, inxhinierët dhe punonjësit e pajisur me dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik janë të tepërta dhe nuk argumentohet domosdoshmëria e tyre për shkak të vëllimit të punës për secilën nga kategoritë apo grupet e kërkuara. Duke rritur në mënyrë artificiale kriteret, AK ka përjashtuar konkurrencën më pak të kualifikuar, por që ka pasur më shumë mundësi për të dhënë një ofertë me vlerë më të ulët.</p> <p>Përsa i përket specifikimeve teknike, konstatohet se nuk korrespondon plotësisht me preventivin e punimeve, pasi në specifikimet teknike përshkruhen punime të cilat nuk gjenden në preventiva, si p.sh.: prishje tarracash dhe mure guri, drenazhim, hidroizolim i plintave dhe themeleve,</p>
-----------------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Mure me blloqe betoni, Mure me gurë, Mure të thatë (kartongips), Mure zjarrdurues, tarraca të reja, Çati me tjegulla bituminoze, Çati me panele sandwich, Çati metalike, druri, patinime, tavane të varuara, panele diellore për ngrohjen e ujit, në preventiva parashikohet shpërndarje e ujit për ngrohje me tuba Mannesmann, ndërkohë që në ST nuk parashikohet një gjë e tillë, etj., të cilat nuk po i përmendim për shkak të vëllimit të madh.

Në preventiva janë përcaktuar punime të tepërta, si psh transport vertikal i mbeturinave, etj., depozita e vendosur për karburantin prej 10,000 litrash është jashtëzakonisht e madhe dhe ka bërë që të mos përdoret kaldaja pasi nuk mund të mbushet me naftë, etj.

Inxhinierët që kanë nënshkruar projektin nuk kanë kompetencat e duhura teknike për të projektuar të gjitha fushat e objektit në fjalë, si psh. instalime elektrike, hidroteknike, ngrohje-ftohje, linja kompjuterash, kamerash, etj.

AK nuk ka të drejtë të përcaktojë origjinën e mallrave. Në preventiva kërkon që disa artikuj të jenë prodhime importi, duke rënë ndesh me kërkesat e nenit 23, pika 5

Me Ref. Ura Vajgurore nr. 1469 prot., datë 26.06.2018 nga OE A. shpk është paraqitur një ankesë në lidhje me DST, për kërkesën e një drejtuesi teknik me profesion arkitekt dhe disa punonjës me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, të ndarë në grupe. AK ka pezulluar procedurën dhe ka shtyrë datën e pranimit dhe hapjes së ofertave, por në vendimin nr. 1469/3 prot., datë 27.06.2018, grupi i punës i përbërë nga N. C., B. R. dhe R. B. e ka hedhur poshtë ankesën, duke mos dhënë argumente bindës. Me Ref. Ura Vajgurore nr. 1481 prot., datë 27.06.2018 nga OE S. shpk është paraqitur një ankesë në lidhje me DST, për kërkesën e një inxhinieri elektronik, një arkitekti, një inxhinieri për auditimin e energjisë dhe disponimin e licencës për ekspertizë mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave. Në vendimin nr. 1481/12 prot., datë 27.06.2018, grupi i punës si më sipër e ka hedhur poshtë ankesën, duke mos dhënë argumente bindës. Me Ref. Ura Vajgurore nr. 1482 prot., datë 27.06.2018 nga OE C. shpk është paraqitur një ankesë në lidhje me DST, për kërkesën e një inxhinieri elektronik si drejtues teknik, disponimin e licencës për ekspertizë mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave dhe disponimin e licencës për mbrojtjen e mjedisit. Në vendimin nr. 1482/3 prot., datë 27.06.2018, grupi i punës e ka hedhur poshtë ankesën, duke mos dhënë argumente bindës.

Me vendimin nr. 1420/6 prot., datë 19.07.2018 është pezulluar procedura e prokurimit për ndryshime në DST pas konsultimeve me APP-në. Me PV nr. 1420/6, datë 19.07.2018, AK ka vendosur ndryshimin e disa kritereve të DST-së, të cilat edhe pas ndryshimit janë në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu, OE konkurues nuk janë njoftuar shkresërisht për këto ndryshime në DST, në kundërshtim me kërkesat e LPP, neni 42

Prokura e mbikëqyrësit për z. B. L. është fotokopje e panoterizuar. Dokumentacioni i mbikëqyrësit nuk e ka vulën lidhëse të noterit.

OE A.S. në ekstraktin e QKB-së ka të regjistruara disa vende për ushtrimin e aktivitetit, nga të cilat një është zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri, në adresën “Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Frosina Plaku, Pallati nr.21, Shkalla A, Apartamenti nr. 5, Kati III-te” (seksioni 7 i ekstraktit) dhe të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	<p>tjerat NË adresat “<i>Tirane Preze AHMETAQ Rruga Nacionale Vore - Fushkruje, Zona KA.le 1006 Tirane Bexull DOMJE Fshati Domje, Rruga Miqesia, Objket ne ndertim 2 kate me Zone kA.le 1514 nr. pasurie 313/49, Vol 10 Fq 43 dhe Zone kA.le 1514, Nr Pasurie 313/50, Vol 10, fq 44 Tirane Bexull Bexull Fshati Bexull, Objekt ne ndertim 1 Kat me zone kA.le 1167, Ndr Pasurie 211/46, Vol 13 Fq.16 dhe Zone KA.le 1167, Nr. pasurie 211/26, Vol 09, Fq.247</i>” (seksioni 15 i ekstraktit të thjeshtë të QKB-së, vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit). Në vërtetimin për pagesat e energjisë elektrike, OE ka paraqitur vetëm 1 kontratë, gjë që do të thotë se nuk e vërteton pagesën e të gjitha detyrimeve për energjinë elektrike, sipas VKM nr. 914, neni 26</p> <p>Pavarësisht se OE fitues ka paraqitur deklaratë për disponimin e pajisjeve dhe makinerive të tij, të mbështetur me fatura, nga verifikimi i bilancit të depozituar u konstatua se vlera e makinerive dhe pajisjeve për vitin 2017 është zero dhe në listat e inventarit (2017) figuron vetëm një gjenerator.</p> <p>Dokumentacioni i noterizuar, i paraqitur nga OE fitues, nuk përmban listën e dokumentave të noterizuara, asnjë inventar apo numër fletësh, si dhe dokumentat e përmbledhura nuk kanë vulën lidhëse të noterit.</p> <p>Për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, si dhe për mosanulimin e procedurës dhe shpalljen fitues të OE “A.S.” sh.p.k., i cili nuk i plotëson kriteret e DST, veprime të cilat kanë shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 45,562,440 lekë (54,674,928 lekë me TVSH).</p> <p>Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.</p>
Kriteri:	Ndërkim negativ në buxhetin e bashkisë Ura Vajgurore, funksionim me dy standarde të KVO-së.
Ndikimi/Efekti:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Shkaku:	I lartë.
Rëndësia:	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për përcaktimin e DST në përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.
Rekomandim 2:	

39. Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve të rekreacionit në fshatin Samaticë”

Situata:	<p>Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së OE të ftuar për pjesëmarrje. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me LPP, neni 23, pika 1</p> <p>Specifikimet teknike në këtë rast nuk janë në përputhje me kërkesat e VKM-së 914, neni 27, pika 1</p> <p>Në nënpikën 2.2.2 të DST AK në lidhje me vërtetimin e punëve të ngjashme ka tjetërsuar kriterin ligjor për kufirin e punëve të ngjashme dhe/ose xhiros së OE, duke ndryshuar përcaktimet ligjore dhe formulimin, rrjedhimisht duke favorizuar OE të caktuar.</p> <p>Në numrin 2 të Kapacitetit teknik, Shtojca 11 e DST, kërkohet licenca profesionale në lidhje me ekzekutimin e kontratës. Grupi i auditimit konstaton se jo të gjitha kategoritë e kërkuara kanë lidhje me objektin e prokurimit dhe rrjedhimisht kërkesat për kategoritë e listuara më poshtë</p>
-----------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

janë të tepërta dhe bien ndesh me LPP, neni 46

Kategoria NS - 6 A (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese);

Kategoria NP - 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Kategoria NS - 13 A (Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni);

Kategoria NS - 19 A (Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë);

Kategoria NS - 20 A (Shpime gjeologjike – inxhinierike, puse e shpime për ujë)

Sa më sipër, në preventivin e bashkëlidhur DST, nuk figuron asnjë nga këto lloj punimesh, ndërkohë që AK nuk ka kërkuar posedimin e licencës për punime elektrike, pasi ka mjaft punime të tilla.

Përcaktimi në numrin 4 të Kapacitetit teknik, Shtojca 11 e DST, se OE duhet të ketë të punësuar mesatarisht 40 punonjës është i tepërt dhe pa lidhje me objektin e kontratës

Në numrin 10 të Kapacitetit teknik, Shtojca 11 e DST, kërkohen certifikata të standardeve ndërkombëtare ISO, etj, një pjesë e të cilave nuk kanë lidhje me punimet e listuara në preventiv, duke rënë ndesh me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të vendosura në pikën 3 më sipër. Çertifikatat të cilat nuk përputhen me zërat e punimeve në preventiv, janë si më poshtë:

ISO 27001-2005, “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit”;

ISO 39001 -2012, “Për menaxhimin e sigurisë së trafikut rrugor”;

ISO 3834-2:2006, “Për kriteret e cilësisë në saldimit me fuzion të materialeve”;

ISO 50001-2012, “Për sistemet e menaxhimit të energjisë”;

ISO 8000:2014, “Për përgjegjësinë shoqërore ndërkombëtare”;

BS EN 13331-1:2002, “Për sistemet e veshjes së kanaleve”;

DS CEN/TR 15128:2005, “Për shqyrtimin e standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit”;

ISO 28001:2007, “Për menaxhimin e sigurisë së sistemeve për zinxhirin e furnizimit”

Në numrin 12 të Kapacitetit teknik, Shtojca 11 e DST, veç të tjerave, kërkohet që OE të ketë në dispozicion (në pronësi apo me qera) një fabrikë betoni, rripa sigurimi për punime në lartësi, etj. Keto kërkesa konsiderohen të tepërta dhe bien në kundërshtim me kriteret ligjore dhe nënligjore të përcaktuara në pikën 3 më sipër, pasi në preventiva ka rreth 50 m³ beton dhe nuk ka punime në lartësi, për të cilat nuk përbën domosdoshmëri posedimi i një fabrike betoni apo rripa sigurimi, etj.

Kërkesa në numrin 15 të Kapacitetit teknik, Shtojca 11 e DST, për të deklaruar që makineritë e kërkuara të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera me Bashkinë Ura Vajgurore është e pakuptimtë, pasi BOE mund t'i ketë të angazhuara të njëjtat makineri dhe pajisje me AK të tjerë, të ndryshëm nga Bashkia Ura Vajgurore.

Kërkesa në numrin 15 të Kapacitetit teknik, Shtojca 11 e DST, (numri 15 është vendosur dy herë) për të pasur në pronësi lejen e shfrytëzimit për mineralin gur gëlqeror dhe disponimin e lavatriçes për larjen e gurit dekorativ nuk është e justifikuar dhe gjykohet preferenciale, pasi ju heq të drejtën OE të tjerë, të cilët mund të sigurojnë materialin e nevojshëm në forma të tjera të ligjshme.

Në ST, preventiv, projekt apo materialet e tjera, nuk ka asnjë të dhënë për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

karakteristikat e gurit dekorativ që do të përdoret, në bazë të së cilës të kërkohet fletë analiza e gurit që do të përdoret (numri 15).

AK nuk ka përcaktuar grafik për zbatimin e punimeve, sipas kërkesave të VKM-së nr. 914, neni 26, pika 4

Në të njëjtën linjë, në nënpikën 8, kërkohet që në stafin e OE të ketë veç të tjerëve 2 punonjës saldatorë, 2 punonjës mekanikë, 3 muratorë, etj., ndërkohë që asnjë nga këto profesione nuk ka lidhje me objektin e prokurimit. Në nënpikën 10, kërkohen minimumi dy punonjës të trajnuar për punime në lartësi. Në preventivin bashkëlidhur nuk ka asnjë punim në lartësi dhe rrjedhimisht kjo kërkesë është pa sens

Në shtojcën 12 të DST, “Projekti i zbatimit dhe specifikimet teknike”, thuhet: “Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj: *Bashkangjitur*”. Nga verifikimi i dokumentacioni bashkëngjitur, u konstatua se nuk ka specifikime teknike, por një reacion teknik, i cili nu paraqet pothuajse asgjë dhe një pjesë e tij (specifikime elektrike) është e papërkthyer nga italishtja (në kundërshtim me kriteret e përgjithshme të DST).

Në shtojcën 11 të DST, “*Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ose në proces*”, kërkohet që secili prej anëtarëve të BOE të plotësojë këtë deklaratë. Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se OE E. K. ka deklaruar një kontratë, ndërkohë që ka të paktën edhe një kontratë tjetër me Bashkinë Ura Vajgurore, për pastrimin e qytetit, ndërsa OE T. nuk e ka paraqitur fare këtë deklaratë.

Në lidhje me kualifikimin e OE “T.”, grupi i auditimit mendon se ky OE duhet të ishte skualifikuar, pasi:

OE T. në ekstraktin e QKB-së ka të regjistruara 2 vende për ushtrimin e aktivitetit, nga të cilat një është zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri, në adresën “Berat L. Barrikad” (seksioni 9 i ekstraktit të thjeshtë) dhe një në adresën “*Berat Cukalat DONOFROSE Lagjja Qender, rruga kryesore, banese private nr. 13*” (seksioni 13 i ekstraktit të thjeshtë të QKB-së, vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit). Në vërtetimin për pagesat e energjisë elektrike, OE ka paraqitur vetëm 1 kontratë, gjë që do të thotë se nuk e vërteton pagesën e të gjitha detyrimeve për energjinë elektrike, sipas VKM nr. 914, neni 26

Dokumentacioni i paraqitur nga OE T. për makineritë teknologjike të kërkuara në DST nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “*Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë*”, neni 113 “*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*”, pika 4

Gjithashtu, në lidhje me makineritë dhe në vërtetim të argumentit të mësipërm, OE T. nuk ka plotësuar të dhënat e detyrueshme për makineritë, sipas shtojcës 9 të DST.

Sa më sipër, KVO duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit, pasi ofertuesi i vetëm nuk i përmbush kriteret e përcaktuara me ligj dhe në DST. Për këtë shkelje ngarkohet me përgjegjësi KVO, A. P., M. M. dhe B. B.. Gjithashtu, përcaktimi i DST në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore të paraqitura më sipër, si dhe duke gjykuar mundësinë e skualifikimit ofertuesit, me vlerësimin e tij KVO ka shkaktuar **paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 6,665,910**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Kriteri:	lekë (7,999,092 lekë me TVSH).
Ndikimi/Efekti:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Shkaku:	Ndikim negativ në buxhetin e bashkisë Ura Vajgurore, funksionim me dy standarde të KVO-së.
Rëndësia:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rekomandim:	I lartë.
	Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për përcaktimin e DST në përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për të gjitha procedurat e audituara për vitin 2018.

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të KLSH-së:

Audituesi pasi shqyrtoi komentet e paraqitura nëpërmjet këtyre observacioneve, nuk konstatoi asnjë bazë ligjore apo dokument të ndryshëm nga ato të cilat gjendeshin në dosje dhe janë shqyrtuar gjatë procesit të auditimit. Për këtë arsye, nuk merret në konsideratë asnjë nga pretendimet e paraqitura.

VITI 2019

40. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “**Rikonstruksion sheshi lagja 18 tetori**”.

40	Titulli	i	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “ Rikonstruksion sheshi lagja 18 tetori ”, me fond limit 30,574,691 lekë pa tvsh .
Gjetjes:			
Situata:			Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, si kërkesat për certifikata ISO, auditues energjie, numri i punonjësve, makineritë, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2. Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 3 OE, një prej tyre nuk ka paraqitur ofertë dhe oferta me vlerën më të ulët është s’kualifikuar për mangësi të theksuara në dokumentacion dhe ka fituar vlera më e lartë e ofruar nga BOE “T.” shpk, “F.” shpk dhe “K.” shpk në vlerën 29,998,925 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të BOE të shpallur fitues rezultuan këto mangësi: Ky BOE ka paraqitur në aktmarrëveshjen për bashkim të përkohshëm të shoqërive nr.926 rep. e 574 Kol., datë 13.5.2019, ndarjen në total dhe jo sipas punëve konkrete. Rezulton se OE “K.”shpk nuk ka paraqitur në spe.gov.al. asnjë certifikatë ISO ndërsa për kategoritë e licensës rezulton se OE “K.”shpk nuk ka kategorinë NS 19A. Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e BOE “T.” shpk & “F.” shpk & “K.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën 29,998,925 lekë dhe për këtë ngarkohet me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. I. Sh., znj. M. M. dhe znj. B. B..
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Autoriteti Kontraktor bashkia Ura Vajgurore të marrë masa që në përcaktimin e kriterëve për kualifikim të ketë në konsideratë objektin e prokurimit dhe të përputhë këto kriterë me të. Gjithashtu, nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

41 Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “*Hartim Projekt-Preventiv urat mbi lumin Osum*”.

41 Titulli i Gjetjes:	Mos zbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt “ <i>Hartim Projekt-Preventiv urat mbi lumin Osum</i> ”, me fond limit 5,833,333 lekë pa tvsh .
Situata:	<p>Mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DST nga njësisia e prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, si kërkesat për përbërjen e stafit teknik me eksperiencë profesionale mbi 25 vjet etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.</p> <p>Nga auditimi rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 BOE e përbërë nga “I. P.” shpk & “A. S.” shpk dhe “A.C.” shpk. Ky BOE nuk plotëson kriterin për përbërjen e stafit teknik drejtues, pasi për plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë kanë paraqitur vetëm CV e punonjësve të tyre por nuk kanë paraqitur diplomë apo dokument tjetër që të provojë se këta kanë eksperiencën profesionale sipas viteve të kërkuara në DST. Përsa i përket përvojës së ngjashme, OE “A. S.” shpk ka paraqitur disa kontrata të lidhura me organe publike por nuk ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga enti publik dhe fatura tatimore shitje ku shënohen qartë palët, datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.</p> <p>Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e BOE “I. P.” shpk & “A. S.” shpk & “A.C.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike , në vlerën 5,550,000 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. I. Sh., znj. M. M. dhe znj. B. B..</p>
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar cilësinë e tyre.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Autoriteti Kontraktor bashkia Ura Vajgurore të marrë masa që në përcaktimin e kriterëve për kualifikim të ketë në konsideratë objektin e prokurimit dhe të përputhë këto kriterë me të. Gjithashtu, nga ana e bashkisë Ura Vajgurore të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për procedurat “Rikonstruksion sheshi lagja 18-Tetori” dhe “Hartim Projekt-Preventiv urat mbi lumin Osum”.

Sqarim: Pas përfundimit të aktkonstatimeve nga subjekti janë bërë kundërshti të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në fazën e projekt raportit të auditimit, por për mungesë të fakteve dhe argumenteve ligjore nuk janë marrë parasys. Duke qenë se të njëjtat observacione janë bërë edhe për projekt raportin dhe nuk ka asnjë provë apo fakt të ri, nuk janë marrë parasys.

D/4 AUDITIM PËR ZBATIMIN E PUNIMEVE, DERI NË MARRJEN NË DORËZIM TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE DHE ZBATIMIT I KONTRATAVE TË PUNËVE PUBLIKE, KOLAUDIMI DHE MARRJA NË DORËZIM E PUNIMEVE;

Nga grupi i auditimit u audituan 8 kontrata zbatim punimesh me vlerë të kontratës 476,058,237 lekë me tvsh dhe pa tvsh në vlerë 396,715,198 lekë, për të cilat u konstatua dëm ekonomik në shumën 5,509,450 lekë, dhe efekte ekonomike negative 625,300 pa TVSH

- 1) “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjentëve të Rekreacionit në fshatin Donofrosë”;
- 2) “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “Refat Bani”;
- 3) “Sistemim varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajgurore”
- 4) “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjentëve të rekreacionit në fshatin Samaticë”;
- 5) “Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”
- 6) “Ndërhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga Stacioni pompave Poshnje”;
- 7) “Sistemim i rrugës së tregjeve (Loti 1)”;
- 8) “Kanali ujitës BRU – 15 Manastir dhe ushqyesi i rezervuarit”;

Në zbatim të pikës D.4 të Programit të Auditimit në Bashkinë Ura Vajgurore u krye auditimi i zbatimit të punimeve në objektet sa vijon:

1- “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjentëve të Rekreacionit në fshatin Donofrosë”, Bashkia Ura Vajgurore

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjentëve të Rekreacionit në fshatin Donofrosë”.			
Lidhja e kontratës Nr.1215/19 Prot datë 10.07.2018	Vlera e kontratës 9,477,624 lekë me tvsh OE fitues “R. C.” SHPK		Likuiduar:
Situacioni Përfundimtar 9,465,316 lekë me tvsh	Afati i kontratës në dite Parashikuar 2 muaj Fillimi punimeve: 17.07.2019 Përfundimi punimeve sipas faktit. 30.11.2019		Zgjatja e kontratës S’ka
Mbikëqyrësi i punimeve N. M.	Licenca Nr: MK. 0992/2	Kontrata nr.21/6 prot, datë 16.07.2019	237,840 lekë me Tvsh
Kolaudatori i punimeve L. H.	Licenca Nr: MK 2928/7	Kontrata me nr. prot., datë 16.08.2018	Pa vlerë ekonomike

Nga auditimi i dosjes teknike nuk administrohet asnjë kërkesë për shtyrje afati, punimet janë ndërprerë (referuar ditarit të punimeve) me argumentin se ke ka probleme me pronarët e tokës për sipërfaqen S1. Realizimi i punimeve, duke tejkaluar afatin e përfundimit të punimeve me 61 ditë, nuk është i argumentuar. Nuk janë zbatuar penalitete për moszbatimin e afatit të përfundimit të punimeve me pasojë mungesë të ardhura ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 2,309,548 lekë me Tvsh.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Titulli i Gjetjes 43	Mosaplikimi nga ana e AK i penaliteteve për sipërmarrësin e punimeve “R. C.” Shpk, për vonesa në afatin e zbatimit të punimeve në përputhje me parakushtet e Kontratës së sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1215/19 Prot., datë 10.07.2017.
Situata:	Nga auditimi i dosjes së realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: - Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 61 ditë, nuk është e argumentuar, pasi akt piketimi dhe marrja e sheshit të punimeve në dorëzim konsideron që nuk ka probleme pronësie.
Kriteri:	Koha e realizimit të punimeve sipas kontratës është paracaktuar dy muaj, punimet kanë përfunduar për katë muaj. - Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar e konkretisht Neni 59, e 60 -VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar e konkretisht Neni 22, Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, 8 9 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu I, Pikat 3, 4, 5 e 6. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1215/19 Prot., datë 10.07.2017, neni 34, pika 34.1 a, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës “Dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 21/6 prot, datë 16.07.2019,”
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar mungesë të ardhurash në fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe mbikëqyrësit dhe të punimeve në verifikimin e zbatimit të punimeve brenda afatit të parashikuar.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për shqyrtimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për vlerën e penaltetit të paaplikuar për shumën 2,309,548 lekë me Tvsh për moszbatimin brenda afateve kohore të kontratës me nr. 1215/19 Prot., datë 10.07.2018 me objekt: “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve të Rekreacionit në fshatin Donofrosë”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë kjo e cila përfaqëson e ardhur e munguar ndaj buxhetit të njësisë vendore, si rrjedhojë e mosaplikimit të penaliteteve për realizimin e punimeve brenda afatit të paracaktuar.

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për të gjitha procedurat e audituara për vitin 2018.

Lidhur me objektin e mësipërm, është observuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve Ing. N. M., Kolaudatori “G. L. K.” Shpk dhe Sipërmarrësi i punimeve “R. C.” Shpk. Bashkëlidhur observacionit dhe fotografi të objektit. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

Në lidhje me vonesat në realizimin e punimeve ju sqarojmë se këto vonesa kanë ardhur nga shkaqe që nuk varen nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi dhe se sheshi i ndërtimit nga pikpamja teknike ka qenë i lirë, ndaj në momentin fillestar të tij në formularin e dorëzimit të tij nuk është shënuar pjesërisht i lirë, përse i përket pretendimeve të pronësisë të dala me vonë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

investitori nuk kishte dijeni për to dhe i sqaroi ato po vet hap pas hapi me pretenduesit duke ju drejtuar edhe Zyrës Vendore të Pasurive të Palujtshme Berat për vënie dokumentacioni ne dispozicion. Po kështu në çdo ndërprerje dhe rifillim pune investitori ka qene prezente dhe ne kemi marrë miratimin e investitorit për këto ndërprerje e rifillime.

Opinion i grupit të auditimit:

Pretendimet e mësipërme nuk shoqërohen me argumente bindës teknike e ligjore, pasi nuk egziston termi: “...leje ndërtimi e pjesshme apo shesh ndërtimi i pjesshëm” i përdorur nga ju për sheshet e ndërtimit. Gjithashtu, bazuar në aktдорëzimin e datës 17.07.2019, sheshi ka qenë i lirë. Përsa më sipër pretendimet tuaja nuk merret në konsideratë.

Vlera prej 2,309,548 lekë me Tvsh, e cila përfaqëson penalitetetin e pa aplikuar për realizimin e punimeve me 61 ditë kalendarike më tepër se kontrata, konsiderohet si efek ekonomik ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Znj. J. M. me detyrë Titullare e Autoritetit Kontraktor.
- 2) N. M. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **100,000 lekë pa Tvsh.**

Titulli i Gjetjes 44	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve të Rekreacionit në fshatin Donofrose”, Bashkia Ura Vajgurore, nga zbatuesi i punimeve OE “R. C.” SHPK, për 1 nga zërat e punimeve.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërin e punës “Lodra për fëmije”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1215/19 Prot., datë 10.07.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 21/6 prot, datë 16.07.2019. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit pa nr. prot., datë 16.08.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	I lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 100,000 lekë pa Tvsh nga OE fitues “R. C.” SHPK , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1215/19 Prot datë 10.07.2018 me “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve të Rekreacionit në fshatin Donofrose”, <i>Bashkia Ura Vajgurore</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.
---------------------	--

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për të gjitha procedurat e audituara për vitin 2018.

Lidhur me objektin e mësipërm, është observuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve Ing. N. M., Kolaudatori “G. L. K.” Shpk dhe Sipërmarrësi i punimeve “R. C.” Shpk. Bashkëlidhur observacionit dhe fotografi të objektit. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

5. Për Kapitullin A. 4. Punime gjelbërimi dhe sinjalistike, në zërin e punës me numër rendor 6, me numer analize An. me përshkrim “Lodra për fëmijë”,....., ju sqarohet se ky zë pune është kryer tërësisht nga sipërmarrësi dhe me kolaudimin e punimeve objekti i është dorëzuar investitorit për shfrytëzim nga ky moment mbikqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve nuk janë përgjegjës për ruajtjen e objektit nga dëmtimet.

Në mbështetje të sqarimit tonë më poshtë po ju bashkëngjisim dhe foto të këtyre lodrave të vendosura në objekt (të vendosura në sheshin e qendrës së fshatit Donofrosë).

Opinionin e grupit të auditimit:

5. Përsa i përket zërit të punimeve “Lodra për fëmijë”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë pjesërisht. Pasi në fotot e paraqitura konstatohen vetëm dy “Lodra për fëmijë” nga tre që janë likujtuar sipas situacionit përfundimtar dhe vlera prej 100,000 lekë do të pasqyrohet në vlerën e dëmit ekonomik

Vlera prej 100,000 lekë pa Tvsh, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Znj. N. M. me detyrë mbikëqyrësi i kontratës së sipërmarrjes.
- 2) Z. G. S. me detyrë kolaudator i kontratës së sipërmarrjes;

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, por që nuk ekzistonin në ambientet e rekreacionit në Donofrosë, me pasojë efekt ekonomik negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **625,300 lekë pa Tvsh**.

Titulli i Gjetjes 45	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve të Rekreacionit në fshatin Donofrose”, Bashkia Ura Vajgurore, nga zbatuesi i punimeve OE “R. C.” Shpk, për 9 nga zërat e punimeve.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume e zërave të punës: “F.V. Fidane Pemë dekorative”, F.V Mbjellje pemë dekorative Bli 16-18cm në trotuar (çdo 6m)”, “F.V Kosha dekorative për hedhjen e mbeturinave/ Konstruksiione metalike të thjeshta”, “F.V Pusetë elektrike 20x20 cm”, “F.V Pusete elektrike 40x40 cm”, “F.V. Ndriçues dopio 42Ë, 3000K, shtyllë ZN e lyer



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	5.5 ml”, “F.V. Ndriçues teke 63W, 3000K, shtyllë ZN e lyer 3.5 ml”, “F.V Shtyllë teke zingato e lyer, h= 5.5 ml” dhe “F.V Shtyllë teke zingato e lyer, h= 3.5 ml”, për pasojë vlera e kësaj difference është likujduar por këto pajisje nuk janë realisht në Donofrosë.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: -Ligj nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” indryshuar, konkretisht Nenet 5, 8 e 24. Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, konkretisht Kreu I, Pikat 2, 5, 6, 7 e 8, Kreu II, Pikat 17, 19, 20 etj, dhe Kreu III - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1215/19 Prot., datë 10.07.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 21/6 prot, datë 16.07.2019.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt ekonomik negativ në fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e Autoritetit Kontraktor në verifikimin i gjendjes dhe marrjen e masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për shqyrtimin e vlerës prej 625,300 lekë pa Tvsh që është vlere e zërave të punimeve të realizuara nga OE “R. C.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1215/19 Prot datë 10.07.2018 me “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve të Rekreacionit në fshatin Donofrose”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë kjo e cila përfaqëson efekt ekonomik negativ buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e dëmtimit të punimeve të kryera e të dëmtuara. AK duhet dokumentojë keqpërdorimin e këtyre aktiveve, evidentimin e përgjegjësive dhe të marr masat e nevojshme për menaxhimin me efektivitet të aktiveve.

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për të gjitha procedurat e audituara për vitin 2018.

Lidhur me objektin e mësipërm, është observuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve Ing. N. M., Kolaudatori “G. L. K.” Shpk dhe Sipërmarrësi i punimeve “R. C.”shpk. Bashkëlidhur observacionit dhe fotografi të objektit. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

1. *Për këtë konstatim tuaj në kapitullin D. Paisjet elektrike, në Zërin e punimeve me numër rendor 3 me përshkrimin “F.V Ndriçues teke zingato e lyer, h=3.5ml”, ju sqarojmë se ky zë pune është kryer tërësisht nga sipërmarrësi dhe me kolaudimin e punimeve objekti i është dorezuar investitorit për shfrytëzim nga ky moment mbikqyrësi dhe sipërmarrësi nuk janë përgjegjës për ruajtjen e objektit nga dëmtimet.*

Në mbështetje të sqarimit tonë më poshtë po ju bashkëngjisim dhe foto të këtyre ndriçusave të vendosur.....

Opinion i grupit të auditimit:

1. Përsa i përket zërit të punimeve “F.V. Fidane Pemë dekorative”, argumenti i sjellë në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

- observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik
2. Përsa i përket zërit të punimeve , “F.V Mbjellje pemë dekorative Bli 16-18cm në trotuar (çdo 6m)”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik
3. Përsa i përket zërit të punimeve “F.V Kosha dekorative për hedhjen e mbeturinave/ Konstruksione metalike të thjeshta”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik
4. Përsa i përket zërit të punimeve “F.V Pusetë elektrike 20x20 cm”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik
6. Përsa i përket zërit të punimeve “F.V Pusete elektrike 40x40 cm”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik
7. Përsa i përket zërit të punimeve “F.V. Ndriçues dopio 42Ë, 3000K, shtyllë ZN e lyer 5.5 ml”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik
8. Përsa i përket zërit të punimeve “F.V. Ndriçues teke 63Ë, 3000K, shtyllë ZN e lyer 3.5 ml”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik
9. Përsa i përket zërit të punimeve “F.V Shtyllë teke zingato e lyer, h= 5.5 ml”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik
10. Përsa i përket zërit të punimeve “F.V Shtyllë teke zingato e lyer, h= 3.5 ml”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik.

Argumentet e sipërcituara qëndrojnë, por në dokumentacionin e paraqitur nga Bashkia Ura Vajgurore gjatë auditimit, nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me kohën e konstatimit të humbjes/eliminimit/dëmtimit e investimit në objektin: "Rikualifikim urban dhe krijimi i ambjenteve te rekreacionit ne fshatin Donofrose"

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 13, datë 29.05.2020 dhe Aneksit të këtij akti bashkëlidhur, si dhe në Projekt Raportin Nr.262/4 Prot. e datë 8.06.2020.

Vlera prej 625,300 lekë pa Tvsh, e cila përfaqëson vlerën ekonomike për punimet, furnizimin dhe vendosjes e pajisjeve në objektin: “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve të Rekreacionit në fshatin Donofrosë”, por që nuk ekzistonjnë në fakt, konsiderohet si efekt ekonomik negativ, shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore.

2-“Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “Refat Bani”, Bashkia Ura Vajgurore

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “Refat Bani”			
Lidhja e kontratës Nr. 1296/13 Prot datë 11.08.2017	Vlera e kontratës 62,781,144 lekë me tvsh BOE fitues “T.”&”F.”&” B. B.” Shpk		Likuiduar: 62,792,2016 lekë me TVSH.
Situacioni Përfundimtar -Vlera 62,729,216.lekë me tvsh	Afati i kontratës në dite Parashikuar 5 muaj. Fillimi punimeve: 21.09.2017 Përfundimi punimeve sipas faktit : 03.06.2018 (<i>njoftimi pa protokoll</i>) Përfundimi punimeve sipas kontratës : 06.09.2019		Zgjatja e kontratës Amendim nr.1, nr.1296/ 17 prot, datë 14.08.2017; Amendimentin nr.2, nr. 2771/1, prot., datë 08.01.2018 Amendim nr.3, nr 2771/ 4 prot., date 21.03.2018
Mbikëqyrësi i punimeve Ing. N. M.	Licenca Nr: MK. 00992/2	Kontrata nr.1296/13 prot, datë 11.08.2017	0 lekë
Kolaudatori i punimeve Ing. V. Z.	Licenca Nr: MK 1148/2	Kontrata me nr. 978/2 prot., datë 20.06.2018	0 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Akt Kolaudimi Datë 13.07.2019	Akt i marrjes në dorëzim dt 23.07.2018
-------------------------------	--

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **393,570 lekë pa Tvsh.**

Titulli i Gjetjes 46	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “Refat Bani”, Bashkia Ura Vajgurore, nga zbatuesi i punimeve BOE fitues “BOE fitues “T.” & ”F.” & ” B. B.” Shpk, për 11 zëra pune.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës: “Kaset shkarkimi me llamarinë bakër 1mm”, F.V. elektroda tokëzimi te xinguara 50x3mm, L=150cm”, “Përcjellës bakri i verdhë jeshil 1x 50mm ² ”, “Kapikorda bakri 1x50mm” “FV puseta elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm”, “Hekur shirit i zinkuar 30x3”, “Fiksues të zinkuar shirit-shirit 30x3”, “Gërmim e mbushje dheu me krah për kanale kategoria IV, h = 1.5”, “Shkëputes për matje komplet”, “F.V. Stola druri”, “PVC 40x40x40cm kapak i fortë”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1296/13 Prot datë 11.08.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1296/13 prot, datë 11.08.2017. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 978/2 prot., datë 20.06.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 393,570 lekë pa Tvsh nga BOE “T.” & “F.” & “B. B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1296/13 Prot datë 11.08.2017 me “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “Refat Bani””, <i>Bashkia Ura Vajgurore</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për të gjitha procedurat e audituara për vitin 2018.

Lidhur me objektin e mësipërm, është observuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve Ing. N. M. dhe Sipërmarrësi i punimeve “T.” Shpk. Bashkëlidhur observacionit dhe fotografi të objektit. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

1. Për zërin “Veshje fasade me polesterol kompakt jeshil $t=5\text{cm}+rrjete+suva$ “, sqarimi juaj është si më poshtë :

Në lidhje me këtë zë ju sqarojmë se të dhënat teknike të materialit “Polesterol” të përdorur për veshjen e fasadës së shkollës “Refat Bani” janë të njëjta me ato të preventivuar e projektuar pamvaresisht ngjyrës. së bardhë dhe bashkëngjitur keni katalogun e prodhuesit nga i cili subjektet sipërmarrëse janë furnizuar për këtë material ku qartazi duket që gjithë produkti i këtij prodhuesi është me ngjyrë të bardhë.

2. Për zërin “Ulluk shkarkimi vertikal me bakër Ø120mm “, sqarimi juaj është si më poshtë:

Në lidhje me këtë zë ju sqarojmë se cilësitë teknike të zërit të vendosura janë të njëjtë me ato të preventivuar ndaj nuk ka as përfitim ekonomik por është një element arkitektonik i përmirësuar.

Opinion i grupit të auditimit: Përsa i përket zërave të punimeve të sipërcituara, argumentet dhe provat e paraqitura pranohen dhe reflektohen në Raportin Përfundimtar.

Në lidhje me

3. Për zërin “Kaset shkarkimi me llamarine bakër 1mm”.

4. Për zërin “F.V. elektroda tokëzimi te xinguar 50x3mm, L=150cm”.

5. Për zërin “Kapikorda bakri 1x50mm”

6. Për zërin “FV puseta elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm”

7. Për zërin “Hekur shirit i zinkuar 30x3”.

8. Për zërin “Fiksues të zinkuar shirit-shirit 30x3”

9. Për zërin “Shkëputes për matje komplet”

Opinion i grupit të auditimit: Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë ligjërisht, teknikisht as realisht e nuk merren parasysh.

Pasi për zërin “Kaset shkarkimi me llamarine bakër 1mm”, duket qartë edhe në foto që ulluk i shkarkimit është i lidhur direkt me ullukun horizontal të çatisë të shkollës.

Përsa i përket “Sistemit të tokëzimit” është e vërtetë që elektrodat janë të padukshme, por “Hekur shirit i zinkuar 30x3” dhe “kapikortat ...” janë sipërfaqësore, pra pa këta element sistemi i tokëzimit nuk funksionon. Nga ana tjetër, nëse ju i keni vendosur brenda kapotës (jo si kërkohet në projekt), atëherë është bërë një gabim i rëndë teknik që rrezikon seriozisht godinën nga zjarri. Për zërat e punimeve në kapitullin “Sistemin përreth shkollës” nuk janë të përmendura në observacion

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 14, datë 29.05.2020 si dhe në Projekt Raportin Nr.262/4 Prot. e datë 8.06.2020.

Vlera prej 393,570 lekë pa Tvsh, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Znj. N. M. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.
- 2) Znj. V. Z. me detyrë kolaudator i kontratës së sipërmarrjes;

3- “Sistemin varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajgurore”

Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Sistemin varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajgurore”		
Lidhja e kontratës Nr. 1288/13 Prot., datë 11.08.2017	Vlera e kontratës 35,165,454 lekë me Tvsh	Likuiduar: Situacioni përfundimtar lekë me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	BOE fitues “K.” & “T.” Shpk		Tvsh	
Situacioni Përfundimtar 35,159,158 lekë me tvsh	Afati i kontratës në dite Parashikuar 3 muaj. Fillimi punimeve: 14.08.2017 Përfundimi punimeve sipas faktit. 14.12.2017		Zgjatja e kontratës Ka 1 muaj zgjatje	
Mbikëqyrësi i punimeve “A. M.”	Licenca Nr: MK. 2892	Kontrata nr.40/7 prot, datë 14.06.2017	394,128 lekë me Tvsh	
Kolaudatori i punimeve “G. L.” Shpk	Licenca Nr: MK 2928/3	Kontrata me nr.6/7 prot., datë 02.03.2018	46,680 lekë me Tvsh	
Akt Kolaudimi Datë 07.03.201	Akt i marrjes në dorëzim dt 12.03.2018			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **304,391 lekë pa Tvsh.**

Titulli i Gjetjes 47	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Sistemim varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajgurore”, nga zbatuesi i punimeve BOE “K.” Shpk & “T.” SHPK, për 4 zëra pune.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Mur guri mbajtës e themele, Ilaç çimento M25”, “Mbushje me zhavorr pas mureve”, “Brez betoni” dhe “F.V Hekur betoni (plegma φ 6)”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1288/13 Prot., datë 11.08.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 40/7 prot, datë 14.06.2017. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 6/7 prot., datë 02.03.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 304,391 lekë pa Tvsh nga BOE “K.” Shpk & “T.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1288/13 Prot., datë 11.08.2017 me “Sistemim varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajgurore”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për të gjitha procedurat e audituara për vitin 2018.

Lidhur me objektin e mësipërm, është observuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve Ing. N. M., Kolaudatori “G. L. C.” Shpk përfaqësuar nga Ing. G. S. (pa nënshkrim) dhe Sipërmarrësi i punimeve B.O.E “K.” Shpk & “T.” Shpk .Bashkëlidhur observacionit dhe fotografi të objektit dhe situacione përfundimtare. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

3. Fshati Syzes, Njësia administrative Poshnje, Bashkia Ura Vajgurore

1. Në zërin “Mure guri mbajtës themele llaç çimento M25”.

2. Në zërin “Mbushje me zhavor pas mureve”.

3. Në zërin “Brez betoni”.

4. Në zërin “F.V. Hekur betoni(plegme Ø 6mm)”

Për këtë konstatim tuajin në nënobjektin 3 “Rruga hyrëse e fshatit Syzez, Bashkia Ura Vajgurore” në zërin e punës me përshkrim, ju sqarojme se ky zë pune është kryer dhe është realizuar mbiështë në përmasa sipas matjeve të pasqyruara në librezën e masave që gjendet në dosjen e objektit të dorëzuar pranë investitorit.

Në mbështetje të sqarimit tonë më poshtë po ju bashkëngjisim dhe foto të këtyre punimeve të kryera në objekt.

Opinionit i grupit të auditimit: Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë ligjërisht, teknikisht e as realisht, pasi sasisa e punimeve që mungojnë janë nga konstatimet në terren, ky fakt vërtetohet edhe nga fotografitë e punimeve paraqitur nga ju, bashkëngjitur observacioneve.

5. Për zërin “Mbjellje peme dekorative Blin”

7. Fshati Banaj, “Njësia administrative Poshnje, Bashkia Ura Vajgurore

2. Për zërin “F. V. Mbjellje pemë dekorative Blin” ,sqarimi juaj është si më poshtë:

Për këtë konstatim tuajin ju informojme se në këtë nënobjekt ne nuk kemi pasur të preventivuar dhe as nuk kemi situacionuar nën zërin e punës me përshkrim “Mbjellje pemë Blin”, ju sqarojmë se ky zë pune është kryer dhe është realizuar në Fshatin Kutalli dhe Fshatin Banaj sipas matjeve të pasqyruara në librezën e masave që gjendet ne dosjen e objektit të dorëzuar pran investitori.

Opinionit i grupit të auditimit: Argumentet dhe provat e paraqitura pranohen dhe reflektohen në Raportin Përfundimtar.

Si më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 15, datë 29.05.2020, si dhe në Projekt Raportin Nr.262/4 Prot. e datë 8.06.2020.

Vlera prej 304,391 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) Znj. N. M. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2) “G. L. C.” me përfaqësues Ing.G. S. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

4- “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambienteve te rekreacionit në fshatin Samaticë” në Bashkinë Ura Vajgurore”

Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambienteve te rekreacionit në fshatin Samaticë”		
14.Lidhja e kontratës Nr. 2420/16 Prot., datë 15.11.2018	Vlera e kontratës 7,999,092 lekë me Tvsh BOE “T.” & “E. K. Shpk	16.LikuiduarSituacioni përfundimtar lekë me Tvsh
Situacioni Përfundimtar 7,719,351 lekë me Tvsh	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 3 muaj. Fillimi punimeve: 14.08.2017 Përfundimi punimeve sipas faktit. 14.12.2017	19. Zgjatja e kontratës Ka 3 muaj zgjatje



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Mbikëqyrësi i punimeve “A. M.”	Licenca Nr: MK. 2892	Kontrata nr.29/8 prot, datë 03.12.2018	145,290 lekë me Tvsh	
Kolaudatori i punimeve “G. L.” Shpk	Licenca Nr: MK 2928/2	Kontrata me nr.7/6 prot., datë 27.02.2019	21,000 lekë me Tvsh	
Akt Kolaudimi Datë 04.03.2019	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 05.03.2019			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **100,000 lekë pa Tvsh.**

Titulli i Gjetjes 48	Diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera në objektin: “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve të Rekreacionit në fshatin Samaticë”, Bashkia Ura Vajgurore, nga zbatuesi i punimeve OE BOE “T.” & “E. K.”, për 1 nga zërat e punimeve.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërin e punës “Lodra për fëmije”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1215/19 Prot., datë 10.07.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 21/6 prot, datë 16.07.2019. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit pa nr. prot., datë 16.08.2018.
Ndikimi/Efekt:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 100,000 lekë pa Tvsh nga BOE “T.” & “E. K.” , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1215/19 Prot datë 10.07.2018 me “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve të Rekreacionit në fshatin Samaticë”, <i>Bashkia Ura Vajgurore</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për të gjitha procedurat e audituara për vitin 2018.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Lidhur me objektin e mësipërm, është observuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve Ing. N. M., Kolaudatori “G. L. K.” Shpk dhe Sipërmarrësi i punimeve “T.” Shpk. Bashkëlidhur observacionit dhe fotografi të objektit. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

4. Për zërin A. 6. me përshkrim “Lodra për fëmijë”, kostatimi juaj është si më poshtë: ju sqarojmë se ky zë pune është kryer tërësisht nga sipërmarrësi dhe me kolaudimin e punimeve objekti i është dorëzuar investitorit për shfrytëzim nga ky moment mbikqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve nuk janë përgjegjës për ruajtjen e objektit nga dëmtimet. Në lidhje me këtë sqarim tonin ju theksojmë se ky zë pune është kryer tërësisht dhe janë ndërtuar 3 lodra për fëmijë në objekt dhe më poshtë po ju bashkëngjisim edhe foto të këtyre lodrave të vendosura në objekt .

Opinion i grupit të auditimit:

5. Përsa i përket zërit të punimeve “Lodra për fëmijë”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë pjesërisht. Pasi në fotot e paraqitura konstatohen vetëm 2 (dy) “Lodra për fëmijë” nga tre që janë likuajduar sipas situacionit përfundimtar dhe vlera prej 100,000 lekë do të pasqyrohet në vlerën e dëmit ekonomik

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 17, datë 29.05.2020, si dhe në Projekt Raportin Nr.262/4 Prot. e datë 8.06.2020.

Vlera prej 100,0000 lekë pa Tvsh, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z. E. M. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
- 2) “G. L. C.” përfaqësuar nga Z. G. S. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **611,500 lekë pa TVSH.**

Titulli i Gjetjes 49	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve te rekreacionit në fshatin Samaticë” në Bashkinë Ura Vajgurore, nga zbatimi i punimeve BOE “T.” & “E. K.” Shpk, për 5 zëra pune.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Shtrese dërrasa FM 4.0 cm për stola”, “F V. Mbjellje pemë dekorative Bli janë 4 copë”, “Lodra për fëmijë”, “Kosha dekorative” dhe “F V Puset b/a shiu 40/40 h=100 cm Grile gize”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: -Ligj nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” indryshuar, konkretisht Nenet 5, 8 e 24. Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, konkretisht Kreu I, Pikat 2, 5, 6, 7 e 8, Kreu II,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

	Pikat 17, 19, 20 etj, dhe Kreu III - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2420/16 Prot., datë 15.11.2017.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt ekonomik negativ në fondet e Bashkisë Ura Vajguore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e Autoritetit Kontraktor në verifikimin i gjendjes dhe marrjen e masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajguore të merren masa për shqyrtimin e vlerës prej 611.500 lekë pa Tvsh që është vlera e zërave të punimeve të realizuara nga BOE “T.” & “E. K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 24/20 Prot datë 15.11.2017 me “Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjenteve të Rekreacionit në fshatin Stamaticë”, Bashkia Ura Vajguore, vlerë kjo e cila përfaqëson efekt ekonomik negativ buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e dëmtimit të punimeve të kryera e të dëmtuara. AK duhet dokumentojë keqpërdorimin e këtyre aktiveve, evidentimin e përgjegjësive dhe të marr masat e nevojshme për menaxhimin me efektivitet të aktiveve.

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për të gjitha procedurat e audituara për vitin 2018.

Lidhur me objektin e mësipërm, është observuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve “A. M.” Shpk, Kolaudatori “G. L. K.” Shpk dhe Sipërmarrësi i punimeve “T.” Shpk. Bashkëlidhur observacionit dhe fotografi të objektit. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

1. Për këtë konstatim tuaj në kapitullin D. Paisjet elektrike, në Zërin e punimeve me numër rendor 3 me përshkrimin “F.V Ndricues teke zingato e lyer, h=3.5ml”, ju sqarojmë se ky zë pune është kryer tërësisht nga sipërmarrësi dhe me kolaudimin e punimeve objekti i është dorëzuar investitorit për shfrytëzim nga ky moment mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi nuk janë përgjegjës për ruajtjen e objektit nga dëmtimet.

Në mbështetje të sqarimit tonë më poshtë po ju bashkëngjisim dhe foto të këtyre ndriçusave të vendosur.

Opinion i grupit të auditimit:

1. Përsa i përket zërit të punimeve “Shtrese derrasa FM 4.0cm per stola”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik

2. Përsa i përket zërit të punimeve , “Mbjellje pemë dekorative Blin)”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik

3. Përsa i përket zërit të punimeve “Lodra për fëmijë”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik

4. Përsa i përket zërit të punimeve “Kosha dekorative”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik

5. Përsa i përket zërit të punimeve “F V Puset b/a shiu 40/40 h=100 cm Grile gize”, argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik

Argumentet e sipërcituara qëndrojnë, por në dokumentacionin e paraqitur nga Bashkia Ura Vajguore gjatë auditimit, nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me kohën e konstatimit të humbjes/eliminimit/dëmtimit e investimit në objektin: "Rikualifikim urban dhe krijimi i ambjenteve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

te rekreacionit ne fshatin Stamicë"

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 17, datë 29.05.2020, si dhe në Projekt Raportin Nr.262/4 Prot. e datë 8.06.2020.

Vlera prej 611,500 lekë pa Tvsh, e cila përfaqëson vlerën ekonomike për furnizimin dhe vendosjes e pajisjeve të kryera por që nuk ekzistojnë në fakt, konsiderohet si efekt ekonomik negativ, shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z. E. M. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes “A. M.” Shpk;

Z. G. S. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara “G. L.” Shpk;

5-“Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”

Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”.		
Lidhja e kontratës Nr. 1541/12 Pprot datë 18.09.2017	Vlera e kontratës 150,008,367.60 lekë me Tvsh BOE fitues “L. K.” & “T.” Shpk	Likuiduar: Situacioni përfundimtar 149,886,618 lekë me TVSH
Situacioni Përfundimtar -Vlera 149,886,618 lekë me Tvsh	Afati i kontratës në dite Parashikuar 12 muaj. Fillimi punimeve: 18.09.2017 Përfundimi punimeve : 18.09.2018	Zgjatja e kontratës S’ka
Mbikëqyrësi i punimeve OE “A.” Shpk	Licenca Nr: MK. 2892	Kontrata nr. 1907/14 prot, datë 18.09.2017
Kolaudatori i punimeve L. N.	Licenca Nr: MK 0230/3	Kontrata me nr. 2172/2 prot., datë 18.10.2018
Akt Kolaudimi Datë 11.10.2017	Akt i marrjes në dorëzim dt 15.11.2018	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **585,703 lekë pa Tvsh.**

Titulli i Gjetjes 50	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”, nga zbatuesi i punimeve BOE “L. K.” & “T.” SHPK, për 28 zëra pune në 9 segmente rrugorë.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Transport dheu me makineri 5 km”, “Gërmim dheu me esk. gom. 0.25m3 ne kanale me gjer.>2m tok. zak kat.III shkar në mjet”, “FV tabela të ndryshme rrugore D=60cm”, etj., për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1541/12 Pprot datë 18.09.2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	<ul style="list-style-type: none">- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1907/14 prot, datë 18.09.2017.- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2172/2 prot., datë 18.10.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 585,703 lekë pa Tvsh nga BOE “L. K.” & “T.” SHPK , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1541/12 Pprot datë 18.09.2017 me “Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për të gjitha procedurat e audituara për vitin 2018.

Lidhur me objektin e mësipërm, është observuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve “A. M.”, Shpk dhe Sipërmarrësi i punimeve “T.” Shpk. Bashkëlidhur observacionit dhe fotografi të objektit. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

1. Përsa i përket zërit të punimeve në Objektin 1: "Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Allambrez", Ura Vajgurore. Zëri 1 (3.89/b) Gërmim dheu me esk. gom. 0.25m³ në kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar në mjet

1/1. Përsa i përket zërit të punimeve “Transport dheu me makineri 5 km”

2. Përsa i përket zërit të punimeve në Objektin: "Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Gurabardh 2", Ura Vajgurore. Zëri 1 (3.89/b) Gërmim dheu me esk. gom. 0.25 m³ në kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar në mjet

2/1. Përsa i përket zërit të punimeve “Transport dheu me makineri 5 km”

3. Përsa i përket zërit të punimeve në Objektin "Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Krotine" Ura Vajgurore. Zëri 1 (3.89/b) Gërmim dheu me esk. gom. 0.25m³ në kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar në mjet

3/1. Përsa i përket zërit të punimeve “Transport dheu me makineri 5 km”

4. Përsa i përket zërit të punimeve në Objektin: "Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Polizhan", Ura Vajgurore. Zëri 1 (3.89/b) Gërmim dheu me esk. gom. 0.25m³ në kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar në mjet

4/1. Përsa i përket zërit të punimeve “Transport dheu me makineri 5 km”

5. Përsa i përket zërit të punimeve në Objektin: "Rikonstruksioni i rrugës së fshatit SMT- Hajdaraj" Ura Vajgurore. Zëri 1 (3.89/b) Gërmim dheu me esk. gom. 0.25m³ në kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar në mjet

Pë këtë konstatim....., ju sqarojmë se ky zë është kryer dhe është realizuar sipas matjeve të pasqyruara në librezën e masave që gjendet në dosjen e objektit, të dorëzuar pranë investitorit dhe hamëndësimet tuaja për mënyrën e realizimit të këtij zëri nuk janë reale pasi vëllimi i gërmimit të llogaritur në këtë zë është për pjesën e skrapatës e llogaritur deri në kuotën për ndërtimin e trupit të rrugës, e pas kësaj më tej janë llogaritur edhe volumet për hapjen e kanalit të rrugës rrugës që është që është me kuotë nën trupin e rrugës që mbushet me shtresën e çakullit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Në mbështetje të të sqarimit tonë më poshtë po ju bashkangjism dhe foto të kryera në objekt (kjo përgjigje është për të gjitha rastet e përmendura për zërat e punimeve të sipërcituara).

Opinion i grupit të auditimit: Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë ligjërisht dhe teknikisht, nga ana juaj nuk janë paraqitur fakte të mbështetura ligjërisht por opinione/këndëvështrime të cilat nuk merren parasysh.

Së pari: Për zërin e punimit “Gërmim dheu me esk..” nuk keni paraqitur asnjë foto të kryer në objekt për të mbështetur pretendimin tuaj, siç shpreheni në paragrafin e fundit.

Së dyti: Zëri i punimeve “Gërmim dheu me esk. gom. 0.25m³ në kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar në mjet” nuk ka asnjë lidhje me zërin e punimev “Gërmim dheu për zgjerim rruge” të aplikuar nga ju, nuk ka lidhje me zërin e punimeve të prokuruar, projektuar e përlllogaritur. Kjo mjafton për të kuptuar që volumit të punimeve të zërit të punimeve “Gërmim dheu me esk. gom. 0.25m³ në kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar në mjet” nuk i shtohen gërmimet në trupin e rrugës.

Rasti i Objekti 1: "Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Allambrez", Ura Vajgurore., për zërin e punimeve “Gërmim dheu me esk. gom. 0.25m³ në kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar në mjet”, është rast ideal për tu kuptuar (jo hamendësuar) përlllogaritjen e volumeve të punimeve të realizuara.

Pra kur trupi i rrugës, në të gjithë gjatësinë e saj është e gjerë mesatarisht 4m, dhe në gjithë gjatësinë e saj është prishur shtresa e çakëlit t=15 cm, gjerësia mesatare e rrugës së re është gjithashtu mesatarisht 4m

Kuptohet që po nuk pati “Gërmim dheu me esk. gom. 0.25m³ në kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar në mjet”- në trupin e rrugës, nuk ka transport dheu.

Në lidhje me zërat e punimeve: a) Tabela tetëkëndore e vogël me A-B, 60-20 (e kompletuar), e b) Tabela të ndryshme rrugore D=60cm, ju shpreheni: ju sqarojmë se ky zë pune është kryer tërësisht nga sipërmarrësi dhe me kolaudimin e punimeve objekti i është dorëzuar investitorit për shfrytëzim nga ky moment mbikqyrësi i punimeve dhe sipërmarrësi i punimeve nuk janë përgjegjës për ruajtjen e objektit nga ndërtime.

Në mbështetje të të sqarimit tonë më poshtë po ju bashkangjism dhe foto të këtyre tabelave të vendosura në objekt.

Opinion i grupit të auditimit: Gjatë vëzhgimit në terren nuk u konstatua asnjë tabelë, kollon table apo bazament. Fotot e vendosjeve të tabelave, nuk gjenden në dosjen e zbatimit të punimeve, nuk paraqesin kohën dhe vendin e realizimit të tyre. Nga takimi me Ju dhe z. A. P. në terren asnjëherë nuk u habitët që nuk kishte asnjë tabelë e nuk u përmend vendosja dhe dorëzimi tek investitori për shfrytëzim, por u ra dakort që do të vendoseshin.

Në lidhje me objektet: “Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Krotine”, “Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Polizhan”, “Rikonstruksioni i rrugës së fshatit SMT- Hajdaraj”, për zërat e punimeve:

“Gërmim dheu me esk. gom. 0.25m³ në kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar në mjet” dhe “Transport dheu me makineri 5 km”, observacioni merret në konsideratë dhe vlerat ekonomike pasqyrohet në Raportin Përfundimtar

Vlera prej 585,703 lekë pa Tvsh, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z. E. M. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

Z. L. N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

6- “Ndërhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga Stacioni pompave Poshnje”, Bashkia Ura Vajgurore

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga Stacioni pompave Poshnje”

14.Lidhja e kontratës Nr. 1130/11 prot datë 05.07.2017	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 97,605,241 lekë +. Shtesa 19,454,899 lekë	16. Likuiduar
--	--	----------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	BOE fitues “B.” & “Sh.” SHPK	
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me tvsh 117,060,140 lekë Kontrata Bazë 97,605,241 lekë Shtesa e Kontra. 19,454,899 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 120 ditë, Zbatuar 253 ditë. Fillimi punimeve: 17.08.2017 Rifillimi punimeve: 23.10.2017 Përfundimi punimeve : 30.04.2018	19. Zgjatja e kontratës Pa nr. Prot, datë 25.04.2017, 180 ditë
20. Mbikëqyrësi i punimeve “H.S. 11” shpk	Licenca Nr: MK 2018/12	Kont. nr. 1279/7, datë 05.07.2016 2,233,693 lekë
21. Kolaudatori i punimeve “G. L.” Shpk L. H.	Licenca Nr: MK 0992/2,	Kont. nr. 13/6 datë 27.06.2018 217,200 lekë
22. Akt Kolaudimi Datë 11.07.2018	23. Akt i marrjes në dorëzim datë 12.07.2018	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **43,800 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 51	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ndërhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga Stacioni pompave Poshnje”, Bashkia Ura Vajgurore, nga zbatuesi i punimeve BOE fitues “B.” & “Sh.” SHPK, për zërin e punimeve III.16.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërin e punës “Shtresë me llaç çimento 1:2, dyshemeja”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1130/11 prot datë 05.07.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1279/7, datë 05.07.2016. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 13/6 datë 27.06.2018.
Ndikimi/Efekt:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 43,800 lekë pa tvsh nga BOE fitues “B.” & “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1130/11 prot datë 05.07.2017 me “Ndërhyrje emergjente për furnizimin me ujë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajguore.

Urës Vajguore nga Stacioni pompave Poshnje”, *Bashkia Ura Vajguore*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Vlera prej 43,800 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajguore. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z. F. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
- 2) Z. L. H. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Komente të paraqitura nga subjekti me shkresën nr.1300/18, datë 12.06.2020 e prot., në KLSH me nr. 262/6, datë 13.06.2020 për të gjitha procedurat e audituara për vitin 2018.

I.Linja e furnizimit Zëri I.1: (Gërmim shkëmbi mesatar me cekic me eskavator me zinxhir) Lidhur me zërin e mësipërm ku nga rillogaritjet pretendohet një diferencë volumesh prej 243m³ me një vlerë prej 243 000 leke, ku është cituar se profili terthor për llogaritjen e volumeve duhej marrë si drejtkëndesh, dhe jo trapez kemi: Referuar detajit të kanalit të projektit të rishikuar të miratuar, si dhe nga matjet faktike në terren rezultoi se baza e sipërme e kanalit është 1.5m po aq sa është raportuar dhe në librezën e masave. Theksojmë se detaji i kanalit të realizuar në terren është në formë trapezi, dhe shmangia e gërmimit në bazën e sipërme nga baza e poshtme, është vetëm 20cm në të dy anët e kanalit, pra baza e sipërme është: $(1.10 + (2 \times 0.20)) = 1.50\text{m}$ aq sa është realizuar në fakt. Bashkangjitur po ju dërgojmë detajin e vizatimit të kanalit nga P1+2m ÷ P34 dhe fotot e realizuara gjatë zbatimit të punimeve.

III.Ndertim rezervuari + pusi i shuarjes së energjisë Zëri III.1: (Gërmim shkëmbi I forte me cekic me eskavator me zinxhir) Lidhur me zërin e mësipërm ku nga rillogaritjet pretendohet për një diferencë volumesh prej 157m³ me një vlerë prej 157 000 leke, ku është cituar se profili terthor për llogaritjen e volumeve të gërmimit është marrë si tokë e zakonshme dhe jo si shkëmb i forte po argumentojmë si mëposhte: Theksojmë se volumet në këto punë janë librezuar sipas vizatimeve përkatëse dhe sipas gjendjes faktike të realizuar në projekt. Bashkangjitur po ju dërgojmë foto të punimeve të maskuara gjatë realizimit të punimeve ku shihet qartë kundi i skarpatës.

III.Ndertim rezervuari + pusi i shuarjes së energjisë Zëri III.16: (Shtresë me llacimento 1 : 2, dyshemeja) Lidhur me zërin e mësipërm ku nga rillogaritjet pretendohet për një diferencë volumesh prej 43.8m³ me një vlerë prej 43 800 leke, po paraqesim argumentin tonë si mëposhte: Ky punë është realizuar në fakt në soletën e depozitës mbi shtresën e hidroizolimit, sipas detajit të projektit dhe jo në dyshemene të saj. Ndërsa në preventiv ky punë, gabimisht është parashikuar në dyshemë. Dmth ka një mospërputhje të projektit të preventivin, dhe firma sipërmarrëse është bazuar në detajin e projektit. Referuar detajit të projektit shtresat e soletës janë: 1) Shtresë b/a t=20cm, 2) Shtresë termoizoluese t=8cm, 3) Shtresë niveluese 5cm, 4) Shtresë hidroizolimi 2kk, 5) Shtresë niveluese për mbrojtjen e izolimit. Për vërtetimin se ky proces punë është zbatuar në soletën e depozitës, bashkangjitur po ju paraqesim procesverbalet e përfundimit të të gjitha fazave të punimeve në soletë, konkretisht procesverbali që e vërteton këtë është procesverbali i datës 29.04.2017 (Mbi përfundimin e procesit të punës shtresë llacimento mbi hidroizolim).

Theksojmë se në fakt ky punë është realizuar në soletën e rezervuarit pas vendosjes së hidroizolimit, ashtu si është paraqitur dhe në librezën e masave. Pra permasat e llogaritjes së këtij zeri punë janë marrë me permasat e jashtme të rezervuarit.

Opinionit i grupit të auditimit:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

1. Përsa i përket zërit Zëri III.1: (Gërmim shkëmbi mesatar me cekic me eskavator me zinxhir), bashkëlidhur observacionit janë paraqitur fotot gjatë zbatimit të punimeve, të cilat tregojnë se gërmimet janë kryer me pjerrësinë e marrë në librezën e masave. Përsa sipër, ky argument merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik.

2. Përsa i përket zërit Zëri III.1: (Gërmim shkëmbi I forte me cekic me eskavator me zinxhir), bashkëlidhur observacionit janë paraqitur fotot gjatë zbatimit të punimeve, të cilat tregojnë se gërmimet janë kryer me pjerrësinë e marrë në librezën e masave. Përsa sipër, ky argument merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik.

2. Përsa i përket zërit III.16: (Shtrese me llac cemento 1 : 2, dyshemeja), sqarojmë se diferenca e evidentuar nga ana jonë, nuk është për soletën, por për dyshemenë e rezervuarit. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Shënim: Në rubrikën “Masa për shpërblim dëmi”, nuk do të evidentohet dëmi ekonomik i mbetur prej 43,800 lekë, pasi kjo vlerë nuk është materiale.

7. “Sistemim i rrugës së tregjeve (Loti 1)”, Bashkia Ura Vajgurore

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim i rrugës së tregjeve (Loti 1)”, Bashkia Ura Vajgurore		
14.Lidhja e kontratës Nr. 983/1 Prot, datë 18.04.2017	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 70,906,936 lekë OE fitues “S.”SHPK	16.Likuiduar -----
17- Situacioni Përfundimtar - Vlera me tvsh 70,906,936 lekë -Vlera pa tvsh 59,089,113 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 135 ditë. Fillimi punimeve: 18.04.2017 Perfundimi punimeve : 01.09.2017	19. Zgjatja e kontratës 45 ditë (sipas relacionit përfundimtar të mbikëqyrësit),
20. Mbikëqyrësi i punimeve “V. I.” SHPK	Licenca Nr: MK 1554/6	Kontrata nr. 8/8, datë 09.02.2017
21. Kolaudatori i punimeve OE “H.S. 11” SHPK	Licenca Nr: MK 2018/12	Kontrata nr. 57/9 prot., datë 05.10.2017
22.Akt Kolaudimi Datë 12.10.2017	23.Akt i marrjes në dorëzim dt. 16.10.2017	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,593,206 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 52	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikualifikimi urban i sheshit Livadhja”, Bashkia Ura Vajgurore, nga zbatuesi i punimeve OE “S.” SHPK, për zërin e punimeve I.13, I.14, I.28, III.6, III.8 dhe IV.8
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punimeve “Beton C16/20 për kunetë”, “Trotuar 6 cm beton me pllaka”, “Puseta betoni me kapak gize 40 x 40 cm, çmimi”, “Shtresë binderi t=5cm”, “Shtresë çakull gurore për bankinat t=10 cm” dhe “Shtresë çakull gurore për bankinat t=10 cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 983/1 Prot, datë 18.04.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 8/8, datë 09.02.2017. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 57/9 prot., datë 05.10.2017.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,593,206 lekë pa tvsh nga OE “S.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 983/1 Prot, datë 18.04.2017 me “Rikualifikimi urban i sheshit Livadhja”, <i>Bashkia Ura Vajgurore</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Vlera prej 1,593,206 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z. B. S. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes
- 2) Z. F. B. në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

8. “Kanali ujitës BRU – 15 Manastir dhe ushqyesi i rezervuarit”, Bashkia Ura Vajgurore **Zbatimi i punimeve**

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Kanali ujitës BRU – 15 Manastir dhe ushqyesi i rezervuarit”		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1827/22 prot., datë 30.09.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 22,659,480 lekë BOE fitues “F.” & “Sh.” SHPK	16. Likuiduar
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me tvsh 22,657,980 lekë Pa tvsh 18,881,650 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 150 ditë, Zbatuar 150 ditë. Fillimi punimeve: 14.10.2019 Përfundimi punimeve : 13.03.2020	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve “S. S.” shpk	Licenca Nr: MK 2992/8	Kont. nr. 27 prot., datë 01.10.2019

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **326,000 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 53	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ndërrhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga Stacioni pompave Poshnje”, Bashkia Ura Vajgurore, nga zbatuesi i punimeve BOE
---------------------------------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

	fitues “F.” & “Sh.” SHPK, për zërin e punimeve 12.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërin e punës “Ndërtim mur gabioni me rrjet xingato”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1827/22 prot., datë 30.09.2019. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 27 prot., datë 01.10.2019.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 326,000 lekë pa tvsh nga BOE fitues “F.” & “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1827/22 prot., datë 30.09.2019 me “Kanali ujitës BRU – 15 Manastir dhe ushqyesi i rezervuarit”, <i>Bashkia Ura Vajgurore</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Vlera prej 326,000 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Ura Vajgurore. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. K. S. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

A. OPINIONI I AUDITIMIT.

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Bashkisë Ura Vajgurore.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Ura Vajgurore për vitin ushtrimor 2019, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës, pasqyrat e ndryshimeve në kapital, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni i kualifikuar⁵ për pasqyrat financiare të vitit 2018 dhe 2019:

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 dhe ISSAI 1200 shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të Bashkisë Ura Vajgurore, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në periudhën nën auditim dhe mbi të gjitha, janë të korrigjueshme. Në opinionin tim, Pasqyrat Financiare të Bashkisë Ura Vajgurore, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në 31 Dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe fluksin e parasë për vitet respektive në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

Baza për opinionin e Kualifikuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardevë janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 705-ISSAI 1705)

Ne i tërheqim vëmendjen subjektit të audituar për çështjet e theksuara më poshtë, të cilat nuk janë thelbësore dhe me ndikim në pasqyrat financiare; Për këto arsye kemi dhënë opinion të pamodifikuar/pakualifikuar me theksim çështjeje, sipas shpjegimeve në Raportin përfundimtar të auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Ura Vajgurore.

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Ura Vajgurore, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me

⁵ Një opinion i kualifikuar (i modifikuar) jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura. Kur gabimet janë materiale por jo të përhapura, audituesi paraqet një opinion të kualifikuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II- Opinion mbi përputhshmërinë.

Për drejtimin e Bashkisë Ura Vajgurore.

Ne kemi audituar përputhshmërinë⁶ e subjektit përse i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në kryerjen e procedurave të prokurimit publik.

Auditimi ka përfshirë:

- ekzaminimin e zbatimit të procedurave të prokurimit në masën 97.4% të fondit limit, në bazë testimesh, bazuar në dokumentacionin mbi procedurat e prokurimit të ndodhura në dosjet përkatëse, si dhe dokumentacionin e ngarkuar në SPE, për vitet 2017 -2019;

- ekzaminimin e dokumentacionit të zbatimit të kontratave për punë civile në 8 raste për vitet 2017 – 2019;

- Zbatimin e buxhetit dhe të ardhurat;

- Menaxhimin financiar dhe kontrollin

Opinion i modifikuar me rezervë⁷.

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinionin me rezervë”, procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit ushtrimor 2017, 2018, 2019 në 19 raste nuk janë kryer në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, dokumentet standarde të tenderit (DST), si dhe akte të tjera nënligjore, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për kryerjen e procedurave dhe që kanë shërbyer si kritere vlerësimi.

Baza për opinion me rezervë:

⁶ Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

⁷ Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; Kapitulli V “Raportimi i auditimit”, pika 5.4 “Konkluzionet/opinionin në auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI/2019 “framework of Professional Pronouncements” (IFPP), ISSAI 400 “Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë” dhe ISSAI 4000 “Standardet e auditimit të përputhshmërisë”, Kapitulli 9 “Raportimi”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, konkretisht:

- Në administrimin e shpenzimeve operative, nuk është arritur eficaenca dhe efikasiteti i procedurave të prokurimit, duke mos përmbushur kështu, qëllimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, veprime me paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në fushën e prokurimit në vlerën **344,972 mijë lekë**, etj.

Për këto u analizuan 38 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 625,492 mijë lekë ose 97.4 % të fondit limit të prokuruar për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019.

- Në fushën e zbatimit të kontratave për punë civile, shërbime e mallra si dhe mungesës së lidhjes së kontratave me subjektet e shfrytëzimit të guroreve, janë konstatuar parregullsi për vlerën e dëmit ekonomik prej **42,161 mijë lekë**, si rezultat i mos përfundim në afat të punimeve dhe mangësive të konstatuara në zbatimin e punimeve jo sipas projekt preventivin të punimeve.

- Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjare, nuk është ndjekur e plotë procedura në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 28.5.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshime dhe Vendimeve respektive të Këshillit Bashkiak, për arkëtimin e vlerës **223,115 mijë lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Ura Vajgurore. Borxhi tatimor i konstatuar është në vlerën **23,615 mijë lekë**.

- Detyrimet për 6 vendime gjyqësore janë në vlerën **18,652 mijë lekë** (nga të cilat 5 për largime nga puna dhe një penalitet).

- Mos zbatimi i rekomandimeve nga auditimet e kaluara, duke vlerësuar se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e tyre, kryesisht për vlerën e shpërblimit të dëmit prej **6,671 mijë lekë**.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Ura Vajgurore:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Ura Vajgurore, janë përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, minimizimin e kostove dhe shmangien e gabimeve apo mashtrimeve. Stafii drejtues, është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit). Stafii drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor “Bashkia Ura Vajgurore”, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e procedurave të prokurimit publik të periudhës objekt auditimi, duke i përshkruar në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

B. MASAT ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për të vlerësuar funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, grupi i auditimit testoi *komponentët vlerësues të funksionimit të kontrollit të brendshëm*, nga të cilat rezultoi;

-Mjedisi i kontrollit. Strukturat e Bashkisë, funksionojnë sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, por nuk është miratuar kodi i etikës profesionale.

Nga ana e Titullarit të Bashkisë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit. Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit. Lëvizjet e punonjësve për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, vlerësohet me risk përse i përket shkallës së kualifikimit të tyre, veprime në kundërshtim me UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19, neni 16 pika 2 dhe neni 22.

-Menaxhimi i riskut. Lidhur me identifikimin e aktiviteteve më risk, hapjen e regjistrit të riskut si dhe menaxhimin e tij, është caktuar koordinatori i riskut në kundërshtim me kërkesat e nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

Nuk është miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk janë identifikuar aktivitete me risk, si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij.

-Veprimtaritë e kontrollit. Në këtë Bashki, është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), por nuk janë miratuar Planet e Zhvillimit Strategjik dhe planet buxhetore afat mesëm, në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010; ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF nr. 8 dt. 29.3.2012 “Procedura e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.

-Informacioni dhe komunikimi. Realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010.

-Monitorimi. Në monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatuan se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore, konkretisht janë konstatuar raste ku marrja në dorëzim e punimeve të kontraktuara ose furnizimi me materiale sipas kontratave, nuk janë bërë me komisione të ngritura për këtë qëllim. Këto raste janë shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar Kap. III, pikat 42, 47 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (IV/A.1), faqe 12-13 të Raport Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos funksionimit të aktivitetit të GMS-së, duke nxjerrë përgjegjësitë më qëllim që GMS-ja të kryejë funksionet e veta ligjore.

1.2 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajgurore, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, të hartojë regjistrin e riskut e në mënyrë periodik, si dhe të hartohet rregullore për kodin e etikës përfshirë hartimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm rezultoi se: nuk është bërë i mundur realizimi i kontrolleve për verifikimin e detyrave të lënë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

nga misionet e auditimit të kryera, pikë e cila nuk rezulton të jetë dhe në programet e auditimit të subjekteve të ri kontrolluara, duke bërë që si nga NJAB ashtu dhe Menaxheri i Njësisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera, në kundërshtim me ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”; Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;

(trajtuar me hollësisht në faqe 13 -14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm, në përfundim të procesit të auditimit në njësitë e audituara, të kryhej monitorimin e zbatimit rekomandimeve i cili kërkon që në zbatim rekomandimeve, Drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit sipas Manualit Auditit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm në mënyrë të përmbledhur rezulton si më poshtë:

a. Me shkresën nr. 259/19, datë 06/07/2017, nga ana e KLSH janë rekomanduar 20 masa organizative nga të cilat janë zbatuar 17 masa, janë në proces zbatimi 3 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë ajo me nr. 20 për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në vitin 2014.

b. Janë rekomanduar 9 masa për shpërblim dëmi nga të cilat për 6 masa (masa nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6) në shumën 6,619,712 lekë subjekti është në procese gjyqësore.

c. Janë rekomanduar APP masa administrative për 11 raste, me shkresën nr. 259/29, datë 07.12.2017 sipas Vendimit nr. 88, datë 05.12.2017 të APP për 1 masë disiplinore dhe 9 masa me gjobë në shumën 680,000 lekë të cilat ri kërkohen për zbatim.

d. Masa administrative në bazë të Vendimit të APP nr. 88, datë 05.12.2017 në shumën 680,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” (trajtuar me hollësisht në faqe 14 -16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Ura Vajgurore të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr.259/19, datë 06/07/2017 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Ura Vajgurore”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për ri zbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

-3 masa organizative të cilat janë në proces zbatimi.

-9 masa për shpërblim dëmi në shumën 6,670,752 lekë nga të cilat për 6 masa (masa nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6) në shumën 6,619,712 lekë subjekti është në procese gjyqësore dhe 1 është në proces.

- Masa administrative të rekomanduara APP, për 11 raste, e cila me shkresën nr. 259/29, datë 07.12.2017 sipas Vendimit nr. 88, datë 05.12.2017 ka dhënë 1 masë disiplinore dhe 9 masa me gjobë në shumën 680,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitet 2017, 2018 dhe 2019, u konstatua se:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Buxheti për vitin 2017 - 2019 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me detyrimet e papaguara, të cilat janë në nivel të lartë, ku vlera totale e detyrimeve të mbartura në vitin 2017 është në shumën 237,447,614 lekë, për vitin 2018 – 258,661,743 lekë dhe në vitin 2019 në shumën 190,564,044 lekë

Në lidhje me detyrimet e pashlyera (467) vlera e detyrimeve të pashlyera është: viti 2017 në shumën 179,212,543 lekë, viti 2018 në shumën 234,762,573 lekë dhe viti 2019 në shumën 173,548, 411 lekë. Ndërkohë të ardhurat për vitin 2017 janë realizuar në masën 50%, për vitin 2018 në masën 62% dhe për vitin 2019 – 53.7%, tregues që tregojnë për një planifikim të të ardhurave mbi një bazë jo reale. Fondet buxhetore të këtyre viteve paraqiten me nivel realizimi për vitin 2017 në masën 87 % dhe për vitin 2018 në masën 86% dhe për vitin 2019 në masën 82.9%. Në këtë nivel realizimi ka ndikuar realizimi në nivel më të ulët i shpenzimeve operative për vitin 2017 në masën 67%, për vitin 2018 në masën 73%, dhe 2019 në masën 63.7%. Po kështu dhe investimet për vitin 2017 në masën 85%, për vitin 2018 në masën 73% dhe 2019 në masën 82.9%. (trajtuar me hollësisht në faqe 16 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi:

a-Me qëllim që të mos krijohen diferenca të theksuara ndërmjet programimit dhe realizimit të treguesve të buxhetit, njësia publike Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa për hartimin sa më real të treguesve të buxhetimit, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Njëkohësisht në çdo periudhë buxhetore të hartohet (PBA) dhe buxhetit vjetor të ndjek parashikimin e vitit të parë të PBA.

b-Titullari i njësisë vendore dhe Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masa të plota për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 190,564,044 lekë, dhe të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkisë, informacion për gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe të mbartura dhe të hartojë grafik për shlyerje të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Bashkia Ura Vajgurore, për vitin 2019 ka 5 raste detyrime përmbarimore për detyrim pagesë për largim nga puna me vlerë **3,311,948** dhe në 1 rast për pagesë të vonuar për një kompani, kamat vonesa me vlerë **16,640,021** lekë. Në vitin 2019 janë likuiduar **1,300,000** lekë për detyrime përmbarimore për pagesë për largim nga puna. Në datë 31.12.2019 detyrimi për vendime gjyqësore është në vlerën **18,651,969** lekë. Për këto procese gjyqësore të humbura, Bashkia Ura Vajgurore nuk ka analizuar shkaqet e lindjes së tyre dhe nuk ka marrë masa ndaj personave përgjegjës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 62 dhe 102, me Udhëzimin nr.2, datë 09.01.2015, “Vendimet gjyqësore” pika 6.1, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar neni 12 pikën 3.

(trajtuar me hollësisht në faqe 16 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Bashkia Ura Vajgurore, të nxjerrë përgjegjësitë ligjore e administrative ndaj personave shkaktarë të cilët kanë krijuar detyrimin prej **18,651,969 lekë** për 6 vendimet gjyqësore çka ka ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit si dhe të marrë masa për planifikimin e fondeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Ura Vajgurore ushtrojnë aktivitetet për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore 17 subjekte për sipërfaqe 35 ha, është lidhur 1 kontratë qiraje për sipërfaqe 16.2 ha. Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit, nuk



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullosor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” (trajtuar me hollësisht në faqe 21 -37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Sektori i pyjeve dhe mbrojtjes mjedisit në Bashkinë Ura Vajgurore, t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i disa artikujve dhe rakordimi me magazinën, u konstatuan probleme me marrjen në dorëzim të mallrave të blera, konkretisht për artikujt që përdoren në ndërtim, si p.sh. çimento, hekur, stabilizant, çakëll, granil, etj., nuk është zhvilluar në rregull procedura për pagesat, marrjen në dorëzim dhe magazinimin e këtyre artikujve, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ” kap III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” pikat 34 deri 44. Nga verifikimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, u konstatua se procesverbalet e marrjes në dorëzim janë bërë në mënyrë fiktive, pasi fletët e hyrjes mbajnë data duke filluar nga 04.07.2017, deri në 29.12.2017. Ndërkohë, pavarësisht mënyrës së hartimit të procesverbaleve, fletë hyrjet korrespondojnë me fletë daljet, si në sasi edhe në kohë. E njëjta procedurë ka ndodhur për të tre vitet e audituara, për artikuj të ndryshëm, kryesisht në lidhje me ndërtimin.

7/1 Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore, të merren masa nga Nëpunësi Autorizues i cili duhet të përcaktojë kushtet e duhura kontraktuale, ku të mundësohet ruajtja e mallrave të blera në ambientet e furnitorit dhe lëvrimi i tyre sipas nevojës së institucionit, njëkohësisht duke bërë pagesën në momentin e lëvrimit të mallrave, si dhe të marrë masa për të zgjeruar ambientet e magazinimit të mallrave, përfshirë edhe kushtet e magazinimit. Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për të përcaktuar kushtet e lëvrimit të mallit, magazinimin e tij dhe në rastet e blerjes së mallrave të bëjë pagesën sipas sasive që nevojiten dhe kur nevojiten.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me konsumin e karburantit dhe vlerësimin e kontabilizimit e mirëmbajtjes së aktiveve:

4. Nuk disponohej një plan shpërndarjeje, për çdo mjet transporti, makineri apo kaldajë, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 38 dhe 59.

5. Në asnjë rast nuk ishte kryer rakordimi i fletudhëtimeve me leximin e kilometrazhit apo orëve të punës të çdo mjeti.

6. Nuk disponohej në të gjitha rastet autorizimi, i shoqëruar me një program pune të miratuar nga titullari i institucionit, për lëvizjet e punonjësve apo makinerive, sipas kërkesave



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

të Ligjit nr. 10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe Nëpunësit civilë”, neni 2 “Kategoritë e përfituesve”, pika 5.

(trajtuar me hollësisht në faqe 37 -53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8/1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Ura Vajgurore të marrë masa, që në çdo rast, automjetet dhe makineritë e institucionit të lëvizin për shërbime vetëm me autorizim apo urdhër të tij, sipas një programi të miratuar prej tij.

8/2 Rekomandim: Nëpunësi Zbatues të marrë masa për të rakorduar furnizimet e mallrave me pagesat, për të rakorduar çdo muaj konsumin e karburantit në fletët e udhëtimit me leximet e kilometrave të përshkuara nga automjetet apo orëve të punës së makinerive/pajisjeve.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e aktiveve (kanaleve ujitëse, kulluese, etj.), nuk ishin shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës.

9/1 Rekomandim: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për të inventarizuar, kontabilizuar dhe pasqyruar saktë vlerat e kostos historike të aseteve, duke llogaritur plotësisht shpenzimet e bëra për mirëmbajtjen, rikonstruksionin apo modifikimet/ndryshimet e tyre.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi Për vitin 2019, në llogarinë 4342 ka një diferencë/mangësi prej 4,995,915 lekësh, (referuar Tabelës PF13), e cila duke pasur parasysh se Llogaria 4342 është llogari rregulluese, tregon se në hartimin e bilancit e vitit 2019 nuk janë marrë në konsideratë përcaktimet e UMF nr. 8, datë 09.03.2018.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” duhet të ketë kundër parti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe të evidentohen veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Pra edhe faturat e gjendura nga data baza e thesarit për faturat e vitit 2018, të cilat janë likuiduar në vitin 2019, apo të vitit 2017, të cilat janë likuiduar në vitin 2018 ose nuk janë likuiduar ende, janë fatura që, për shkak të mungesës së fondeve, nuk janë likuiduar si dhe nuk janë paraqitur si detyrime në llogarinë kreditore 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe për të njëjtën arsye, nuk e gjejmë as në llogarinë debitore 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. Pra automatikisht kemi një nënvlerësim të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

10/1 Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore, të merren masa nga Nëpunësi Zbatues për të rakorduar llogarinë 4342 me llogaritë përkatëse të pasivit dhe për të regjistruar kontratat e lidhura në Llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Vlera historike totale e Llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në fund të vitit 2017 ka qenë 19,658,672 lekë, në fund të vitit 2018 ka qenë 28,097,072 lekë dhe në fund të vitit 2019 ka qenë 36,521,816 lekë. Sa më sipër, konkludohet se për këto asete njësia publike nuk ka përlllogaritur dhe kontabilizuar siç duhet normat e amortizimit sipas VKM-së nr. 401, datë 23.10.1989 dhe Kreut III, pika 3.7.2 “Normat e amortizimit sipas grupeve”, të UMF-së nr. 5, datë 30.01.2016 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, që përcakton se aktivet e patrupëzuara amortizohen me normën vjetore të amortizimit prej 15 % në vit dhe SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”. Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit, ndërkohë që objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është e gabuar.

Pavarësisht se një pjesë e projekteve dhe studimeve janë vënë në zbatim ose kanë përfunduar gjatë viteve të mëparshme dhe gjatë vitit ushtrimor 2019, nuk i janë shtuar kostos totale të objekteve, megjithëse vlerat respektive të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Ilogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” janë rritur në kontabilitet, në këto llogari nuk janë shtuar kostot e projekteve përkatëse, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për paraqitjen e pasqyrave financiare në NjQP*”, kapitulli III, pikat 33 e në vijim dhe aneksi I, pika 2 dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “*Për raportimin e pasqyrave financiare vjetore...*”, kapitulli IV.

11/1 Rekomandimi: Nga Bashkia Ura Vajgurore, të merren masa nga Nëpunësi Zbatues për të mbajtur të përditësuar regjistrin e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Llogaria 210 “*Toka, troje terrene*” gjatë periudhave të audituara (2017, 2018, 2019) e në vijim, ka pasur vlerën 0. Nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore nuk është bërë vlerësimi dhe regjistrimi në kontabilitet i aktiveve dhe më pas në ZVRPP/Kadastër, në kundërshtim me SKK 5 “*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*”. Për zërat e kësaj llogarie nuk është mbajtur regjistër aktivesh sipas përcaktimeve në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” pikat 26 deri 33. Gjithashtu, nuk ka asnjë dokumentacion të lëvizjes së aktiveve sipas pikave 34 deri 41 të udhëzimit dhe për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara dhe inventarizimin e tyre sipas pikave nga 42 deri 94 të këtij udhëzimi.

Llogaria 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”, njësoj si për Llogarinë 210 “*Toka, troje terrene*”, janë asete të transferuara me VKM të ish komunat dhe për shkak të mungesës së regjistrimit të aktiveve nuk paraqesin vlerën e vërtetë. Vlera e paraqitur në këtë llogari (3,641,232 lekë për vitin 2017, 4,280,832 lekë për vitin 2018 dhe 4,940,832 lekë për vitin 2019) është e gabuar, pasi nuk paraqet vlerën reale të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, por vlerën e inventarit të pemëve të mbjella në rrugë, lulishte, parqe, etj., me shtesat dhe pakësimet e veta, e cila duhet të shtohet në llogarinë përkatëse të çdo objekti, si pjesë e të cilit është krijuar.

Për llogarinë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”, për llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” dhe për llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri e paisje*”, në asnjë rast vlera e mirëmbajtjes nuk është kontabilizuar dhe nuk janë bërë rivlerësimet e aseteve, si dhe në listat e inventarit nuk janë llogaritur amortizimet, pra mbahen me vlerën historike, veprime që bien në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.3.2018, kapitulli II, pikat 17 e në vijim dhe kapitulli III, pika 33 e në vijim.

Për llogarinë 215 “*Mjete transporti*”, në fund të vitit 2017 gjendja në bilanc rezulton në vlerën 48,596,898 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 40,177,287 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 32,226,902 lekë. Kjo llogari 215 është mbivlerësuar me zëra të cilët i përkasin Llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e paisje*”. Kjo llogari nuk paraqet vlerën reale dhe është e mbingarkuar në vlerën 33,258,487 lekë.

Nga verifikimi i procedurës për nxjerrjen jashtë përdorimit, u kontaktua se personat e kontraktuar nga bashkia Ura Vajgurore, (G. B. dhe S. N.) nuk janë të pajisur me lejet apo licencat për ushtrimin e profesionit dhe për vlerësimin e mjeteve motorike, pra bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006, “*Për auto riparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to*” ndryshuar me ligjin nr. 10137/2009”. Nxjerrja jashtë përdorimit e këtij automjeti dhe lëshimi i urdhrave është bërë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 5 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*. Për sa më sipër, konstatohet se vlera prej 1,378,800 lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

e shkarkuar nga kontabiliteti për nxjerrjen e këtij aktivi jashtë përdorimit, përbën përdorim pa Efikasitet, Ekonomicitet dhe Efektivitet të aktiveve të Bashkisë Ura Vajgurore.

Në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, janë përfshirë edhe aktive të cilat kanë përfunduar (pavarësisht se disa nuk janë likuiduar për mungesë fondesh), janë marrë në dorëzim, por nuk ka përfunduar periudha e garancisë. Rrjedhimisht, kjo llogari nuk paraqet vlerën e vërtetë përse i përket aktiveve të cilat janë vënë në përdorim. Mos regjistrimi i vlerave të sakta në këtë llogari, ka sjellë edhe regjistrimin e gabuar në llogarinë 105 të pasivit, “*Teprica e Granteve kapitale te Brendshme*”, ku si rregull regjistrohet vetëm vlera për investimet në proces. Këto veprime bien në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, kapitulli III, pika 31, 33, 36 e në vijim dhe SKK nr. 5 “*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*”, pika 40.

Në urdhrat e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, nuk është specifikuar cilat aktive do të inventarizohen dhe vlerësohen dhe si rezultat është realizuar inventarizimi vetëm për llogaritë 214 “*Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune*”, 215 “*Mjete transporti*” dhe 218 “*Inventar ekonomik*”. Janë përjashtuar nga inventarizimi përkatësisht llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje dhe Plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete e vepra ujore*” dhe Aktivet afatshkurtra, në kundërshtim me pikën 74 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*. Komisioni i vlerësimit nuk është ngritur në përputhje me pikën 99 të UMF 30, ku përcaktohet se: “*...Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i njësisë...*”.

Nuk ka një sektor të veçantë apo një zyrë të menaxhimit të aseteve, veprim në kundërshtim me nenin 9 pika f) dhe nenin 8 pika d) të ligjit 10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” dhe pikat 9, 10 11, 13, 14 dhe 21 të VKM-së nr. 500 datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*”.

Në llogaritjen e amortizimit ka diferenca për shkak të mos mbajtjes në rregull të regjistrimit të aktiveve, pasi nuk është e qartë se për cilat aktive është llogaritur amortizimi i shtesave të bëra gjatë vitit, dhe për cilat jo. Llogaritja e gabuar e amortizimit për shkak të mosmbajtjes së regjistrave të aktiveve është në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, si në ekzistencën e një regjistri aktivesh ashtu dhe në dokumentacionin mbështetës për plotësimin e pohimit të ekzistencës së aktivitetit.

Vlera e zërave në pasqyrën e pozicionit financiar 2017, është vendosur bruto nga pasqyrat financiare të njësitë administrative në 2015 dhe nuk është specifikuar në mënyrë analitike, janë bërë shtesat e pakësimet për vitet 2017, 2018 dhe 2019, por në listat e inventarit mbahen me vlerën historike, pa llogaritur amortizimin.

Në regjistrin e inventarit, nuk ka informacion të hollësishëm për përshkrimin e aktivitetit, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

12/1 Rekomandim: Nga Nëpunësi Autorizues i bashkisë Ura Vajgurore, të merren masa për të caktuar Nëpunësin Zbatues të krijojë dhe të mbajë regjistrin e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj. Gjithashtu nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm e Aktiveve Afatgjata të pa



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore.

12/2 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore të merren masa të menjëhershme që nën strukturën organizative të ngrihet një zyrë apo sektor i veçantë për administrimin e aseteve dhe krijimin e regjistrimit të aseteve, e cila të funksionojë vetëm për kohën dhe problematikën e parashikuar. Kjo zyrë apo sektor, të mbajë lidhje të vazhdueshme me zyrën e kadastrës, të përgatitë planimetritë, planvendosjet dhe gjithë dokumentacionin tjetër të nevojshëm, deri në përfundim të regjistrimit dhe kontabilizimit të pronave, si dhe të bëjë përditësimin e vazhdueshëm të regjistrimit, duke pasqyruar ndryshimet përkatëse në kontabilitet.

12/3 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive për dëmtimin e autoveturës tip V. T., me targë AA...JT, deri në zhdëmtimin e vlerës së saj, si dhe për vlerësimin e aktiveve të mos kontraktohen persona të cilët nuk janë të kualifikuar siç duhet.

12/4 Rekomandim: Nëpunësi Autorizues, të marrë masa që në ngritjen e komisioneve për vlerësimin e aktiveve, kryetar i komisionit të vlerësimit të jetë Nëpunësi Zbatues.

12/5 Rekomandim: Nga Nëpunësi Zbatues, të merren masa për të llogaritur amortizimin në mënyrë progresive dhe për t’i mbajtur në mënyrë kumulative në regjistrin e aktiveve së bashku me të gjitha detajet e tjera të regjistrimit, të listuara në rekomandimin 1 më sipër.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Aksionere “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore” me NIPT K32803022R në ka 100% të aksioneve, në vlerën nominale 170,366,002 lekë, në pronësi 100% të Bashkisë Ura Vajgurore. Kjo vlerë nuk paraqitet në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, kapitulli III, pika 31.

Alokimi nga Ministria e transportit dhe infrastrukturës i shumës prej 13,100,000 për vitin 2017, si viti i parë i investimit për objektin “Ndërrhyrje emergjente për furnizimin me ujë të Urës Vajgurore nga stacioni i pompave Poshnjë, (ndërtim, montime, kolaudim punimesh dhe makineri e pajisje”, me vlerë totale 98,151,828 lekë, është në kundërshtim me përcaktimin në nenin 40 “E drejta për të kryer shpenzime”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57-2016, datë 02.06.2016. Vlera e alokuar për vitin 2017, duhet të ishte minimalisht 19,630,366 lekë.

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore” është personi i vetëm që ka kompetenca ligjore për furnizimin me ujë të pijshëm për konsumatorët dhe shitjen e ujit në Bashkinë Ura Vajgurore, mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, etj. Këshilli Bashkiak nuk i ka kaluar fondet e investimeve në ujësjetllës në destinacionin përfundimtar, ku të zhvillohen procedurat e prokurimit, etj., duke vepruar në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës me nr. akti 29588, datë 22.04.2003, “Për regjistrimin e personit juridik Ujësjetllës Ura Vajgurore SHA”, Aktit të Themelimit dhe Statutit të kësaj shoqërie, Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr. 73, datë 04.03.2003, “Për transformimin e ndërmarrjes shtetërore “Ujësjetllës Ura Vajgurore” Berat në shoqëri anonime”, etj.

Nga ana e bashkisë Ura Vajgurore (Këshillit Bashkiak), përveç transferimit të aktiveve, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë tjetër, verifikim apo vlerësim i pasurisë dhe fondeve të saj në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore”, përfshirë edhe regjistrimin e aksioneve në llogarinë 26 të pasqyrave financiare të bashkisë, “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

13/1 Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjiellës Kanalizime Sha Ura Vajgurore”, me vlerë kontabël 170,366,002 lekë në llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*”.

13/2 Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore, Këshilli Bashkiak, të merren masa që fondet për mallra dhe shërbime të prokurohen nga Shoqëria Aksionare “Ujësjiellës Kanalizime Sha Ura Vajgurore”, si i vetmi person juridik përgjegjës me ligj për furnizimin me ujë të popullatës së qytetit Ura Vajgurore dhe fshatrave të bashkisë Ura Vajgurore.

13/3 Rekomandim: Nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, të merren masa që në angazhimet buxhetore shumëvjeçare, të cilat lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes të shpërndahen jo më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Llogaria 105 “*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*”

Në fund të vitit 2017 rezulton në vlerën 494,473,628 lekë, në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 584,394,777 lekë dhe në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 548,854,365 lekë.

Nga ana e Bashkisë Ura Vajgurore bëhet e ditur se vlerat e paraqitura në bilanc paraqesin investime të përfunduara, të cilat janë marrë në dorëzim dhe aktualisht janë në funksionim, gjë që bie në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për paraqitjen e pasqyrave financiare në NjQP*”, aneksi I, pika 2, etj., ku thuhet qartë që duhet të ishin kapitalizuar me fondet bazë kur investimi është marrë në dorëzim. Pra llogaria 105, Teprica e Granteve kapitale të brendshme në këtë rast duhet të ishte me vlerën aktuale, minus vlerën e aktiveve të marra në dorëzim.

14/1 Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për llogarinë 105 “*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*”.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve, faturave, procesverbaleve të marrjes në dorëzim, rakordimeve me thesarin, etj., u konstatua se në shumicën e rasteve, urdhrat e shpenzimeve dhe kontratat për prokurime të ndryshme, si me grante/fonde të deleguara, ashtu edhe me fondet e veta, janë bërë pa pasur të disponueshme në llogarinë e institucionit vlerën e plotë të prokurimit, si në rastet e investimeve njëvjeçare, ashtu edhe për investimet shumëvjeçare. Këto veprime dhe mosveprime bien ndesh me dispozitat e përcaktuara në nenin 70 “*Lidhja e kontratës*”, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014. Kjo shkelje ngarkon me përgjegjësi Nëpunësit Autorizues, sipas nenit 71 “*Shkelje dhe Sanksione*” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH*”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, në pikën b).

15/1 Rekomandim: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i bashkisë Ura Vajgurore të marrin masa për të mos zhvilluar angazhime shpenzimi për mallra/punë/shërbime, pa pasur paraprakisht në llogarinë e institucionit fondet e nevojshme.

Në vijimësi

15/2 Rekomandim: Bashkia Ura Vajgurore (Sektori i Financës), të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak dhe më pas t’i dërgojë Nëpunësit të parë Autorizues, një material për angazhimet e shpenzimeve për mallra/punë/shërbime të bëra pa pasur fonde në dispozicion.

Në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

16. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i faturimeve të ndryshme, u konstatua se ka pasur mjaft raste (sidomos për kontratat e ndërtimit apo rikonstruksionit) kur faturat janë paraqitur për pagesë pas marrjes në dorëzim të punimeve apo mallrave. Ky veprim apo mosveprim, është në kundërshtim me përcaktimet në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 51, “Lëshimi i faturës tatimore”, neni 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve”, me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 33 “Rregulla të veçanta, neni 99 “Momenti i lëshimit të faturës” dhe me UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 20 “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes” pika 2 “Vlera e tatueshme e punimeve të ndërtimit” dhe pika 3 “Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim”.

Duke mos kërkuar paraqitjen e faturave në momentin e marrjes në dorëzim të punimeve, shërbimeve apo blerjes së mallrave, nga bashkia Ura Vajgurore është stimuluar evazioni fiskal, nëpërmjet mospagimit të TVSH-së në momentin e duhur për këto fatura të paraqitura me vonë.

Për marrjen në dorëzim të punimeve, mallrave dhe shërbimeve, në rastet kur faturat janë paraqitur pas marrjes në dorëzim, sipas bazës ligjore të përmendur më sipër, një punë, shërbim apo blerje mallrash quhet e përfunduar në momentin e paraqitjes së faturës, bashkia Ura Vajgurore nuk ka proceduar me penalitetet përkatëse sipas kontratave për mos përmbushje të afateve kontraktuale. Për punimet në ndërtim sipas grafikut të kontraktuar për punimet, ditareve dhe situacioneve të punimeve, në rastet kur nuk janë paraqitur situacione, bashkia Ura Vajgurore nuk ka proceduar me penalitete për mosrealizimin e grafikut të punimeve, sipas kontratave përkatëse.

16/1 Rekomandim: Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa për të gjitha subjektet të cilët kanë paraqitur me vonë faturat me TVSH, për të filluar menjëherë llogaritjen e penaliteteve dhe gjobave përkatëse sipas kushteve për mosrealizimin në kohë të kontratave, duke filluar nga data kur punimet/shërbimet apo mallrat duhet të dorëzoheshin sipas kontratës, deri në momentin e paraqitjes së faturës nga furnitori.

16/2 Rekomandim: Bashkia Ura Vajgurore (Sektori i Financës), të hartojë një material të detajuar ku të përmbledhen të gjitha rastet e faturave të paraqitura me vonë, përfshirë edhe situacionet për punimet në ndërtim, të cilat nuk janë paraqitur çdo muaj. Ky material të përcillet menjëherë për dijeni në Drejtorinë Tatimore Rajonale Berat ose ku kanë regjistrimin e selisë qendrore subjektet, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i listave të tatimpaguesve në bashkinë Ura Vajgurore, u konstatua se pothuajse asnjë nga subjektet të cilët nuk janë me seli qendrore në territorin e bashkisë Ura Vajgurore, nuk ka hapur adresë sekondare në bashkinë Ura Vajgurore, duke shmangur pagesat e detyrimeve përkatëse tatimore dhe tarifave që zbatohen nga kjo bashki. Rrjedhimisht, këto subjekte kanë bërë shmangien e këtyre pagesave, duke shkaktuar mungesë të ardhurash për bashkinë Ura Vajgurore, si dhe duke konkurruar pa të drejtë në tenderat e ndryshëm të zhvilluar nga bashkia Ura Vajgurore.

17/1 Rekomandim: Bashkia Ura Vajgurore të marrë masa për të arkëtuar detyrimet tatimore dhe tarifore vendore, nga të gjitha subjektet të cilët kanë operuar në territorin e saj pa licencë/NUIS sekondar, duke llogaritur edhe kamatëvonesat përkatëse. Gjithashtu, të marrë masa që këto subjekte të mos ftohen apo pranohen për të ofertuar në prokurime të ndryshme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

pa arkëtuar më parë detyrimet në fjalë, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë Ura Vajgurore.

Menjëherë

18.Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit për vitet objekt auditimi (2017 -2019) nga 43 procedura të zhvilluara me fond limit 642,541 mijë lekë, u audituan 38 prej tyre, me vlerë të fondit limit 625,492 mijë lekë, nga te cilat per investime gjate tre viteve ne vlerën 558,997 mijë lekë, për mallra në vlerën 52,210 mijë lekë dhe shërbime në vlerën 14,285 mijë lekë, konkretisht:

Viti	Numër prokurimesh	Fondi limit	Vlera e kontratës	Audituar	Fondi limit	OE		Diferenca nga F.Limit
						gjithsej	S` kualifikuar	
2017	20	428,815,837	510,727,030	19	426,975,021	36	14	2,706,344
2018	10	79,743,262	4,961,854	10	79,743,262	26	19	2,197,957
2019	13	136,990,119	145,350,994	9	118,773,690	19	8	3,599,707
Shuma	43	642,541,161	737,775,083	38	625,491,973	81	41	8,504,008

Nga auditimi u konstatua se një pjesë e kriterëve të veçanta të DST që lidhen me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura me aftësinë zbatuese dhe llojit të punimeve apo shërbimeve, vlerën dhe natyrën e kontratës, të shërbimeve dhe blerjes së mallrave, si dhe nuk janë argumentuar me procesverbal të veçantë, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, ku në 26 prej procedurave të prokurimit të audituara ose në 68.4% e tyre (43 gjithsej), janë realizuar me pjesëmarrjen nga 1 deri 2 operatorë ekonomik (OE) me vlerë kontrate 460,416 mijë lekë ose 61 %, veprime në kundërshtim me nenet 45, 46 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 61, Kreun X “Shqyrtimi i ankesave”, neni 78 “Ankesat ne autoritetin kontraktor” (trajtuar me hollësisht në faqe 52 -105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Ura Vajgurore, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, për secilin kriter me procesverbal, i cili të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Ura Vajgurore), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **42,161,450 lekë**, si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: - **“Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”, të zhvilluar në vitin 2017**, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 150,008,367.60 lekë, fituar nga BOE fitues “L. K.” & “T.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **585,703 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1541/12 prot., datë 18.09.2017. (trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **585,703 lekë pa Tvsh** nga BOE fitues “L. K.” & “T.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1541/12 prot., datë 18.09.2017, me objekt: “Rikonstruksione rrugësh në Bashkinë Ura Vajgurore”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: - **“Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani”,**, me vlerë të kontratës (me Tvsh) **62,781,144** lekë, fituar nga BOE fitues “T.” & “F.” & “B. B.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **393,570** lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1296/13 prot., datë 11.08.2017 (trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **393,570 lekë pa Tvsh** nga BOE fitues “T.”&“F.”&” B. B.” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1296/13 prot., datë 11.08.2018, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Refat Bani”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: **“Sistemim varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajgurore**, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 35,165,454 lekë, fituar nga BOE “K.” & “T.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **304,391 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1288/13 prot., datë 11.08.2017, (trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **304,391 lekë pa Tvsh** nga BOE “K.” & “T.” Shpk,, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1288/13 prot., datë 11.08.2017,, me objekt: **“Sistemim varrezash dhe rrugët hyrëse në Bashkinë Ura Vajgurore”,** Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: **“Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjentëve të Rekreacionit në fshatin Donofrosë”**., Bashkia Ura Vajgurore, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 9,477,624 lekë, fituar nga “R. C.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **100,000 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

nr. 1215/19 prot., datë 10.07.2018, *(trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **100,000 lekë pa Tvsh** nga OE “R. C.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1215/19 prot., datë 10.07.2018, me objekt: “Rehabilitim rruga Pllakë Kulluricë”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: **“Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjentëve të Rekreacionit në fshatin Samaticë”**, Bashkia Ura Vajgurore, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 7,999,092 lekë, fituar nga BOE “T.” & “E. K. Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 100,000 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2420/16 prot., datë 15.11.2018 *(trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **100,000 lekë pa Tvsh** nga BOE “T.” & “E. K. Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2420/16 prot., datë 15.11.2018, me objekt: **“Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambjentëve të Rekreacionit në fshatin Samaticë”** Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Sistemim i rrugës së tregjeve (Loti 1)”**, Bashkia Ura Vajgurore, me vlerë të kontratës (me tvsh) 70,906,936 lekë, fituar nga OE “S.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në zërat “Beton C16/20 për kunetë”, “Puseta betoni me kapak gize 40 x 40 cm, çmimi”, “Shtresë çakull gurore për bankinat t=10 cm”, “Shtresë çakull gurore për bankinat t=10 cm” etj., në vlerën **1,593,206 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 983/1 Prot, datë 18.04.2017 *(trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,593,206 lekë pa tvsh** nga OE “S.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 983/1 Prot, datë 18.04.2017, me objekt “Sistemim i rrugës së tregjeve (Loti 1)”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Kanali ujitës BRU – 15 Manastir dhe ushqyesi i rezervuarit”**, Bashkia Ura Vajgurore, me vlerë të kontratës (me tvsh) 22,659,480 lekë, fituar nga BOE “F.” & “Sh.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në zërin “Ndërtim mur gabioni me rrjet xingato”, në vlerën 326,000 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 1130/11 prot datë 05.07.2017 *(trajtuar më hollësisht në faqet 105 -125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

7.1. Rekomandim: Nga Bashkia Ura Vajgurore të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **326,000 lekë pa tvsh** nga BOE “F.” & “Sh.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

me nr. 1130/11 prot datë 05.07.2017, me objekt “Kanali ujitës BRU – 15 Manastir dhe ushqyesi i rezervuarit”, Bashkia Ura Vajgurore, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se:

- në procedurën me objekt “Blerje Autoveture” të zhvilluar vitin 2018, me fond limit 2,750,000 lekë, shpallur fitues OE “OAL” shpk, rezultoi se nga veprimet dhe mosveprimet e KVO-së nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar dëm ekonomik të paarkëtueshëm prej 150,000 lekë;

- në procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje dhe riparim automjetesh” të zhvilluar në vitin 2018, me fond limit 1,463,300 lekë shpallur fitues OE “P. I.” shpk për mos anulimin e procedurës dhe shpalljen e fituesit i cili nuk i plotëson kriteret e DST, veprimet dhe mosveprimet e KVO-së nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike kanë shkaktuar dëm ekonomik të paarkëtueshëm në vlerën 311,760 lekë;

- në procedurën e prokurimit “Ndërtim dhe mirëmbajtje urash” të zhvilluar në vitin 2018, me fond limit 3,441,494 lekë shpallur fitues OE T. shpk nga veprimet dhe mosveprimet e KVO-së nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar dëm ekonomik të paarkëtueshëm prej 443,820 lekë.

- në procedurën e prokurimit “Hartim projekt preventiv për rikonstruksionin e Qendrës Kulturore Bashkia Ura Vajgurore”, me fond limit 4,230,790 lekë të zhvilluar në vitin 2017, fituar nga BOE “E. G.” shpk & “A. S.” rezultoi se nga veprimet dhe mosveprimet e KVO-së nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar dëm ekonomik të paarkëtueshëm prej 1,201,000 lekë.

Trajtuar më hollësisht në faqet 52 -105 të Raportit Përfundimtar të auditimit

8/1 Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Ura Vajgurore, në lidhje me procedurat e prokurimit të sipërcituara, për veprimet dhe mosveprimet e anëtarëve të KVO-së, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësohet shkalla e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore.

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Ura Vajgurore ushtrojnë aktivitetet për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore 17 subjekte për sipërfaqe 35 ha, është lidhur 1 kontratë qiraje, për sipërfaqe 16.2 ha. Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit, nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullosor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” për të cilat nga mos lidhja e kontratave të qirave për të ardhurat e munguara është shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në shumën **36,652,000 lekë** (trajtuar me hollësisht në faqe 21-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9/1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Ura Vajgurore, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **36,652,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve, duke e konsideruar respektivisht këtë mospagesë si dëm ekonomik që duhet të arkëtohet.

Menjëherë

B/I. MASA PËR ELEMENIMIN E PALIGJSHMËRIVE NË TRAJTIMIN E SUBJEKTEVE LIDHUR ME LLOGARITJEN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE ME EFEKTE NË TË ARDHURAT E MUNGUARA NË BASHKINË URA VAJGURORE.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Kryetari i Bashkisë Ura Vajgurore, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e të ardhurave të munguara në **shumën 223,114,696 lekë, si më poshtë vijon:***

1- Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat rezulton se për vitin 2019: nuk kanë paguar taksën e tokës me tarifat përkatëse, 7,531 familje në shumën **166,711,179 lekë**, taksa lokale me tarifat përkatëse, 909 familje në shumën **9,010,940 lekë**, si dhe 210 familje për qiranë e tokës bujqësore në vlerën **12,228,661 lekë** të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019. Për vitin 2019, nuk kanë paguar taksë ndërtese, pastrimi, ndriçimi e gjelbërimi 5439 familje në shumën **13,001,000 lekë**, të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019.

Në Bashkinë Ura Vajgurore nga subjekte të biznesit të vogël dhe të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore pavarësisht punës së bërë niveli i arkëtimit është shumë i ulët. Kështu nga 21,749,029 lekë për vitet objekt auditimi janë arkëtuar vetëm 37.7% kanë mbetur pa u arkëtuar **13,542,916 lekë**.

Nga auditimi vjeljes së gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor për periudhën deri 31.12.2019 rezultoi se janë pa arkëtuar **2,020,000 lekë**.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI- “*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*” (trajtuar me hollësisht në faqe 21 -37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1/1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike, Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e :

- taksës së tokës me tarifat përkatëse, në shumën **166,711,179 lekë**,
- taksës lokale me tarifat përkatëse, në shumën **9,010,940 lekë**,
- qiranë e tokës bujqësore në vlerën **12,228,661 lekë**
- taksës së ndërtesës, pastrimit, ndriçimit e gjelbërimit në shumën **13,001,000 lekë**, të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019.
- taksës e tarifës vendore nga subjekte të biznesit të vogël dhe të madh në shumën **13,542,916 lekë**.
- gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor për periudhën deri 31.12.2019 rezultoi se janë pa arkëtuar **2,020,000 lekë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Ura Vajgurore.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të taksave/ tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre (autorizimeve), u konstatua se nuk është aplikuar saktë tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet.

Detyrimet për pajisjen me licence tregtimi nuk janë paguar në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur, sipas të cilës këto subjekte duhet të paguajnë 1,000,000 lekë për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, duke mos aplikuar dhe arkëtuar vlerën prej **4,600,000 lekë**, si e ardhur e munguar.

Gjithashtu dy subjekte qe kanë filluar aktivitetin e tyre dhe janë mbyllur më vonë nga përmbarimi apo pezulluar nga QKB, nuk kanë paguar detyrimin përkatësisht me nga 1,000,000 lekë, në total **2,000,000 lekë**. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar (trajtuar me hollësisht në faqe 21 -37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Ura Vajgurore, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **6,600,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve

Menjëherë

B/II. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat rezultojnë se për vitin 2019:

Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, rezultojnë se më datën 31.12.2019, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë **95 subjekte të biznesit të vogël, 23 të biznesit të madh, të cilët nga të dhënat e zyrës së financës janë kontabilizuar, në vlerën prej 23,615,358 lekë.**

Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël për subjekte në vlerën 4,740,225 lekë, (NJA Ura Vajgurore, për 19 subjekte në vlerën 1,098,625 lekë, NJA Kutalli 69 për subjekte në vlerën 3,331,276 lekë, NJA Poshnjë për 4 subjekte në vlerën 155,854 lekë, NJA Cukalat për 3 subjekte në vlerën 154,470 lekë).

Në vlerën e mësipërme është përfshirë dhe shuma e vlerës debitorë për subjekte të Njesisë Administrative Kutalli të lënë nga KLSH me procesverbalin nr. 18 datë 12.05.2017, për subjekte 28 biznes i vogël me vlerë 1,060,440 lekë sipas Aneksit B/1,2,3.

